


Parteneritet për
Qeveri e
hapur të
**Maqedonisë
së Veriut**



PLAN KOMBËTAR PËR PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR VITI 2021-2023

Shkup,
Tetor
2021

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE.....4

HYRJE.....6

PËRPJEKJET E DERITANISHME

PËR PARTNERITET

PËR QEVERISJE TË HAPUR..... 8

ZHVILLIM I PLANIT KOMBËTAR PËR VEPRIM PËR
PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR PËR
PERIUdhËn 2021-2023 - QEVERI E HAPUR..... 10

QEVERI E HAPUR 16

**1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET
DHE PËRFSHIRJE..... 16**

1.1. Shpallje publike e pronarëve të vërtetë
të kompanive që kanë lidhur kontrata për
prokurime publike..... 16

1.2. Publikim proaktiv i informacioneve
me karakter publik në web faqet e
institucioneve..... 21

1.3. Publikim i informacioneve bazë
për prokurimet publike në web faqet e
institucioneve..... 26

1.4. Përmirësim i qasjes në informacione dhe
numrit të të dhënave të publikuara në njësitë e
vetëqeverisjes lokale (NJVL)..... 31

1.5. Mundësim i qasjes pa pagesë në të dhëna
për organizatat e shoqërisë civile
Tetor 2021-Maj 2022..... 35

1.6. Transparencë fiskale dhe llogaridhënie
në nivel lokal dhe përmirësim i përfshirjes së
qytetarëve përmes mekanizmave dhe mjeteve
inovative..... 43

**2. PARANDALIM I KORUPSIONIT
DHE PROMOVIM I QEVERISJES
SË MIRË..... 48**

2.1. Prokurimet publike si të dhëna
të hapura..... 48

2.2. Mekanizëm i përparuar për ndjekje të
gjendjes pasurore të personave të zgjedhur
dhe të emëruar..... 52

2.3. Shpallje publike e lëndëve për zgjedhjen e
personave të zgjedhur/emëruar nga Qeveria e
RMV-së si udhëheqës të institucioneve 56

**3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË
SHËRBIMEVE PUBLIKE..... 61**

3.1. Shërbimet publike dhe politikat e
bazuara në prioritetet qytetare nga sfera
e punësimit 61

3.2. Shërbime publike dhe politika të bazuara
në prioritetet qytetare nga sfera e mbrojtjes
shëndetësore preventive 68

3.3. Shërbime publike dhe politika të
bazuara në prioritetet qytetare nga
sfera e arsimit 75

3.4. Shërbime publike dhe politika të bazuara
në prioritetet qytetare nga sfera e ofrimit të
shërbimeve publike lokale 82

3.5. E-shërbime të disponueshme në zonat
rurale 87

3.6. Rritje e qasjes në format e organizuara
të mbrojtjes së viktimave të tregëtisë me
njerëz 93

3.7. Përmirësim i mekanizmave për
mbrojtje të viktimave të shqetësimit në
vend të punës 101

3.8. Mundësim i qasjes në terapi dhe
shërbime mjekësore për personat që
konsumojnë droga pas vuajtjes së dënimit
me burg 106

4. QASJE NË DREJTËSI 114

4.1. Përmirësim i mbrojtjes së punëtorëve
seksualë dhe personave që konsumojnë
droga 114

4.2. Përmirësim i qasjes në drejtësi për
personat e rrezikuar social dhe personat
në rrezik social 122

4.3. Qasje në drejtësi për gra që kanë
përjetuar dhunë familjare 131

4.4. Përforsim juridik i qytetarëve përmes
informacioneve të disponueshme dhe
institucioneve të hapura 142

**5. MJEDISI JETËSOR DHE
NDRYSHIMET KLIMATIKE 155**

5.1. Zvogëlim i efekteve nga ndryshimet
klimatike dhe mbrojtje e mjedisit jetësor
nga aktivitetet bujqësore 155

5.2. Qasje në informacione për nivelin
e ndotjes së ajrit 161

PARLAMENT I HAPUR 172

GJYQËSI E HAPUR 206

LISTA E SHKURTESAVE

APRMV	Agjencioni për punësim i Republikës së Maqedonisë së Veriut
AQLI	Agjencioni për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informacione të karakterit publik.
BPP	Ministria e Financave- Byroja për prokurime publike
BZHA	Byroja për zhvillim të arsimit
SB	Sektori bankar
BEGJ	Ministria e drejtësisë - Byroja për ekspertiza gjyqësore
OSHQ	Organizatrat e shoqërisë civile
SP I QRMV	Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut
ISHP	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - Inspektorati shtetëror i punës
KSHPK	Komisioni shtetëror për parandalim të korupsionit
ISHA	Ministria e arsimit dhe shkencës - Inspektorati shtetëror i arsimit
BNJVL	Bashkësia e njëjësive të vetëqeverisjes lokale
SEPP	Sistemi elektronik i prokurimeve publike
TIK	Teknologjia informatike dhe e komunikimit
DHP	Dhoma e Përmbauesve
IAL	Institucionet arsimore lokale
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MMPH	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MSH	Ministria e Shëndetësisë
MBPEU	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave
MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
MVL	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
MF	Ministria e Financave
PKV	Plani kombëtar i veprimit
PKV 5	Plani i pestë kombëtar i veprimit për Partneritet për qeverisje të hapur për periudhën 2021-2023
GJTH	Gjykatat themelore
PHQ	Partneritet i hapur qeveritar
PQH	Partneritet për qeverisje të hapur
KR	Koalicioni rural
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KE	Këshilli i Europës
DES	Ministria e Drejtësisë – Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve
FSSHRMV	Fondi i sigurimit shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut
FSHHM	Fondacioni i shoqërisë së hapur Maqedonia
RQRMV	Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
QPS	Qendrat për punë sociale

HYRJE

Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV) ka rezultate të njohura në proceset e qeverisjes së hapur. Që nga bashkangjitja në iniciativën për Partneritet për qeverisje të hapur (PQH), në vitin 2011 RMV me përkushtim ndoqi nevojën për angazhim më të madh dhe përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, vendosjes së standardeve më të mëdha të integritetit dhe qasje më të madhe në teknologji për të gjithë qytetarët.

Përkushtimi për hapje solli shumë dobi, duke e bërë qeverinë më transparente dhe më të përgjegjshme, duke krijuar potencial për zhvillim të një ambienti dinamik për përfshirje, udhëheqje efikase me resurset publike, ndërtim të sistemit të integritetit, hapësirë mundësuese në nivel lokal, qasje në informacione dhe të dhëna të hapura. Përmes hapjes dhe vendosjes së resurseve tona në dobi të publikut, ia dolëm të përmirësojmë dialogun, inovacionet dhe përdorimin e teknologjisë që e bëjnë jetën e qytetarëve më të mirë dhe më të lehtë.

Bazuar në suksesin e arritur nga zgjerimi i mëparshëm i kësaj iniciative në suaza të Parlamentit, në këtë cikël përveç zotimeve për Parlament të Hapur janë krijuar edhe zotime për Gjyqësi të hapur. Prandaj, duke respektuar pavarësinë e punës së pushtetit ligjvënës dhe atij gjyqësor si pushtete të veçanta në RMV, Partneriteti i hapur qeveritar në mënyrë të merituar rritet në Partneritet i qeverisjes së hapur. Si rrjedhojë sa më sipër, në komunikimin e mëtutjeshëm dhe realizimin e kësaj iniciative në vend

të emërimit të deritanishëm Partneritet i hapur qeveritar do të përdoret emërtimi PARTNERITET I QEVERISJES SË HAPUR (PQH).

Plani i pestë kombëtar i veprimit për Partneritet për qeverisje të hapur për periudhën 2021-2023 (PKV 5) ndërlidhet me intensitetin e mëparshëm të punës me ndërmarrje të detyrimeve për rritje të pjesëmarrjes së publikut dhe ofrimin e zgjedhjeve të vërteta transformuese. Gjithashtu, e njeh nevojën që sektori publik të inovojë, të zhvillojë politika që përgjigjen me nevojat e qytetarëve si përgjigje e trendeve bashkëkohore.

PKV 5 i ri konfirmon nevojën e thellimit të detyrimeve të mëparshme dhe përmirësim të kualitetit të tyre. Ai është i drejtuar drejt zotimit për qasje në drejtësi, përforcim i qytetarëve dhe përmirësim i mbrojtjes juridike veçanërisht të të rinjve, grupeve të marginalizuara dhe grave, përmirësim të ofrimit të shërbimeve publike, vazhdim i aktiviteteve të lidhura me shpalljen publike të informacioneve për pronarët e vërtetë, hapje të të dhënave të reja si dhe aktivitete për parandalim të korupsionit dhe mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ndotjes së ajrit. Pritet që pas periudhës dyvjeçare të realizimit të zotimeve të përcaktuara në këtë plan të mundësohet njohje e vërtetë e rezultateve ndërsa qytetarët do të kenë mundësi të konfirmojnë ndryshimin.

Në PKV 5 janë të përfshira zotimet e mëposhtme:



QEVERI E HAPUR

- Transparencë, llogaridhënie, proaktivitet dhe përfshirje
- Parandalim i korupsionit dhe promovim i qeverisjes së mirë
- Ofrim i shërbimeve publike
- Qasje në drejtësi
- Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike



PARLAMENT I HAPUR

- Parlamenti për qytetarët me përgjigje të hapur dhe rimëkëmbje të hapur nga pandemia e COVID 19
- Infrastrukturë e përmirësuar e tik
- Pjesëmarrje e qytetarëve/parlament i hapur



GJYQËSOR I HAPUR

- Qasje në informacione dhe të dhëna
- Performanca të institucioneve

PËRPPJEKJET E DERITANISHME PËR PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR

Përmes kësaj iniciative globale, RMV përmes katër planeve për veprim (2012-2014; 2014-2016; 2016-2018 dhe 2018-2020) ka arritur arritje të rëndësishme në sfera të ndryshme të rëndësishme duke përfshirë transparencën fiskale dhe financat e hapura, bashkëpunimin me shoqërinë civile, qasjen në informacionet me karakter publik, krijimin participativ të politikave, shërbimet publike, hapësirë e volitshme juridike për marrëveshje sociale, të dhëna të hapura, parandalim i korupsionit, prokurimet publike, transparenca në nivel lokal, qasja në drejtësi dhe ndryshimet klimatike.

Është futur praktika e mirë e ndërlikohjes së zotimeve për planin e veprimit me qëllimet e përcaktuara në Agjendën për zhvillim të qëndrueshëm deri më 2030, veçanërisht me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme, 3 „Shëndet i mirë dhe mirëqenie“, 11 „Qytetet dhe vendbanimet njerëzore të jenë përfshirëse, të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme“, 13 „Aksioni klimatik“ dhe qëllimi 17 „Partneritet për qëllimet“.


Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve është parakusht bazë për suksesin e partneritetit për qeverisje të hapur. Pjesëmarrja e

shoqërisë civile është kyçe për qeverisje të hapur dhe element kyç në ciklin kombëtar për krijim të planeve të veprimit.

Me qëllim arritjen e pajtueshmërisë së plotë me kërkesat që dalin nga kjo iniciativë dhe duke ndjekur Udhëzimet për udhëheqje dhe pjesëmarrje në iniciativën Partneritet për qeverisje të hapur dhe Standardet për bashkëkrijim dhe dizajnim të forumit me më shumë palë të interesuara, në vitin 2020 u vendos Këshilli për koordinim dhe ndjekje të procesit të Partneritetit të hapur qeveritar dhe Planit kombëtar për veprim për Partneritetin e hapur qeveritar për vitin 2018-2020¹ (në tekstin e mëposhtëm: Këshilli për PHQ). Këshilli për PHQ dhe Grupi i punës me të gjithë palët e interesuara për zbatim të planit kombëtar për Partneritet të hapur qeveritar të vitit 2018-2020 (në tekstin e mëposhtëm Grupi i punës për PHQ), paraqesin strukturën për koordinim, ndjekje dhe zbatim të procesit të Partneritetit për qeverisje të hapur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Prandaj, procesi i PQH edhe në ciklin e pestë u përmbajt nga Këshilli për

¹ <https://ovp.gov.mk/%d1%81%d0%be%d0%b2%d0%b5%d1%82-%d0%b7%d0%b0-%d0%be%d0%b2%d0%bf/>



PHQ dhe Grupi i punës për PHQ të cilët mundësuan në mënyrë të struktuar të maksimizohet pjesëmarrja dhe kontributi si i përfaqësuesve të sektorit publik ashtu edhe i përfaqësuesve të sektorit joqeveritar, edhe atë përmes Rrjetit të vendosur të organizatave të shoqërisë civile për partneritet të hapur qeveritar² (në tekstin e mëposhtëm: Rrjeti për PHQ).

Është krijuar portal për Partneritetin për qeverisje të hapur (www.ovp.gov.mk) i cili paraqet pikë qendrore për konsultim, monitorim, përfshirje, rrjetëzim dhe njoftim të të gjithë palëve të interesuara dhe të prekura në këtë proces. Portali shërben si platformë për interaksion dhe shkëmbim të informacioneve në katër segmente të këtij procesi: konsulta për përgatitje të Planit kombëtar për veprim, ndjekje e zbatimit të PKV, si dhe ndjekje e punës së Këshillit për PHQ dhe Rrjetit për PHQ.

² Rrjeti angazhohet për inicim, nxitje, mbështetje, zbatim dhe monitorim të procesit të PQH dhe për nxitje të pushteteve dhe institucioneve tjera për rritje të transparencës, llogaridhënies dhe hapjes për pjesëmarrje (participim), në rrjet janë të përfshirë më shumë se 70 organizata të shoqërisë civile.

ZHVILLIM I PLANIT KOMBËTAR PËR VEPRIM PËR PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR PËR PERIUDHËN 2021-2023 - QEVERI E HAPUR

Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, në bashkëpunim me Këshillin për PHQ dhe Rrjetin për PHQ, dhe me mbështetje të Sekretariatit për Partneritet për qeverisje të hapur dhe Fonacionit shoqëri e hapur-Maqedoni, bashkë me dy organizatat partnere Qendra për komunikim qytetar dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave, ka vazhduar mbështetjen dhe përfshirjen aktive në procesin e bashkëkrijimit të PKV 5.

Me qëllim që të mundësohet mënyrë e sistematizuar e planifikimit dhe zbatimit të procesit të konsultimit, i cili do të mundësojë proces në kohë të duhur, të papenguar, përfshirës dhe transparent të bashkëkrijimit të PKV të ri, në vitin 2020 u përcaktua mënyra e zbatimit të procesit të bashkëkrijimit të PKV 5, si dhe Procedura e zbatimit të konsultave me palët e prekura dhe krijim i prioritetëve të reja dhe zotimeve në suaza të procesit PHQ me kornizë kohore. Thirrje publike për paraqitje për pjesëmarrje në procesin e bashkëkrijimit të PKV 5 dhe

Udhëzimet për zbatim të pyetësorit për vlerësim të implementim të masave nga PKV dhe PHQ për 2018-2020 dhe nevojën e përfshirjes së tyre në PKV 5 të ri. Poashtu janë përgatitur edhe materiale të cilat rrjedhin nga procedura për zbatim të konsultave: Plan për promovim të thirrjes publike, material edukativ dhe kriteriume për vlerësim të relevancës dhe lidhjes së principeve të PHQ. Të gjithë dokumentet janë të disponueshme në portalin për PQH.

Bazuar në një procedurë të parashikueshme dhe të rregulluar të procesit të bashkëkrijimit në vitin 2020 në një ambient dinamik dhe përfshirës, filloi procesi i përgatitjes së Planit të pestë kombëtar për veprim dhe partneritetit për qeverisje të hapur për periudhën 2021-2023.

Në bazë të rezultateve të fituara nga thirrja publike për paraqitje të pjesëmarrjes në procesin e bashkëkrijimit të planit të veprimit për Partneritet për qeverisje të hapur 2021-2023 dhe shprehjes së interesit për përfshirje në takime për një ose më shumë zona prioritare

për pjesëmarrje³ dhe idetë e reja të dorëzuara dhe pyetjet të cilat duhet të jenë subjekt i përpunimit në procesin e bashkëkrijimit (mbrojtje sociale, kulturë, shkencë, arsim, shëndetësi, digjitalizim dhe të ngjashme), imponohet nevoja të kryhet shkrirje, rigrupim por

edhe zgjerim i shtrirjes së zonave prioritare për planin e ri për veprim. Sipas sa më sipër, Këshilli për PHQ i përcaktoi zonat e mëposhtme prioritare dhe grupet e punës në të cilët vazhdoi procesi i bashkëkrijimit të planit të veprimit:



TRANSPARENÇË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJE

→ zotime të cilat promovojnë përfshirje më të madhe të qytetarëve në krijimin e politikave, proaktivitet, liri dhe qasje në informacione, të dhëna të hapura, transparencë të institucioneve, mbrojtje e të dhënave personale, digjitalizim, me fokus të veçantë të rinjtë, grupet e marginalizuara dhe gratë.



PARANDALIM I KORUPSIONIT DHE PROMOVIM I QEVERISJES SË MIRË

→ Zotim drejt promovimit të parandalimit të korupsionit, ndërtim i sistemit të integritetit, menazhim me konfliktet e interesit, ndalim i flukseve të paligjshme financiare dhe lufta kundër evazionit fiskal me fokus të veçantë tek të rinjtë, grupet e marginalizuara dhe gratë.



OFRIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

→ zotim për ofrim të shërbimeve publike- masat që mund të përmirësojnë kualitetin e arsimit, shëndetësisë, gjendjes sociale si dhe qeverisjes në nivel lokal, digjitalizim të shërbimeve, mjedisi jetësor/ ndotja e ajrit, efikasiteti energjetik etj. me fokus të veçantë tek të rinjtë, grupet e marginalizuara dhe gratë.



QASJE NË DREJTËSI


→ zotim për promovim të qasjes efektive në shërbime juridike kualitative, efikase dhe komplementare të bazuara në bashkësinë për të gjithë qytetarët, veçanërisht për grupet e cenueshme përmes formave formale dhe joformale të ndihmës dhe shërbimeve juridike, politika zhvillimore për përfundim juridik etj, përgjegjsi, llogaridhënie dhe përfshirje me fokus të veçantë tek të rinjtë, grupet e marginalizuara dhe gratë.

³ Qasje në informacione, integritet dhe udhëheqje të mirë, transparencë fiskale, të dhëna të hapura, transparencë në nivel lokal, qasje në drejtësi, ndryshime klimatike

Në suaza të procesit të bashkëkrijimit, janë mbajtur 3 takime online informative-edukative, 12 takime online për identifikim të nevojave dhe problemeve, analizë të aktiviteteve që momentalisht po ndërmerren për zgjidhje të problemeve, institucionet e përfshira, portretizim i masave, punëtori për identifikim dhe zhvillim të zotimeve si dhe mbi 60 mbledhjeve individuale për përcaktim dhe harmonizim të propozim zotimet, takim ministerial për PHQ dhe dy e-punëtori në temë Transparencë dhe llogaridhënie në sektorin publik dhe Udhëheqje bazuar në interesat dhe nevojat e qytetarëve, të cilat mundësuan finalizim të zotimeve që janë pjesë e planit të ri për veprim.

Në kohën e pandemisë Covid-19, komunikimi dhe procesi i bashkëkrijimit ishte online, përmes informimit në kohë të duhur për proceset rrjedhëse, shfaqet online, thirrjet dhe mundësitë për përfshirje lidhur me PHQ në vend përmes portalit për PQH dhe Rrjetin për PHQ.

PJESËMARRJE DHE PËRFAQËSIM I PALËVE TË PREKURA NË PROCESIN E BASHKËKRIJIMIT



KORNIZA KOHORE PËR BASHKËKRIJIM TË PKV 5



Gjatë përgatitjes të këtij plani për veprim qeveria e RMV-së vazhdoi me praktikën e mirë për ndërlidhje të zotimeve nga plani për veprim me qëllimet e përcaktuara në agjendën për zhvillim të qëndrueshëm deri më 2030, veçanërisht me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të forta“, 3 „Shëndet i mirë dhe mirëqenie“ dhe 13 „Aksion klimatik“.

PKV5 më konkretisht identifikon lidhjet mes agjendës për partneritet të qeverisjes së hapur me 3 qëllime zhvillimore dhe 6 objektiva:



■ QËLLIMI 3 „SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE“

- **Objektivi 3.8:** : Të arrihet mbrojtje shëndetësore universale duke përfshirë edhe mbrojtjen nga rreziku financiar, qasje në shërbimet e domosdoshme kualitative shëndetësore dhe qasje në barna elementare dhe vaksina të sigurta, efektive, kualitative dhe të arritshme për të gjithë.



■ QËLLIMI 13 „AKSION KLIMATIK“

- **Objektivi 13.3** Të përmirësohet arsimi, ndërgjegjësimi dhe kapacitetet njerëzore dhe institucionale për zbutje të ndryshimeve klimatike, për rregullim, zvogëlim të ndikimeve dhe për paralajmërim të hershëm.



■ QËLLIMI 16 „PAQE, DREJTËSI DHE INSTITUCIONE TË FUQISHME“

- **Objektivi 16.3:** Promovim i sundimit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mundësim i qasjes së njëjtë në drejtësi për të gjithë.
- **Objektivi 16.5:** Ulje e ndjeshme e të gjitha formave të korupsionit dhe ryshfetit.
- **Objektivi 16.6:** Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënese dhe transparente në të gjitha nivelet.
- **Objektivi 16.7:** Të mundësohet vendimmarrje e përgjegjshme, përfshirëse, participative dhe përfaqësuese, në të gjitha nivelet
- **Objektivi 16.10:** Të mundësohet qasje në informacione dhe mbrojtje e lirive fundamentale, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Me realizimin e 23 zotimeve drejtëpërdrejt do të punohet drejt arritjes së përparimit për arritje të qëllimit 16, respektivisht do të kontribuojnë në përmirësimin e efikasitetit, llogaridhënies, transparencës së institucioneve duke promovuar qasje në drejtësi, qasje në informacione dhe mbrojtje e të drejtave fundamentale si dhe zvogëlim i korupsionit. Si shtesë

me dy zotimet do të punohet në mundësimin e përparimit në Qëllimin 3 dhe qëllimin 13 përkatësisht për promovim të kënaqësisë së qytetarëve nga shërbimet publike në sektorin e arsimit dhe atë shëndetësor, por edhe në mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe qasjen në këtë sferë.

Prandaj, përmes procesit të gjërë virtual konsultativ dhe praktikat ekzistuese të përparuara bazuar edhe në eksperiencat nga planet e mëparshme për veprim për partneritet të hapur qeveritar, këshillat dhe rekomandimet nga Sekretariati i PHQ, rekomandimet nga mekanizmi për njoftim të pavarur, propozimet kreative nga palët e interesuara dhe me përfshirje direkte të mbi 350 përfaqësuesve nga sektori qeveritar dhe ai i shoqërisë civile u pregadit propoyim plan kombëtar për veprim për Partneritetin për qeverisje të hapur për periudhën 2021-2023 në të cilën janë definuar 23 zotime, 95 arritje në 5 sfera prioritare.

SHQYRTIM PËRMBLEDHËS I ZOTIMEVE SIPAS SFERAVE PRIORITARE NË PKV 5-QEVERI E HAPUR



**TRANSPARENCË,
LLOGARIDHËNIE,
PROAKTIVITET DHE
PËRFSHIRJE**

- Shpallje publike e pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë lidhur marrëveshje për prokurime publike
- Shpallje proaktive e informacioneve me karakter publik në web-faqet e institucioneve
- Shpallje e informacioneve bazë për prokurimet publike në web faqet e institucioneve
- Përmirësim i qasjes në informacione dhe numri i të dhënave të hapura të shpallura në njësitë e vetëqeverisjes lokale (NJVL)
- Mundësim i qasjes pa pagesë në të dhënat për organizatat e shoqërisë civile
- Transparencë fiskale dhe llogaridhënie në nivel lokal dhe përmirësim i përfshirjes së qytetarëve përmes mekanizmave inovativë dhe mjeteve.



**PARANDALIM
I KORUSIONIT DHE
PROMOVIM I QEVERISJES
SË MIRË**

- Prokurimet publike si të dhëna të hapura
- Mekanizëm i përparuar për ndjekje të gjendjes pasurore të personave të zgjedhur dhe të emëruar
- Shpallje publike e lëndëve për zgjedhjen e personave të zgjedhur/emëruar nga Qeveria e RMV-së si udhëheqës të institucioneve



PËRMIRËSIM I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e punësimit
- Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera mbrojtjes shëndetësore preventive
- Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e arsimit
- Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e mundësimit të shërbimeve publike lokale
- E-shërbimet e disponueshme në zonat rurale
- Zmadhim i qasjes në format e garantuara të mbrojtjes së viktimave të trafikimit me njerëz
- Përmirësim i mekanizmave për mbrojtje të viktimave të shqetësimit në vend të punës
- Mundësim i qasjes në terapi dhe shërbime mjekësore të personave që përdorin droga pas vuajtjes së dënimit me burg



QASJE NË DREJTËSI

- Promovim i mbrojtjes së punëtorëve seksualë dhe personave që konsumojnë droga
- Promovim i qasjes në drejtësi të personave të rrezikuar social dhe qytetarëve në rrezik social
- Qasje në drejtësi për gratë që kanë pësuar dhunë familjare
- Përforsim juridik i qytetarëve përmes informacioneve të disponueshme dhe institucioneve të hapura



MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

- Zvogëlim i efekteve nga ndryshimet klimatike dhe mbrojtje e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore
- Qasje në informacione për nivelin e ndotjes së ajrit

* * *

Puna e qeverisë së hapur është zotim i vazhdueshëm dhe ky plan për veprim përmban një pjesë nga të mundshmet por përpjekje ambicioze për promovim të transparencës dhe llogaridhënies së Qeverisë, Parlamentit dhe Gjyqësorit.

Ky dokument promovon hapjen dhe mundësinë për zhvillim të mëtutjeshëm dhe thellim të prioritetëve të mëposhtme në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë palët e interesuara në sferën e Partneritetit për qeverisje të hapur.

I gjithë procesi i zbatimit dhe ndjekjes do të mbështetet nga Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës, Këshillit për PHQ dhe Rrjetit për PHQ.

QEVERI E HAPUR



1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJE

1.1. Shpallje publike e pronarëve të vërtetë të kompanive që kanë lidhur kontrata për prokurime publike

tetor 2021 - gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Në 27 janar 2021 dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut u vendos Regjistri i pronarëve të vërtetë që të rritet transparencja në strukturën pronësore të personave juridik në vend dhe të përmbushen standardet ndërkombëtare dhe ata të BE-së për luftën kundër larjes së parave dhe finansimit të terrorizmit. Personat juridik kishin afat deri më 27 prill të vitit 2021, pa kompenzim, të paraqesin të dhëna për pronarët e vërtetë.

Si pjesë e masave të përforcuara për llogaridhënie dhe përgjegjshmëri për ndihmën gjatë krizës që ua ndajnë vendeve për tu përballuar me pasojat nga pandemia me Covid-19, FMN kërkoi që vendet të cilëve u ndahet ndihmë (mes të cilave edhe RMV) të zbatojnë disa mekanizma mbrojtëse, mes të cilave edhe informacione publike për pronarët e vërtetë të kompanive që kanë fituar tendera nga shteti. Edhe pse kërkesa për këto informacione vjen si rezultat i përgjigjes ndaj korona-krizës dhe rreziqeve të rritura nga korupsioni, sidoqoftë, mbetet standard në prokurimet publike të shumë vendeve në botë.

Deri më tani, vendosja e mekanizmit të tillë në RMV nuk ka qenë e mundshme, përshkak mos ekzistimit të Regjistrimit të pronarëve të vërtetë. Nga ana tjetër, prokurimet publike në vend vazhdimisht lidhen me korupsion të përhapur dhe keqpërdorime, dyshime për marrëveshje të kompanive dhe krijim i konkurrencës artificiale me çka nuk mund të garantohet se fitohet vlerë më e mirë për paratë e harxhuara. Edhe në raportin e fundit të Departamentit të Shtetit për klimën për investim në Republikën e Maqedonisë së veriut theksohet korupsioni (dhe nepotizmi) në prokurimet publike si problem për investitorët.

Transparenca e të dhënave nga ky regjistër mundëson ndërlidhje të të dhënave për atë se kush e zotëron personin juridik, kush e kontrollon dhe kush ka dobinë më të madhe nga ajo. Kjo ndihmon të shtypet korupsioni, të zvogëlohen rreziqet investuese dhe të rritet udhëheqja e mirë.

Qëllimi kryesor i zotimit

Zotimi përfshin shpallje publike të informacionit lidhur me pronarët e vërtetë të kompanive që kanë lidhur kontrata për prokurime publike në sistemin elektronik për prokurime publike, në pjesën ku shpallen Njoftimet për Kontratat e lidhura dhe Kontrata për prokurim publik.

Në këtë mënyrë edhe më tej do të parandalohet korupsioni, respektivisht do të parandalohet që para publike të mbarojnë në xhepa privatë të funksionarëve; do të zbulohet dhe do të ndalohet marrëveshja jolegale mes kompanive në prokurimet publike dhe do të ndalohet konkurrenca fiktive në tenderat nga kompanitë e pronarëve të njëjtë të vërtetë. Nga ana tjetër do t'i mundësohet publikut të ndjekë racionalitetin në shpenzimin e parave publike; detektimi i të ashtuquajturave drita të kuqe për korupsion dhe do të mbështetet përgjegjshmëria në shpenzimin e parave publike.

Si do të kontribuojë zotimi në zgjidhjen e problemit publik?

Transparenca në prokurimet publike llogaritet mjet kryesor për zvogëlim të korupsionit dhe mundësim të konkurrencës fer dhe konkurrese mes kompanive. Transparenca do të thotë informacione të disponueshme publikisht për të gjithë ciklin e prokurimeve publike që ti bëjë prokurimet më të përgjegjshme. Mes këtyre informacioneve bëjnë pjesë edhe informacionet për atë se kush qëndron pas kompanive që fitojnë tendera shtetërorë. Në këtë mënyrë, nuk mendohet vetëm për drejtorët dhe personat përgjegjës, por edhe për pronarët e vërtetë që janë konsumuesit final dhe që e kontrollojnë kompaninë. Këto informacione deri më tani nuk kanë qenë të njohura, poashtu nuk kanë qenë të disponueshme jo vetëm për kompanitë që fitojnë tendera publik, por në përgjithësi për të gjitha kompanitë në vend. Me krijimin e Regjistrimit të pronarëve të vërtetë dhe me shpalljen publike të emrave të pronarëve të vërtetë të kompanive, mundësohet që ky informacion të jetë i njohur edhe për operatorët ekonomik që kanë fituar tendera, respektivisht kanë lidhur kontrata për prokurime publike. Në këtë mënyrë do të veprohet para së gjithash në mënyrë preventive në parandalimin e korupsionit, por gjithashtu do të mund të zbulohen dhe ndalohen marrëveshjet koruptive në prokurimet publike. Edhe pse është e detyrueshme personat që janë të përfshirë në dhënien e pëlqimit për lidhje të kontratave të deklarojnë mospasje interesi në asnjë procedurë ose nëse kanë të tërhiqen nga vendimmarrja, sidoqoftë ajo bëhet vetëm në lidhje me personat e njohur të kompanisë (drejtor, pronar dhe të ngjashme). Por, jashtë kësaj mase preventive mbeten pronarët e vërtetë të cilët deri më tani nuk kanë qenë të njohur.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

Me këtë masë do të ndalohen kompanitë të cilat kanë konflikte të tilla interesi të mos konkurojnë fare në tendera, por edhe nëse ndodh, më lehtë do të zbulohet ekzistimi i konfliktit të tillë dhe do të parandalohet veprimi koruptiv. Pritet që ky zotim të ndikojë pozitivisht edhe mbi rritjen e konkurrencës, respektivisht të mundësojë hyrje edhe të kompanive tjera në prokurime publike që në mënyrë të pashmangshme sjell deri te rritja e kualitetit të prokurimeve dhe përmirësim të shërbimeve publike. Njëkohësisht, në këtë mënyrë mbështeten llogaridhënia dhe qeverisja e mirë e institucioneve sepse publikisht shpallen të dhënat edhe për pronarët e vërtetë të fituesve të tenderave.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione plotësisht të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve për prokurimet publike dhe rrumbullakson vëllim të caktuar informacionesh me të cilat mund të zbulohet dhe të parandalohet korupsioni dhe e përmirëson qasjen në informacione nga ana e publikut me atë që kjo e dhënë do të jetë publike, lehtë dhe pa pagesë e disponueshme deri te qytetarët.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon dhe përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrjen publike dhe ndikimin në krijimin e vendimeve përmes së cilës organizatat e shoqërisë civile dhe gazetarët hetues do të mund të zbulojnë dhe të theksojnë veprimet e detektuara korruptive. ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon dhe përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nuk nevojitet buxhet shtesë sepse bëhet fjalë për marrje automatike të informacioneve ekzistuese nga RQRMV dhe shpallje e tyre në web fagen qeveritare për prokurime publike SEPP ku tashmë ekziston mundësi teknike e tillë.

Lidhje me qëllimet Globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhur me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.10: Të mundësohet qasje në informacione dhe mbrojtje e lirive fundamentale, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe Objektivi 16.5: Zvogëlim i konsiderueshëm i të gjitha formave të korupsionit dhe ryshfetit. Me masat e këtij zotimi kontribuohet në përmirësimin e qasjes në informacione të karakterit publik përmes zbatimit më efikas të ligjeve dhe informim më i mirë i qytetarëve.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.1.1	Është rënë dakort kriteriumi për publikim të pronarëve të vërtetë për kontratat për prokurime publike, për mënyrën e zbatimit të zotimit dhe për parakushtet e nevojshme ligjore dhe teknike për atë.	1. Është arritur marrëveshje për kriteriumin (kufirin e vlerës) për cilat kontrata do të publikohen pronarët e vërtetë për kontratat për prokurime publike (po/jo) 2. Është arritur marrëveshje për zgjidhjen konkrete teknike për marrje automatike të të dhënave për pronarët e vërtetë nga Regjistri qendror dhe SEPP (po/jo)	MF, RQRMV dhe BPP	tetor 2021	gusht 2022
1.1.2	Janë publikuar emrat e pronarëve të vërtetë të subjekteve që janë bartës të kontratave për prokurime publike	1. Numri i kontratave të lidhura sipas kriteriumit të dakorduar (kufirit të vlerës së kontratës) për të cilat publikohen pronarët e vërtetë	BPP	tetor 2022	Në vazhdimësi

Zotimi është i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

RQRMV dhe BPP

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

RQRMV, Vladimir Naumovski
BPP, Goran Davidovski

Funksioni, Departamenti

Këshilltar i drejtorit për zhvillim informatik,
RQRMV

Ndihmës udhëheqës i Sektorit për ndjekje
të sistemit për prokurime publike dhe
udhëheqje me SEPP, BPP

Email

vladimir.naumovski@crm.org.mk
goran.davidovski@bjn.gov.mk

Telefon

+389 2 3288 130, mob. +389 75 284 050
+389 2 3255 693

Ministri/
Agjencione

MF dhe SP i QRMV

Subjektet e tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civike,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Qendra për
komunikime
qytetare, German
Filkov,
gfilkov@ccc.org.mk





1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJE

1.2. Publikim proaktiv i informacioneve me karakter publik në web faqet e institucioneve

tetor 2021–gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Zotimi i referohet të ashtuquajturës transparencë aktive që nënkupton publikim të informacioneve në iniciativë vetanake pa dorëzuar dikush kërkesë për qasje tek ato informacione me karakter publik.

Zotimi duhet të iu mundësojë qytetarëve, kompanive dhe të gjithë grupeve të interesuara qasje të shpejtë, të lehtë dhe të vazhdueshme në informacionet bazë për punën e institucioneve shtetërore.

Edhe pse nga fundi i vitit 2019, me Ligjin e ri mbi qasje të lirë në informacionet me karakter publik, publikimi i këtyre informacioneve në web faqet e institucioneve është i detyrueshëm, sidoqoftë një numër shumë i vogël prej tyre e zbatojnë këtë detyrim. Sipas Indeksit të fundit për transparencë aktive për vitin 2021 nga QKQ, ministrinë dhe Qeveria publikojnë mesatarisht 79% të këtyre informacioneve, ndërsa komunat vetëm 60%. Përqindjet individuale lëvizin nga 10% deri në 100%. E njëjta matje në ndërmarrjet publike tregon që publikohen 41% nga këto informacione. Vlerësohet se tek institucionet tjera (rreth 1.200) të cilat nuk janë nën monitorim të sektorit të shoqërisë civile, publikimi është edhe më i vogël, dhe është me rëndësi të njëjtë për jetën e qytetarëve.

Ndërkohë, Qeveria ndërmerr disa masa për inkurajim të publikimit të këtyre informacioneve, por përsëri vetëm tek institucionet qeveritare, tek komunat dhe ndërmarrjet publike themelues i të cilës është vetë ajo.

Edhe Enti shtetëror për auditim, në raportin nga auditimi i suksesit për Kualitetin e shërbimeve që i ofrojnë NJVL përmes web portaleve të tyre konstaton se "Kualiteti ekzistues i shërbimeve që i ofrojnë NJVL në web portale nuk ofron shërbim efektiv dhe të shpejtë dhe nuk ofron trajtim të njëjtë, qasje të njëjtë dhe disponueshmëri për çdo qytetar.

Qëllimi kryesor i zotimit

Zotimi përfshin përpjekje të përforcuara nga Agjencioni për ruajtje të të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik për përmirësim të transparencës aktive tek mbajtësit e informacioneve.

Para se të fillojnë përpjekjet e përforcuara për transparencë aktive tek institucionet qeveritare dhe komunat, në vitin 2016, publikimi mesatar tek këto institucione ishte 45%, ndërsa para këtyre aktiviteteve tek ndërmarrjet publike, ata publikonin vetëm 28% të informacioneve. Duke marrë parasysh rritjen e transparencës aktive tek këto institucione pas marrjes së masave konkrete, pritët përmirësim edhe në institucionet tjera.

Me realizimin e zotimi do të rritet disponueshmëria e informacioneve që janë të rëndësishme për jetën dhe punën e njerëzve, ndërsa do të zvogëlohet presioni për marrje të informacioneve përmes kërkesave për qasje të lirë.

Qasja e përshtatshme dhe në kohë të duhur në informacione është parakusht për pjesëmarrje efektive e qytetarëve në krijimin e politikave dhe për marrje kualitative dhe në kohë të duhur të shërbimeve nga institucionet shtetërore.

Si do të kontribuojë zotimi për zgjidhjen e problemit publik?

Llogaritet që vetë detyrimi për institucionet që të informojnë në nivel vjetor për shkallën e respektimit të nenit 10 të ligjit, përkatësisht për vëllimin e publikimit të informacioneve bazë për punën e tyre do të kontribuoj në rritjen e publikimit të këtyre informacioneve dhe respektim të nenit 10, për mosrespektimin e të cilës nuk janë paraparë dispozita për kundërvajtje në ligj.

Me përpilimin dhe publikimin e raportit për respektim të nenit 10, do iu mundësohet qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të kenë qasje më të madhe në shkallën e publikimit të informacioneve bazë nga ana e institucioneve, me çka do të rrisin presionin mbi institucionet për publikim të më shumë informacioneve.

Ndryshe, me realizimin e zotimit, institucionet do të zbardhin:

- Informacione për rregulloren dhe vendimet e autoriteteve, me çka realizohet e drejta e qytetarëve të jenë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre në shoqëri;
- Informacione që iu nevojiten qytetarëve për të kërkuar përgjegjësi nga autoritetet;
- Informacione që janë të pashmangshme për qytetarët që të mund të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe
- Informacione që iu nevojiten qytetarëve që të mund të kenë qasje në shërbimet që i ofrojnë institucionet publike.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

Edhe vetë institucioni që publikon informacione mbi bazën proaktive realizon përfitime në disa baza:

- Transparenca aktive i ndihmon institucionit të jetë më i përgjegjshëm në shpenzimin e parave publike;
- Në këtë mënyrë institucioni promovon parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit dhe
- Institucioni është më efikas sepse më mirë menaxhon me informacionet me të cilat disponon.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione më të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën mbi informacionet.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon ose i përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikimin në krijimin e vendimeve dhe krijon ose përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon dhe përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nuk nevojitet buxhet shtesë sepse të gjithë aktivitetet e parapara janë pjesë e funksionimit të rregullt të institucioneve, si dhe të Agjencionit për mbrojtje të të drejtës së qasjes së lirë në informacione me karakter publik (AQLI).

Zotimi është i lidhur me Strategjinë kombëtare për parandalim të korupsionit dhe konfliktin e interesit 2021-2025, Strategjinë për transparencë në Qeverinë e RMV, Planin për luftë kundër korupsionit në Qeverinë e RMV, rekomandimet nga Analiza funksionale në AQLI.

Ligje me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektiva 16.10: Të mundësohet qasje në informacione dhe mbrojtje e lirive fundamentale, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Me masat e këtij zotimi kontribohet në përmirësimin e qasjes në informacione me karakter publik përmes zbatimit më efikas të ligjeve dhe informimit më të mirë të qytetarëve.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.2.1	Vendosje e detyrimit për çdo institucion-bartës i informacionit, detyrimisht të informojë në raportin e tij vjetor që e dërgon në AQLI edhe për zbatimin e nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik i cili parasheh detyri për bartësit e informacioneve të i publikojnë të gjithë informacionet rreth funksionimit të tyre në web faqet e tyre	1. Përqindje e institucioneve (duke filluar nga viti 2021) që kanë dorëzuar raport vjetor deri te AQLI përfshijnë informacione për zbatimin e nenit 10 (objektiv 50%) (nga 1440 bartës të informacioneve, në vitin 2020 raport deri te AQLI kanë dërguar 1132 institucione, përkatësisht 79 % e institucioneve).	Të gjithë bartësit e informacioneve me karakter publik	janar 2022	Në vazhdimësi
1.2.2	Është vendosur detyrim për AQLI për publikim të informacionit përmbledhës në raportin e saj vjetor edhe për zbatimin e nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë, në bazë të raporteve të pranuar nga bartësit e informacioneve.	1. Numri i institucioneve për të cilat AQLI ka publikuar informacione në raportin vjetor për zbatim të nenit 10	AQLI	prill 2022	Në vazhdimësi

Zotimi është vazhdim i zotimeve të mëparshme

Institucion udhëheqës për zbatim	AQLI	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Petar Gajdov Oliver Serafimovski	
Funksioni, Departamenti	Ndihmës udhëheqës Këshilltar, Departamenti për bashkëpunim me bartësit e informacioneve dhe informim të publiku	
Email	petar.gajdov@aspi.mk oliverserafimovski@komspi.mk	
Telefon	+389 2 3118 038	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	SP i QRMV
	Organizatave shoqërisë civile, sektori privat, grupet e punës dhe multilaterale	Qendra për komunikime qytetare German Filkov, gfilkov@ccc.org.mk +389 2 3213 513





1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJE

1.3. Publikim i informacioneve bazë për prokurimet publike në web faqet e institucioneve

tetor 2021– gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Të dhënat bazë për shpenzimin e parave publike përmes tenderave janë të disponueshme në portalin qeveritar Sistemi elektronik i prokurimeve publike (SEPP).

Qëllimi bazë i këtij portali është zbatimi i prokurimeve publike në mes institucioneve shtetërore dhe kompanive. Portali është i destinuar për personat për prokurime publike në institucione dhe kompani, të cilët paraprakisht janë trajnuar për përdorim të tij. Prandaj, transparenca e të dhënave për prokurimet publike nuk është funksioni primar i këtij portali. Me atë, të dhënat bazë për shpenzimin e parave të qytetarëve përmes prokurimeve publike mbeten të vështira për tu arritur për rrethin më të gjërë të qytetarëve dhe palët tjera të interesuara dhe për dallim nga vendet tjera, qytetarët nuk kanë qasje të shpejtë, të thjeshtë, të lehtë dhe të kuptueshme në shpenzimin e parave publike.

Dy hulumtime të njëpasnjëshme në Qendrën për komunikime qytetare mbi shkallën e informimit të qytetarëve për shpenzimin e parave publike përmes prokurimeve publike të realizuara mbi 400 të anketuar nga i gjithë vendi, në vitin 2017 dhe 2019 tregojnë që me ndërmarrje të disa masave të caktuara të ngjashme, përqindja e qytetarëve që vlerësojnë se kanë mjaftueshëm informacione për mënyrën në të cilën institucionet shpenzojnë paratë publike përmes tenderave është zmadhuar nga 6% në 20%, vetëm për tre vite. Në të dy hulumtimet, madje 98% nga qytetarët janë përgjigjur se informacionet që tani i kanë për këto shpenzime i marrin nga web faqet e institucioneve dhe nga mediumet. Prandaj, nevojitet që institucionet me patjetër të duhet të publikojnë më shumë informacione për këto shpenzime në web faqet e tyre, si vende në të cilat qytetarët më së shumti i kërkojnë dhe presin që ti gjejnë këto informacione.

Në dy planet paraprake për veprim nga PHQ u zbatuan zotime dhe aktivitete si parakushte për këtë zotim. Fillimisht u përpilua lista e informacioneve si standard minimum për transparencë në prokurimet publike, pastaj Byroja për prokurime publike mundësoi funksionalitet të ri të SEPP me të cilën krijohen linqe të shkurtëra të publikimeve të SEPP të cilat mund të përdoren për publikim të informacioneve të tilla në web faqet e institucioneve.

Qëllimi kryesor i zotimit

Në këtë mënyrë çdo institucion publikimet në SEPP mundet në mënyrë të shpejtë, të lehtë dhe të thjeshtë ti publikojë në web faqen e saj ku në një vend të vetëm do të jenë të disponueshme të gjithë informacionet bazë për prokurimet e saja publike. Domethënë, në profilin e çdo administruesi lokal të regjistruar në SEPP janë shtuar "HTML" etiketime për "iFrame" i cili përmban informacionet mbi prokurimet e planifikuara, njoftimet, njoftimet lidhur me kontratat e lidhura dhe njoftimet mbi kontratat e realizuara për atë organ kontraktues. Këto etiketime "HTML" nevojitet që të kopjohen dhe të vendosen në web faqen e institucionit.

Zotimi përfshin detyrimin për institucionet/organet kontraktuese të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit mbi prokurimet publike për të krijuar pjesë të veçantë (tab) në web faqet e tyre për "prokurime publike" dhe atje, në një vend, ti publikojnë informacionet dhe dokumentet në vijim: plan vjetor për prokurime publike, njoftime mbi prokurimet publike (link nga publikimi në SEPP), njoftime mbi kontratat e lidhura (link nga publikimi në SEPP), kontratat e lidhura dhe njoftimet për kontratat e realizuara (link nga publikimi në SEPP).

Qëllimi është që qytetarët të kenë qasje të shpejtë, të lehtë, të thjeshtë dhe të kuptueshme në informacione për mënyrën në të cilën institucionet shpenzojnë paratë përmes prokurimeve publike (rreth 900 milionë euro në vit) ashtu që institucionet do ti publikojnë këta informacione në web faqet e tyre, të cilat janë pika e parë në të cilën qytetarët drejtohen kur duan të informohen për ndonjë institucion konkret.

Si do të kontribuojë zotimi në zgjidhjen e problemit publik?

Qasja e shpejtë, e lehtë, e thjeshtë dhe e kuptueshme në këto informacione për qytetarët do ti rrisë llogaridhënien e institucioneve dhe përgjegjësinë e tyre në shpenzimet publike, ndërsa qytetarëve do t'iu mundësojë të kuptojnë si dhe për çka shpenzohen paratë e tyre dhe të ndikojnë në përdorimin e mjeteve publike për nevojat e tyre.

Me atë që publikimi i informacionete është shumë i thjeshtësuar dhe mund të bëhet vetëm me kopjimin e etiketimeve "HTML" nga SEPP dhe vendosja e tyre në web faqen e institucionit, do të tejkalohen edhe problemet e tanishme të mospasjes së stafit mjaftueshëm profesional TIK në institucione dhe mbingarkesa e personave për prokurime publike sepse për publikim të informacioneve nuk nevojitet profesionalizëm i veçantë dhe nuk merr kohë.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione më të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve me të cilat disponojnë qytetarët dhe organizatat shoqërisë civile dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundësojnë të drejtën mbi informacionet.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon ose përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve dhe krijon ose përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon ose përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nuk nevojitet buxhet shtesë sepse funksionaliteti i nevojshëm i SEPP për krijim dhe marrje të lehtë dhe të shpejtë të linqeve nga informacionet e publikuara dhe vendosja e tyre në web faqet e institucioneve tashmë ekziston. Tek institucionet tjera nevojitet vetëm krijimi i tab-it të veçantë (ata që nuk kanë) për të cilën nuk nevojiten mjete të veçanta financiare. Do të nevojiten mjete shtesë buxhetore tek institucionet që tashmë nuk kanë web faqe të tyre që ti krijojnë.

Ndërlidhje me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.10: Të mundësohet qasje në informacione dhe mbrojtje e lirive fundamentale, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Me masat e këtij zotimi kontribuohet për përmirësim të qasjes në informacione me karakter publik përmes zbatimit efikas të ligjeve dhe informim më të mirë të qytetarëve.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.3.1	Është krijuar pjesë (tab) i veçantë për "prokurime publike" në web faqet e institucioneve (organeve kontraktuese)	1. Përqindje e institucioneve kanë krijuar pjesë të veçantë në web faqet e tyre për "prokurime publike" (Objektiv 50%) (Sipas raportit të fundit të MSHIA nga regjistri i të punësuarve në sektorin publik, në vend aktivë janë 1332 institucione publike)	Të gjithë organet kontraktuese në vend	tetor 2021	mars 2022
1.3.2	Publikohen në web faqen e çdo institucioni (në pjesën për "prokurime publike") informacionet dhe dokumentet si në vijim: → plan vjetor për prokurime publike (me të gjitha ndryshimet dhe shtesat); → njoftime mbi prokurimet publike (linqe nga publikimet në SEPP); → njoftime për kontratat e lidhura (link nga publikimet në SEPP); → kontratat e lidhura për prokurime publike dhe → njoftime për kontratat e realizuara (linqe nga publikimet në SEPP).	1. Përqindje e institucioneve që i publikojnë rregullisht të dhënat bazë mbi prokurimet publike të tyre (Objektiv: 50%)	Të gjithë organet kontraktuese në vend	prill 2022	Në vazhdimësi

Bëhet fjalë për zotim të vazhdueshëm të plotësuar

Institucion udhëheqës
për zbatim

SP i QRMV

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Maja Petkovska Leses
Neda Gacova

Funksioni, Departamenti

Këshilltar shtetëror

Email

maja.petkovska@gs.gov.mk
nedagacova@gmail.com

Telefon

+389 2 3118 022

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

BPP

Institucione publike

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe të punës
dhe multilaterale

Qendra për
komunikime
qytetare, German
Filkov,
gfilkov@ccc.org.mk
+389 2 3213 513





1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJE

1.4. Përmirësim i qasjes në informacione dhe numrit të të dhënave të publikuara në njësitet e vetëqeverisjes lokale (NJVL)

tetor 2021 – gusht 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Transparenca dhe hapja e NJVL ende është në nivel të ulët. Shumica e NJVL në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk i publikojnë të gjithë të dhënat dhe informacionet që janë detyrim i tyre ligjor. Gjithashtu, shumica e komunave nuk publikojnë të dhëna të formatit të hapur. NJVL nuk kanë informacione saktë me cilat sete të të dhënave të karakterit publik disponojnë. Njohja dhe vetëdija për të dhënat e hapura, si dhe benefitet që bartin ata, është në nivel shumë të ulët tek zyrtarët lokal por edhe tek organizatat lokale të shoqërisë civile. Nevojitet të rritet vetëdija për të dhënat e hapura tek të gjithë palët e interesuara në proces.

Hulumtimi përmes Indeksit të hapjes për vitin 2020, kryer nga Fondacioni Metamofrozis, tregoi që pushteti lokal përmbush 40% të treguesve për hapje. Ky vlerësim mesatar tregon nivelin e ulët të përkushtimit të komunave për përmbushjen e parimeve të hapjes.

Ekziston nevoja e sigurimit të qasjes më të lehtë në informacione për funksionimin e pushtetit lokal, promovimin e qasjes përfshirëse në marrjen e vendimeve dhe publikimin e numrit më të madh të setit të të dhënave në format të hapur.

Qëllimi kryesor i zotimit

Kushte të përmirësuara dhe kapacitete të zmadhuara për transparencë më të madhe dhe hapje të pushtetit lokal. Publikim i minimum nga 5 sete të dhënash në format të hapur në secilën nga 30 NJVL.

Kuptim më i mirë i konceptit të të dhënave të hapura në nivel lokal nga ana e të gjithë personave të interesuar në proces, si dhe zmadhim i vetëdijes për përfitimet e të dhënave të hapura.

Si do të kontribojë zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Me qëllim që të fitohet informacion për nivelin e hapjes së NJVL do të zbatohet matje e punës së të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut në lidhje me parimet e transparencës, qasjes, efikasitetit dhe integritetit, përmes Indeksit të hapjes. Në bazë të vlerësimit të bërë do të jepen rekomandime për përmirësim të transparencës dhe hapjes në funksionimin e NJVL.

Me qëllim përmirësimit të njohjes së konceptit të të dhënave të hapura dhe promovim të transparencës në nivel lokal do të zbatohen trajnime për përfaqësuesit e komunave dhe për organizatat e shoqërisë civile.

Me qëllim publikimin e më shumë informacioneve, dokumenteve dhe të dhënave të hapura nga ana e NJVL, do të angazhohen lehtësues (facilitator) për mbështetje të komunave në publikimin e më shumë informacioneve dhe përgatitjen dhe publikimin e seteve të të dhënave në format të hapur.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione më të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën mbi informacionet.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve dhe përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE sepse promovon mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionarëve.

Informacione shtesë

Aktivitetet do të zbatohen në korniza të Projektit të USAID-it për pjesëmarrje të shoqërisë civile i implementuar nga Fondacioni Metamorfozis, në bashkëpunim me MVL dhe NJVL.

Zotimi është i lidhur me realizimin e qëllimeve nga Strategjia e të dhënave të hapura.

Për realizim të suksesshëm të aktiviteteve nevojitet bashkëpunim i afërt me NJVL.

Lidhshmëri me qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjithë nivelet.

Me masat nga ky zotim kontribohet në përmirësim të transparencës dhe hapjes në nivel lokal. Me këtë zotim do të përmirësohet qasja, disponueshmëria, përdorimi dhe shfrytëzimi i informacioneve dhe të dhënave me karakter publik.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
14.1	Njësiti e vetëqeverisjes lokale marrin pjesë në zbatimin e matjeve të hapjes së njësive të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes Indeksit të hapjes	1. Është kryer hulumtim dhe është publikuar raport nga hulumtimi i vitit 2021 (po/jo) 2. Është kryer hulumtim dhe është publikuar raport nga hulumtimi për vitin 2022 (po/jo)	MVL, Fondacioni Metamorfozis	tetor 2021	gusht 2022
14.2	Njohuri të përparuara për transparencën dhe të dhënat e hapura përmes mbajtjes së trajnimeve me përfaqësues të komunave	1. Numri i trajnimeve të mbajtura për përfaqësuesit e komunave (Objektiv: më së paku 2 trajnime) 2. Numri i përfaqësuesve të komunave të cilët marrin pjesë në trajnime (Objektiv: më së paku 20 pjesëmarrës)	MVL, Fondacioni Metamorfozis	nëntor 2021	mars 2022
14.3	Mundësim i mbështetjes direkte të 30 NJVL (përmes lehtësuesve) për përmirësim të transparencës dhe hapjes së tyre	1. Numri i seteve të publikuara të të dhënave në format të hapur nga 30 NJVL (Objektiv: 5 sete të dhënash nga çdo komunë)	MVL, Fondacioni Metamorfozis	dhjetor 2021	prill 2022

Zotimi është pjesërisht i ndërlidhur me zotimin 5
- Transparencë në nivel lokal PKV 4

Institucion udhëheqës për zbatim	MVL	
Emri i personit përgjegës për zbatim	Eli Çakar	
Funksioni, Departamenti	Këshilltar shtetëror	
Email	elicakar@gmail.com	
Telefon	/	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	MSHIA/NJVL
	Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	Fondacioni për internet dhe shoqri Metamorfozis Marijana Jançeska marijana@metamorphosis.org.mk





1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFSHIRJEE

1.5. Mundësim i qasjes pa pagesë në të dhëna për organizatat e shoqërisë civile

tetor 2021-maj 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Sipas Regjistrimit qendror të RMV ka 15.581 shoqata dhe fondacione të regjistruara, në pajtim me Ligjin për shoqatat dhe fondacionet. Regjistri qendror në pajtim me nenin 47 të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet, e në lidhje me prioritetin „Shoqëria civile“ nga Plani 3-6-9 i Qeverisë së RMV, publikon listë të organizatave të shoqërisë civile të formatit të hapur (excel), e disponueshme në linkun e mëposhtëm: <https://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/gragjanski-organizatsii>.

Momentalisht, informacionet që publikohen në kuadër të kësaj liste janë: emri i organizatës, numri amë dhe kontakti dhe email adresa.

Përmes mundësisë për kërkim individual sipas emrit të subjektit ose numrit amë <https://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/osnoven-profil-na-registriran-subjekt>, për çdo subjekt mund të fitohen informacionet në vijim, pa kompenzim financiar shtesë: NUIS; NUT; Emri i plotë; Emri i shkurtë; Data e krijimit; Forma juridike; Statusi juridik; Adresa; Informacione shtesë (në falimentim/në likuidim); Aktiviteti mbizotërues; Madhësia.

Në pajtim me nenin 47 të Ligjit për shoqatat dhe fondacionet, është definuar se në këto regjistre shkruhen: emri i plotë i organizatës dhe emri i shkurtër nëse e ka; selia; akti i krijimit; data e krijimit; emri, mbiemri dhe numri amë i themeluesve; data e sjelljes, përkatësisht ndryshimit dhe plotësimit të statusit; koha e paraparë për të cilën krijohet organizata; qëllimet dhe aktiviteti; emri, mbiemri dhe numri amë i përfaqësuesit ligjot; të dhënat për njësitë organizative (filiale, zyra dhe të ngjashme); të dhëna për statusin e organizatës me interes publik; të dhënat mbi ndryshimet statusore; të dhëna për falimentimin dhe likuidimin; shënim për fillimin e procedurës për ndalim të kryerjes së aktivitetit, ndalim të punës dhe; numri dhe data e vendimit për regjistrim, ndryshim të të dhënave dhe vendim për fshirje nga regjistrimi në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) i këtij Ligji.

Mund të konkludojmë, se në këtë moment, pa pagesë mes të tjerave nuk janë të disponueshme: akti i themelimit, informacione mbi themeluesit dhe personat e autorizuar, qëllime dhe aktivitete, statusi i organizimit me karakter publik.

Në kuadër të proceseve për krijim të politikave, pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile llogaritet si minimum demokratik. Për atë qëllim institucionet përdorin metoda të ndryshme, mes të cilave edhe krijojnë regjistra të veçantë, si për shembull Sekretarijati për çështje evropiane <https://www.sep.gov.mk/post/?id=706> ose Këshilli për bashkëpunim me dhe zhvillimi i shoqërisë civile https://www.nvosorabotka.gov.mk/sites/default/files/4.%D0%9Ebrazec_Registar_GO_0.pdf.

Edhe aktorët joshitetërorë, të cilët kanë nevojë për konsulta më të gjëra, komunikim dhe rrjetëzim përdorin regjistrat që i krijojnë vet, psh Dialog drejt BE-së <https://bit.ly/3wnsQ1O> ose Civica Mobilitas <https://civicamobilitas.mk/adresar/>.

Edhe organizata ndërkombëtare dhe ndërshtetërore shpesh lëshohen në aktivitete që kanë qëllim të locojnë organizata nga sfera të ndryshme, për shembull UNICEF https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3541/file/MK_MappingCSOsCWD_Report_MK.pdf.

Nevoja e krijimit të regjistrave të veçantë (përkatësisht baza të të dhënave për shoqatat dhe fondacionet) u paraqit për arsye të mungesës së qasjes në të dhënat e hapura për organizatat e shoqërisë civile të cilat janë të evidentuara në Regjistrin qendror në pajtim me Ligjin mbi shoqatat dhe fondacionet, të cilat rregullisht azhurohen dhe të cilat përdoruesit mund ti kërkojnë përmes bazave të ndryshme, për qëllime të ndryshme. Regjistrat ekzistues të mësipërm që udhëhiqen jashtë Regjistrit qendror nuk e mundësojnë atë, janë të pjesëshme dhe harxhohen mjete pa nevojë për të njëjtin qëllim.

Përveç kësaj, momentalisht në listën e organizatave të shoqërisë civile, janë evidentuar forma të ndryshme të asociacioneve civile, nga shoqatat, dhomat, shoqëri sportive, grupe tifozerie, shoqata të shoferëve, shoqata të të pensionuarve, grave dhe të ngjashme. Pa informacione shtesë për secilin nga subjektet nuk mund të bëhet vlerësim i strukturës së shoqërisë civile.

Qëllimi kryesor i zotimit

1. Qëllimi kryesor i zotimit
2. Përparim i transparencës së shoqërisë civile;
3. Përparim i përfshirjes në proceset e krijimit dhe ndjekjes së politikave publike përmes mundësisë për targetimit tematik, gjeografik ose të ndonjë lloji tjetër të organizatave të shoqërisë civile.;
4. Dizajnim i duhur i politikave për zhvillim të shoqërisë civile, duke patur parasysh specifikat e subjekteve të regjistruara në pajtim me Ligjin mbi shoqatat dhe fondacionet;
5. Zvogëlim i barrës administrative mbi shoqatat dhe proceset për aplikim për mbështetje financiare tek donatorët publik dhe privat.

Si do të kontribuojë zotimi në zgjidhjen e problemit publik?

1. Zgjerim i të dhënave të hapura për organizatat e shoqërisë civile me të dhënat e disponueshme në kërkimin individual si shërbime ekzistuese

Zgjerim i të dhënave që Regjistri qendror i publikon në organizatat e shoqërisë civile në format të hapur (Lista e organizatave të shoqërisë civile) papagesë në web lokacionin <http://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/gragjanski-organizatsii> me të gjithë të dhënat që janë të disponueshme publikisht dhe pa pagesë përmes shërbimit Profili bazë i subjektit të regjistruar (<http://www.crm.com.mk/mk/otvoreni-podatotsi/osnoven-profil-na-registriran-subjekt>).

Të dhënat do të merren nga gjendja aktuale-momentale në Regjistrin e shoqatave dhe aleanca, Regjistrin e fondacioneve dhe Regjistrin e formave organizacionale të organizatave të huaja (3 të definuara në Ligjin mbi shoqatat dhe fondacionet) dhe do të azhurohen më së paku një herë në muaj.

Me zgjerimin e të dhënave do të mundësohet filtrim përmes kërtimeve në baza të ndryshme, për shembull sipas selisë, formës juridike, madhësisë etj, që do të zmadhojë vlerën e tyre të përdorimit. Duke patur parasysh se për të dhënat është përgjegjës Regjistri qendror, të njëjtat do të azhurohen dhe do të kompletohen. Regjistrat që momentalisht i udhëheqin institucionet tjera shtetërore dhe aktorët joshtetërorë, janë pjesërisht (vetëm me informacione mbi organizatat që janë regjistruar për nevojat e tyre) dhe pa mekanizma të qëndrueshëm për azhurim të të dhënave.

Këto informacione do ti shërbejnë vetë organizatës së shoqërisë civile, donatorëve dhe organizatave ndërkombëtare, kur ata organizojnë procese konsultative ose kanë nevojë të diseminojnë informacione. Gjithashtu, përshkak të disponueshmërisë publike të këtyre informacioneve, procesi i aplikimit për mbështetje financiare (publike dhe private), do të mund të lehtësohet deri në një masë në aspekt administrativ.

2. Mundësim i qasjes në raporte dinamike me të dhëna të regullueshme për organizatat e shoqërisë civile për përdoruesit e buxhetit (pushteti qendror dhe lokal)

Edhe pse Regjistri qendror ofron qasje pa pagesë në informacione për institucione shtetërore, e dukshme është që një pjesë e institucioneve nuk janë të informuara për mundësinë, ndërsa një pjesë të tyre nuk iu shërben formati në të cilin janë të disponueshme informacionet për organizatat e shoqërisë civile, prandaj ata vendosin të krijojnë dhe përdorin regjistrat e vet të shoqatave dhe fondacioneve, shpesh të krijuara në bazë të përcaktimit tematik të organizatave, siç është shembulli i mësipërm i SÇE dhe Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të shoqërisë civile.

**Përse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**

Me mundësimin e qasjes në raportet dinamike me të dhëna të rregullueshme për shoqatat dhe fondacionet e institucioneve përdorues të buxhetit shtetëror (pushteti qendror dhe lokal) do i mundësohet qasje direkte dhe e autorizuar në raporte dinamike me të dhëna të rregullueshme. Të dhënat në raportet që fitohen nga gjendja aktuale-momentale në Regjistrin e shoqatave dhe asociacioneve, Regjistrin e fondacioneve dhe Regjistrin e formave organizative të organizatave të huaja (3 të definuarat në Ligjin mbi shoqatat dhe fondet) në bazë të kriteriumeve të caktuara hyrëse (filtrave), si për shembull: gjeografikisht sipas selisë së subjektit, forma organizative, madhësia, sipas fjalës kyçe nga qëllimet dhe të ngjashme.

Përcaktimi final i kriteriumeve hyrëse dhe të dhënave dalëse do të vendoset në procesin inkluziv, në grupin e punës e përbërë nga përfaqësues të FSHHM si propozues i zotimit, përfaqësues të RQ, Qeverisë- Departamentit për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, Këshillin për bashkëpunim me dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Me mundësinë e qasjes në të dhënat e azhuruara, të cilat mund të përpunohen sipas interesit të institucionit i cili i shfrytëzon, institucionet do të mund të rrisin përfshirjen e organizatave me të cilat komunikojnë, ti informojnë dhe ti përfshijnë në proceset rrjedhëse konsultative.

Si përfundim, zhvillimi i politikave për shoqërinë civile është qëllim në vete. Qeveria ka krijuar Këshill për bashkëpunim me dhe zhvillim të shoqërisë civile dhe ka miraturar, përkatësisht përgadit Strategji të re për zhvillim të shoqërisë civile. Megjithatë dizajnimi i politikave kualitative, varet nga disponueshmëria e të dhënave kualitative. Formatimi momental në të cilin janë të disponueshme të dhënat për shoqata të qytetarëve nuk janë mjaftueshëm të shfrytëzueshme dhe të dobishme gjatë krijimit të politikave. Mundësim i qasjes pa pagesë në të dhënat për organizatat e shoqërisë civile në mënyrë të konsiderueshme do ta lehtësojë punën edhe të Këshillit në këtë aspekt.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse e përmirëson transparencën e shoqërisë civile; e përmirëson kualitetin dhe qasjen në informacione publike dhe pa pagesë me atë që ata të dhëna janë të disponueshme në një lokacion qendror dhe përveç kërimit individual, i mundshëm është edhe përdorimi analitik i të dhënave; mundëson kushte për lehtësim të barrës administrative mbi organizatat e shoqërisë civile gjatë aplikimit të mjeteve financiare nga donatorë publik dhe privat.

Informacione shitesë

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR SHOQËRINË CIVILE sepse institucionet shtetërore kanë në dispozicion të dhëna, sipas të cilave mund të bëjnë targetim tematik, gjeografik, tipologjik dhe të llojeve tjera, të organizatave të shoqërisë civile, me qëllim përfshirjen e tyre në proceset e krijimit dhe ndjekjes së politikave publike, ndërsa organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët kanë në dispozicion të dhëna të integruara në një vend të cilat mund ti përdorin në rastet kur ato organizojnë procese konsultative ose kanë nevojë të diseminojnë informacione tek shoqatat dhe fondacionet.

Do të përmirësohen politikat për zhvillim të shoqërisë civile, të cilat tani do të mund të bazohen në informacione kredibile dhe të besueshme, duke përdorur këtë bazë integrale.

Ndërlidhja me Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim dhe zhvillim të sektorit civil 2018-2020:

Në Strategjinë e Qeverisë për bashkëpunim dhe zhvillim të sektorit civil 2018-2020 është paraparë MASA 12: Rritje e disponueshmërisë dhe diseminimit të të dhënave publike për organizatat e regjistruara të shoqërisë civile në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të kësaj mase, janë paraparë dy aktivitete 12.1. Përmirësim i bazës së organizatave të regjistruara të shoqërisë civile në Regjistrin qendror, ku duhet të zgjerohen informacionet e disponueshme publike për organizatat e regjistruara të shoqërisë civile 12.2. Përmirësim i kornizës ligjore për procedurat e marrjes së informacioneve të nevojshme nga Regjistri qendror me qëllim financimin publik të projekteve dhe programeve të organizatave të shoqërisë civile.

Ndërlidhje me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.10: Të mundësohet qasje në informacione dhe mbrojtje e lirive fundamentale, në pajtim me legjislacionin kombëtar dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Me masat nga ky zotim kontribohet në përparimin e qasjes në informacione me karakter publik përmes zbatimit më efikas të ligjeve dhe informim më të mirë të qytetarëve.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.5.1	Publikim i të dhënave për organizatat e shoqërisë civile në format të hapur në portalin e Regjistrit qendror, portalin qeveritar për të dhëna të hapura	1. Numri i shoqatave të regjistruara të shoqërisë civile dhe fondacione për të cilat janë publikuar të dhëna në format të hapur (Numri i shoqatave të regjistruara sipas Regjistrit qendror është 15580) 2. Numri i transferimeve të të dhënave të hapura nga Portali i RQ dhe Portalit Qeveritar mbi të dhënat e hapura	RQRMV, MSHIA	dhjetor 2021	dhjetor 2021
1.5.2	Azhurim i rergullt i të dhënave të hapura nga pika e mëparshme	1. Frekuenca e azhurimit të të dhënave të hapura (Objektivi: më së paku një herë në muaj)	RQRMV	dhjetor 2021	Në vazhdimësi
1.5.3	Krijimi i grupit të punës për përcaktim të kriteriumeve hyrëse dhe të dhënave dalëse për organizatat e shoqërisë civile që do ti përmbajnë raportet dinamike	1. Kriteriumet e përcaktuara dhe të dhënat dalëse (po/jo)	FSHHM si propozues i zotimit, përfaqësues të RQ, SP të QRMV, Këshillit për bashkëpunim me dhe zhvillim të shoqërisë civile	tetor 2021	tetor 2021

1.5.4	Mundësim i qasjes në raportet dinamike me të dhëna të rregullueshme për organizatat e shoqërisë civile për shfrytëzuesit e buxhetit (pushteti qendror dhe lokal)	1. Qasje e mundësuar në raportet dinamike me të dhëna të rregullueshme për organizatat e shoqërisë civile (po/jo)	RQRMV	tetor 2021	maj 2022
1.5.5	Trajnime dhe udhëzime me shkrim për shfrytëzuesit e buxhetit (pushteti qendror dhe lokal) për shfrytëzim të raporteve dinamike	1. Numri i nëpunësve, pjesëmarrës në trajnim; 2. Numri i nëpunësve deri te të cilët janë dërguar udhëzime me shkrim mbi shfrytëzimin e raporteve dinamike.	RQRMV	maj 2022	maj 2022
1.5.6	Shfrytëzim i raporteve dinamike për organizatat e shoqërisë civile	1. Numri i raporteve të ndërmarra me të dhëna për organizatat e shoqërisë civile	RQRMV, SP i QRMV, Këshilli për bashkëpunim me dhe zhvillim të shoqërisë civile.	maj 2022	Në vazhdimësi

Zotim i ri



Institucion udhëheqës
për zbatim

RQRMV

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Vladimir Naumovski

Funksioni,
Departamenti

Këshilltar i drejtorit për zhvillim informatik

Email

vladimir.naumovski@crm.org.mk

Telefon

+389 2 3288 130

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

SP QRMV- Departamenti
për bashkëpunim me
shoqëritë civile, Suzana
Nikodijeviq Filipovska, [Suzana.
Nikodijevic@gs.gov.mk](mailto:Suzana.Nikodijevic@gs.gov.mk)

Maja Petkovska Leses, [Maja.
Petkovska@gs.gov.mk](mailto:Maja.Petkovska@gs.gov.mk)

Këshilli për bashkëpunim me
dhe zhvillim i shoqërisë civile

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe të punës
dhe multilaterale

Fondacioni Shoqëri e Hapur -
Maqedoni

Dançe Danilovska Bajdevska,
dance.danilovska@fosm.mk

Marija Mirçevska, [marija.
mirchevska@fosm.mk](mailto:marija.mirchevska@fosm.mk)

Qendra për komunikime
qytetare, German Filkov,
gfilkov@ccc.org.mk



1. TRANSPARENCË, LLOGARIDHËNIE, PROAKTIVITET DHE PËRFS

1.6. Transparencë fiskale dhe llogaridhënie në nivel lokal dhe përmirësim i përfshirjes së qytetarëve përmes mekanizmave dhe mjeteve inovative

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Qeverisja e mirë në nivel lokal nënkupton përmirësim të proceseve në funksion të dhënies më efektive dhe më ekonomike të shërbimeve publike, me mundësimin e transparencës dhe llogaridhënies së plotë, si dhe përfshirje e qytetarëve në vendimmarrje. Por gjithmonë duhet pasur kujdes proceset të garantojnë përfshirje. Duke patur parasysh trendet e reja dhe dokumentet e Këshillit të Europës, të Bashkimit European dhe të OKB-së, këto zotime mund të arrihen me përdorimin e inovacioneve dhe teknologjive të reja të cilat lehtësojnë qasjen në informacione dhe sensibilizojnë qytetarët.

Nevoja e ngritjes së nivelit të transparencës dhe llogaridhënies në nivel lokal është adresuar në thuajse të gjitha raportet dhe dokumentet strategjike të institucioneve kombëtare, ndërsa përmirësimi në këta aspekte, mes të tjerash ndiqet përmes analizave dhe anketave të cilat zbatohen në nivel vjetor. Në hulumtimet e mendimit publik për kënaqshmërinë nga shërbimet në nivel lokal të zbatuara në katër vitet e kaluara, vërehet një përmirësim i ndjeshëm në vlerësimin që japin qytetarët për disponueshmërinë e informacioneve për komunat (nga 3.0 në 2017 në 3.1 në 2020), pjesëmarrja e qytetarëve gjatë vendimmarrjes me rëndësi lokale (nga 2.3 në 2017 në 2.6 në 2020), si dhe për njohjen e qytetarëve me mënyrën se si harxhohen mjetet buxhetore në komunën e tyre (nga 2.2 në 2017 në 2.4 në 2020). Megjithatë, edhe përkaj përmirësimin relativ në këtë drejtim, ekziston nevojë e madhe për investim të përpjekjeve shtesë për përmirësim të transparencës dhe llogaridhënies totale të njërive të vetëqeverisjes lokale, si dhe për përfshirje më të madhe të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal.

Kur bisedohet për menaxhim më të mirë me financat publike gjithmonë akcenti vendoset në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies. Nevoja e transparencës më të madhe financiare dhe llogaridhënies është adresuar edhe gjatë miratimit të Ligjit për mbështetje financiare të njërive të vetëqeverisjes lokale dhe individëve shfrytëzues themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për finansim të detyrimeve të arritura, por të pa paguara në tetor të vitit 2018, me qëllim përmes disiplinës më të madhe financiare dhe llogaridhënies të përmirësohet menaxhimi me financat publike.

	Në dhjetor të vitit 2020 Qeveria miratoi Konkluzion me të cilin iu dha detyrë ministrive, ndërsa komunave iu rekomandoi të përmirësojnë transparencën aktive, me theks në transparencën financiare, veçanërisht në realizimin e mjeteve të buxhetit qendror.
Qëllimi kryesor i zotimit	Përmes vendosjes së mekanizmave dhe mjeteve inovativë të përmirësohet transparenca financiare dhe llogaridhënia në njësitë e vetëqeverisjes okale dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal.
Si do të kontribuojë zotimi në zgjidhjen e problemit publik?	Vendosja e tablove elektronike në komuna si mënyrë shumë e disponueshme për informim të anëtarëve të këshilleve dhe në përgjithësi të qytetarëve për të dhënat kyçe financiare të punës së komunës dhe shërbimeve publike, përmes marrjes automatike të raporteve kuartale për realizim të buxhetit të përgatitura nga ana e administratës së komunës dhe përpunimi i tyre në format më të kuptueshëm dhe më të dukshëm. Të dhënat publikohen në mënyrë që do të jetë e kuptueshme për anëtarët e komisioneve të cilët nuk janë ekspertë financiar, si dhe për qytetarët. Qëllimi është që me informim më të madh dhe kuptim të procesit të përgatitjes dhe realizimit të buxhetit, anëtarët e komisioneve të munden në mënyrë më të përgjegjshme të kryejn funksionin kontrollues, si dhe të marrin vendime në bazë të informacioneve dhe në bashkëpunim të ngushtë dhe në konsultim me qytetarët. Në komuna do të mbështetet krijimi dhe vendosja në funksion e mjeteve inovative për qasje më të lehtë në informacione dhe promovimi i përfshirjes së qytetarëve në marrjen e vendimeve gjatë krijimit të politikave lokale dhe shërbimeve. Aspekti i tretë është vendosja e një sistemi të veçantë për përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes dhe definim të prioritetëve lokale që do të ofrojë përfaqësim të duhur të të gjithë qytetarëve, me theks në të pambrojturit social dhe grupet e marginalizuara.
Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?	ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione më të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën mbi informacione. ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE sepse krijon dhe i përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve dhe e përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile. ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE sepse përmirëson mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve.

Informacione shitesë

Zotimi vazhdon prej PKV 4 me qëllim që mekanizmat dhe mjetet për përmirësim të transparencës financiare dhe llogaridhënies dhe përfshirjes së qytetarëve të vendosen në të gjithë komunat dhe të kryejnë ndikim më të madh në përmirësimin e menaxhimit në nivel lokal.

Në kuadër të PKV4 kështu mekanizma dhe mjete janë vendosur në 24 komuna.

Zotimi kontribon drejt realizimit të prioriteteve dhe qëllimeve të Programit të Qeverisë për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim 2021-2026 si dhe qëllimeve të qëndrueshme të OKB, veçanërisht Qëllimit 16: „Promovim i shoqërive paqedashëse dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, QASJE NË DREJTËSI për të gjithë dhe ndërtim i institucioneve efikase, të përgjegjshme dhe përfshirëse në të gjithë nivelet“, konkretisht për qëllimet 16.6: „Të zhvillohen institucione efikase, të përgjegjshme dhe transparente në të gjithë nivelet“ dhe 16.7: „Të sigurohet vendimmarrje e përgjegjshme, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjithë nivelet“.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.6.1	Vendosje dhe vënie në funksion e tabelave elektronike në 20 komuna në të cilat në mënyrë automatike do të publikohen raportet kuartale për realizim të Buxhetit të komunës, të përpunuara në mënyrë të kuptueshme dhe të disponueshme për qytetarët.	1. Numri i komunave në të cilat janë vendosur në funksion tabelat elektronike 2. Niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve nga njohja me shpenzimin e buxhetit komunal (nota mesatare 2.4 në vitin 2020)	MVL UNDP	janar 2022	dhjetor 2023
1.6.2	Krijim dhe vendosje e mjeteve inovative për qasje më të lehtë në informacione dhe promovim i përfshirjes së qytetarëve në 20 komuna	1. Numri i mjeteve inovative të vendosura (minimum 20 mjete në 20 komuna)	MVL UNDP	janar 2022	dhjetor 2023
1.6.3	Vendosja e mekanizmit për pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje dhe definimi i prioritetëve lokale, përmes përfaqësimit të duhur me theks tek të pambrojturit dhe grupet e marginalizuara, në 20 komuna	1. Numri i komunave me mekanizëm të vendosur për pjesëmarrje të qytetarëve 2. Numri i konsultave të realizuara me përfaqësimit të duhur të qytetarëve (minimum 80) 3. Numri i projekteve të pranuar dhe të zbatuara nga ana e autoriteteve lokale të propozuara nga qytetarët përmes mekanizmave për pjesëmarrje (minimum 20)	MVL UNDP	janar 2022	dhjetor 2023

Zotimi vazhdon nga PKV 4

Institucion udhëheqës për zbatim	MVL	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Eli Çakar	
Funksioni, Departamenti	Këshilltar shtetëror	
Email	elicakar@gmail.com	
Telefon	/	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	NJVL
	Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	UNDP ilmiasan.dauti@undp.org martin.nikolic@undp.org





2. PARANDALIM I KORUPSIONIT DHE PROMOVIM I QEVERISJES SË MIRË

2.1. Prokurimet publike si të dhëna të hapura

tetor 2021 - gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Prokurimet publike, në nivel botëror janë vend tipik ku mund të haset korupsion. Ekzistojnë shumë mënyra se si prokurimet publike janë instrument për transaksione të llojllojshme kundër interesit publik e me qëllim pasurim material ose tregëti me ndikimin.

Në Strategjinë kombëtare për luftë kundër korupsionit, prokurimet publike janë identifikuar si faktor i rëndësishëm rreziku, i pranishëm në më shumë sfera ku veprojnë institucionet publike.

Qendra për komunikime qytetare, në valën më të re të mbikëqyrjes vë në dukje se në gjashtë muajt e parë të 2021, vetëm 1% e prokurimeve publike janë kontrolluar ndërsa janë vërejtur parregullsi tek çdo i pesti prokurim i kontrolluar.

Në mbikëqyrjen e prokurimeve publike, nga ana e QKQ, vazhdimisht vihet në dukje vërejtja për shkallën e ulët të konkurrencës në sektorët ekonomikë ku konkurrenca është tregues i rëndësishëm i rrezikut nga korupsioni.

Republika e Maqedonisë së Veriut mban sistem elektronik të prokurimeve publike, i cili është publik dhe palët e interesuara mund të shohin të dhëna mbi njoftimet dhe kontratat e lidhura.

Mirëpo, mbikëqyrja e prokurimeve publike nga persona të jashtëm, në kuptimin e parë, nga mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile, është e vështirë sepse mbledhja e të dhënave është në mënyrë manuale. Kjo do të thotë që mbikëqyrja e jashtme është e ngarkuar me angazhimin e resurseve dhe kohës e cila në fakt mund të angazhohet në analizë në vend të mbledhjes së të dhënave.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi i zotimit është përmirësim i llogaridhënies së prokurimeve publike përmes mundësisë së rritur për mbikëqyrje të jashtme nga mediumet dhe organizatat e shoqërisë civile.

Zotimi parasheh publikim të prokurimeve publike në format të lexueshëm maqinerik, si të dhëna të hapura në portalin qeveritar për atë qëllim.

Si do të kontribojë zotimi në zgjidhjen e problemit publik?

Transparenca e të dhënave në mënyrë të konsiderueshme ndikon në zvogëlimin e rreziqeve nga korupsioni. Lirimi i informacioneve kah publiku i interesuar mundëson analiza më të thella dhe alarmim. Kjo në fakt do të thotë që institucionet, me transparencën e tyre, mundësojnë përfshirje më kualitative të aktorëve të jashtëm, si psh shoqërinë civile në mbikëqyrje efikase përmes marrëdhënies së partneritetit të palëve.

Analizat e bazuara në aksione, vëllim, rrjetëzim të organeve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik me fazën bashkëkohore të mjeteve për luftë kundër korupsionit dhe sigurojnë alarm në kohë të duhur i cili më tutje mund të procesojë dhe nga institucione të tjera publike si KSHPK me qëllim përmirësim të politikave dhe kornizës ligjore. Me bazën e prokurimeve publike në format të hapur, mundësohen kushte për zhvillim të mjeteve të tilla dhe përmirësim i luftës kundër korupsionit.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacionet ekzistuese në mënyrë të re dhe mundëson analiza të shpejta mbi një vëllim të lartë të të dhënave.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR SHOQËRINË CIVILE sepse lehtëson punën e organizatave të shoqërisë civile dhe medimeve të cilat tashmë merern me prokurimet publike dhe mundëson numër të rritur të akterëve që shfrytëzojnë analiza të prokurimeve publike për informim të qytetarëve.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE sepse gjithpërfshirja e analizave në bazë të të dhënave të hapura mundëson zhvillim të mjeteve të reja për alarmim të hershëm për faktorë të rrezikshëm gjatë prokurimeve të caktuara publike dhe alarmimit të hershëm e përmirëson kontrollin e integritetit të prokurimeve publike dhe kursen mjete të taksapaguesve.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nuk nevojitet buxhet shtesë.

Ndërlidhje me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.5: Zvogëlim i konsiderueshëm i të gjitha formave të korupsionit dhe ryshfetit.

Me masat e këtij zotimi kontribohet drejt parandalimit dhe luftës kundër korupsionit dhe mbrojtje të interesit publik përmes rritjes të llogaridhënies dhe përgjegësisë së personave të zgjedhur dhe të emëruar kundrejt qytetarëve.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.1.1	Përgatitje e planit për publikim i cili paraqet strukturën e setit të të dhënave dhe zgjedhje të informacioneve të cilat do të publikohen në çdo prokurim publik.	1. Plani për publikim është i përgatitur (po/jo)	BPP	janar 2022	shkurt 2022
2.1.2	Publikim në bazën e portalit të të dhënave të hapura	1. Numri i njoftimeve për prokurime publike të cilat i përmbushin kriteriumet e përmbajtuara në planin për publikim në portalin për të dhëna të hapura.	BPP	mars 2022	Në vazhdimësi

Zotimi është i ri



Institucion udhëheqës për zbatim	BPP	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Biljana Ristevski Goran Davidovski	
Funksioni, Departamenti	Këshilltar në sektorin për ndjekje të sistemit për prokurime publike dhe menaxhim me SEPP	
Email	biljana.drijovska@bjn.gov.mk goran.davidovski@bjn.gov.mk	
Telefon	02/3255 716	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	MSHIA
	Organizata të shoqërisë civile, sektor privat, grupe pune dhe multilaterale	Instituti për demokraci "Societas Civilis" Shkup Misha Popoviq, misha@idscs.org.mk Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis Marijana Jançeska, marijana@metamorphosis.org.mk



2. PARANDALIM I KORUPSIONIT DHE PROMOVIM I QEVERISJES SË MIRË

2.2. Mekanizëm i përparuar për ndjekje të gjendjes pasurore të personave të zgjedhur dhe të emëruar

tetor 2021 - gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Një nga mënyrat e zvogëlimit dhe parandalimit të pasurimit jolegal të personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe rritja joproporcionale e pasurisë së tyre, si rezultat i keqpërdorimit të funksionit, është mekanizëm funksional për evidentim dhe ndjekje të gjendjes pasurore të personave të zgjedhur dhe të emëruar. Në Maqedoninë e Veriut ky sistem është relativisht joefikas, para së gjithash për shkaqe teknike, që lë hapësirë për transparencë të pamjaftueshme në pjesën e publikimit të gjendjes pasurore të funksionerëve dhe efikasitetin e pamjaftueshëm në ndjekjen e gjendjes së tyre pasurore. KSHPK është e kufizuar në evidentimin dhe ndjekjen e gjendjes pasurore të funksionerëve, gjatë kohës së kryerjes së funksionit të tyre. Njëkohësisht, KSHPK nuk ka kontroll të plotë për numrin total të funksionerëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe nëse të gjithë personat sipas nenit 82 të LPKKI që janë të detyruar të dorëzojnë Deklaratë për gjendjen pasurore dhe interesat e kanë kryer detyrimin e tyre, sepse regjistri i personave të zgjedhur dhe të emëruar ende nuk ka realizuar funksionin për të cilin është krijuar.

Shkurtimisht, përveç se institucioneve, edhe qytetarëve i është shkurtuar mundësia të kenë kontroll mbi atë se kush janë personat e zgjedhur dhe të emëruar në shtet, cila është dhe si ndryshon gjendja pasurore në periudhën deri sa e kryejnë funksionin publik.

Qëllim kryesor i zotimit

Vendosje e sistemit funksional i cili do të thjeshtësojë kontrollin e gjendjes pasurore dhe interesat e personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe do iu mundësojë qytetarëve kontroll të duhur në gjendjen pasurore dhe interesat e personave të zgjedhur dhe të emëruar dhe qasje në ndryshimet e të njejtave në periudhën deri sa e kryejnë funksionin.

Si do të kontribuojë zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Deklarimi i intereseve dhe pasurisë është mjet i pranuar botërisht për transparencë, e cila qytetarëve dhe institucioneve u jep mundësi për kontroll më të madh në gjendjen pasurore dhe interesat e personave të zgjedhur dhe të emëruar me çka kontribuohet në parandalimin e keqpërdorimit të pozitës zyrtare për zmadhim të gjendjes pasurore dhe realizim të interesave personale.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

Ndjekja historike e pasurisë është bazë e kontrollit të rrezikut nga pasurimi material gjatë kohës së shërbimit publik, deri sa kontrolla e interesit ndihmon në mbikëqyrjen se si personi ka vendosur gjatë kohës së punës së tij, dhe nëse i ka vendosur interesat personale para interesit publik. Publikimi i këtyre të dhënave në mënyrë të qartë, të strukturuar dhe të hapur do të mundësojë ndërtim të mjeteve të lehta të cilat në mënyrë shumë të qartë do të ua tregojnë këto informacione.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të reja, sepse deri më tani një pjesë e këtyre informacioneve kanë qenë të padukshme, ose të keqprezantuara dhe është bërë analizë e shpejtë mbi një vëllim të madh të të dhënave.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse lehtëson punën për mbikëqyrje të jashtme nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe mediumeve.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse mundëson regjistrë të përmirësuar të personave të zgjedhur dhe të emëruar, mënyrë të përmirësuar të paraqitjes së pasurisë dhe interesave, si dhe shkëmbim elektronik të të dhënave që do të mundësojë të shmangen paqartësitë dhe joprecizitetet në publikimin e pasurisë dhe interesave, me çka përmirësohet llogaridhënia e personave të emëruar në periudhën deri sa e kryejnë funksionin e tyre.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nevojitet buxhet i cili tashmë është i siguruar për nevojat e KSHPK (nga buxheti qendror dhe ndihma ndërkombëtare)

Ndërlidhja me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.5: Zvogëlim i konsiderueshëm i të gjitha formave të korupsionit dhe ryshfetit.

Me masat nga ky zotim kontribohet drejt parandalimit dhe luftës kundër korupsionit dhe mbrojtje të interesit publik përmes zmadhimit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë së personave të zgjedhur dhe të emëruar.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.2.1	Kompletim i zgjidhjes softuerike për regjistër të letrave anketuese	1. Zgjidhja softuerike është e kompletuar, dhe përjashton modul për paraqitje të lehtë të gjendjes së anketuar dhe transparencë mbi ndryshimin e gjendjes pasurore përgjatë kohë	KSHPK	tetor 2021	mars 2022
2.2.2	Faza fillestare e mbledhjes së të dhënave	1. Në tre muajt e parë nga iniciimi i mënyrës së re të paraqitjes, të gjithë personat e regjistruar me detyrim për paraqitje në mënyrë të suksesshme i kanë mbushur të dhënat.	KSHPK	prill 2022	Në vazhdimësi

Zotimi është i ri



Intitucion udhëheqës për
zbatim

KSHPK

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Borçe Stojanovski

Funksioni,
Departamenti

Bashkëpunëtor i lartë dhe i autorizuar për
udhëheqje të Departamentit për ndjekje
të gjendjes pasurore dhe interesave

Email

s.borce@dksk.org.mk

Telefon

/

Ministri/
Agjencione

SP i QRMV

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori rivat,
grupe pune dhe
multilaterale

Instituti për
demokraci "Societas
Civilis" Shkup
Misha Popoviq,
[misha@idscs.org.
mk](mailto:misha@idscs.org.mk)





2. PARANDALIM I KORUPSIONIT DHE PROMOVIM I QEVERISJES SË MIRË

2.3. Shpallje publike e lëndëve për zgjedhjen e personave të zgjedhur/emëruar nga Qeveria e RMV-së si udhëheqës të institucioneve

tetor 2021 - gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Personat e zgjedhur/të emëruar nga Qeveria e RMV si udhëheqës të institucioneve paraqet shtresën më të lartë meritokratike në udhëheqësinë shtetërore. Në bazë të legjislacionit pozitiv, si dhe standardeve të udhëheqjes së mirë, ky kuadër duhet të dallohet nga profesionalizmi i lartë, ekspertizë dhe aftësi menaxhuese.

Megjithatë, me vite të tëra praktika dallon nga standardet. Zgjedhja e kuadrit mbetet në pjesë të madhe joformal, me emërimin e kryerësve të detyrës ose me nivel të ulët të konkurrencës, përkatësisht konkurse me vetëm një kandidat.

Informacionet për zgjedhjen e tyre janë të pakta, njëjtë si biografitë e tyre profesionale, si dhe dokumentacioni, të paktën formalisht, duhet të ekzistojë si shtojcë e zgjedhjes së tyre.

Kjo gjendje kontribon drejt perceptimit të qytetarëve se nuk zgjidhen kandidatët më të mirë dhe se përkatësia partiake ose marrëveshja koalicionuese luan rol kyç në këtë proces.

Paralelisht me këtë perceptcion, rotacionet ose ndryshimet në zgjedhje, gjatë të njëjtës qeveri, konfirmon jo-thelbësoren e zgjidhjes personale, përkatësisht vlerën e ulët të shtuar të funksionimit të institucionit që i bën këta persona të ndryshueshëm.

Gjendja e tillë ndikon negativisht në zhvillimin e institucioneve e me atë edhe dhënia e shërbimeve drejt qytetarëve. Fillimisht, kuadrot udhëheqëse joprofesionale nuk kontribojnë në zhvillimin e institucionit sepse nuk di të zgjedh dhe të menaxhoj zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet institucioni. Megjithatë, si e dyta, zgjidhja e tillë i demotivon kuadrot profesionale në të njëjtat institucione, por edhe profesionistët e jashtëm të cilët shpresojnë se mund të kenë sukses në shpallje publike të fitojnë shansin të udhëheqin me institucion publik.

Qëllim kryesor i zotimi

Zotimi është në funksion të transparencës së procesit. Qëllimi i zotimit nuk është të zgjidh problemin e plotë, por përmes përmirësimit të transparencës të kontribuojë drejt gjendjes në të cilën do të ngushtohet hapësira për vendimarrje joformale për zgjedhje të personave udhëheqës.

Zotimi përfshin publikim të lëndës së zgjedhjes së personit të zgjedhur ose të emëruar (shpallja e publikuar nëse ka, propozimi i Komisionit për emërim, Vendimi i Qeverisë, CV e personit të zgjedhur ose të emëruar, matrica e vetëevaluimit, letër motivimi dhe program pune). Publikimi do të kishte qenë në portalin e Vlada.mk ose në ndonjë alternativë tjetër, atë për të dhënat e hapura. Zotimi vlen edhe për rastet kur emërohen kryerës detyre, me përjashtim të dokumenteve të cilat kandidati nuk i dorëzon, siç është programi për punë.

Publikim i tabelës me të dhëna: shpallja e publikuar, numri i aplikimeve të pranuar (të rregullta dhe të parregullta, në kohë të duhur dhe në kohë jo të duhur), numri i kandidatëve të zgjedhur. Tek rastet kur është zgjedhur kryerës i detyrës, publikohen informacione për personin e emëruar.

Me këtë do të rritet transparenca dhe do të vendosen standarde për transparencën si mjet për luftë kundër korupsionit.

Transparenca e zmadhuar do të ndikojë në kthimin gradual të besimit në procesin përmes qytetarëve dhe kandidatëve të interesuar.

Si do të kontribuoj zotimi në zgjidhjen e problemit publik?

Transparenca llogaritet si mjet i rëndësishëm për përmirësim të udhëheqjes dhe luftës kundër korupsionit. Me publikimin e dosjeve të personave të zgjedhur/emëruar nga Qeveria e RMV si udhëheqës institucionesh, publikut i jepen në kontroll kompetencat profesionale të kandidatit të zgjedhur.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione plotësisht të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve për emërimet dhe përmirëson qasjen në informacione nga ana e publikut përmes asaj që kjo e dhënë do të jetë publikisht, lehtë dhe pa pagesë e disponueshme për qytetarët.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon dhe përmirëson mundësitë që sektori joqeveritar dhe mediumet të ndjekin emërimet më lehtë dhe me atë të informojnë qytetarët për vendime të qeverisë dhe në mënyrë direkte informon qytetarët për zgjedhjen dhe kompetencat e personave të emëruar.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE sepse krijon dhe përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve.

Informacione shtesë

Për zbatim të këtij zotimi nuk nevojitet buxhet shtesë.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.5: Zvogëlim i konsiderueshëm i të gjitha formave të korupsionit dhe ryshfetit.

Me masat e këtij zotimi kontribohet drejt parandalimit dhe luftës kundër korupsionit dhe mbrojtjes së interesit publik përmes rritjes së llogaridhënies dhe përgjegjësisë së personave të zgjedhur dhe emëruar kundrejt qytetarëve.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.3.1	Përgatitje e listës së standardeve dhe dokumenteve shitesë për publikim në një lëndë.	- Lista e informacioneve dhe dokumenteve i përfshin të gjithë dokumentet e nevojshme për publikim në një lëndë (po/jo) - Lista e informacioneve dhe dokumenteve që do të publikohen është miratuar si Vendim në Qeveri (po/jo)	SP i QRMV	tetor 2021	nëntor 2021
2.3.2	Publikim i lëndëve për emërim të personave të zgjedhur// emëruar në portalin e të dhënave të hapura	- Përqindje e lëndëve të publikuara për emërim të personave të zgjedhur/ emëruar (përlllogaritet si raport i 1.6/1.a 1.a Numri i lëndëve për emërim të personave të zgjedhur/ emëruar 1.b Numri i lëndëve të publikuara për emërim të personave të zgjedhur/ emëruar	SP i QRMV	dhjetor 2021	Në vazhdimësi

Zotimi është i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

SP i QRMV

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Maja Petkovska Leses
Neda Gacova

Funksioni,
Departamenti

Këshilltar shtetëror

Email

maja.petkovska@gs.gov.mk
nedagacova@gmail.com

Telefon

3118-022

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

MSHIA

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Instituti për
demokraci „Societas
Civilis“ Shkup
Misha Popoviq,
misha@idscs.org.mk





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.1. Shërbimet publike dhe politikat e bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e punësimit

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Vendet e rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore, në të cilat gjindet edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, mbeten prapa vendeve evropiane për vendime në aspekt të treguesve kryesorë për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Niveli i lartë i mbylljes së institucioneve publike dhe niveli i ulët i njohjes së qytetarëve me të drejtat e tyre elementare, si dhe mungesa e partneritetit të vërtetë mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, e kufizojnë procesin e përmirësimit të shërbimeve publike dhe qasjen në to. Si shtesë, zhvillimi i teknologjive dhe mundësive për digjitalizim në botë, kanë shtyrë Qeveritë e rajonit, përfshirë edhe Qeverinë e RMV të inicojnë procese për digjitalizim të shërbimeve të caktuara dhe vendosje e teknologjive për publikim automatik të të dhënave. Shumica e iniciativave të deritanishme kanë të bëjnë me zhvillimin e produkteve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e nivelit të transparencës së institucioneve, por në pjesë të madhe të këtyre iniciativave e lënë pas aspektin e përfshirjes së qytetarëve dhe nuk i marrin parasysh mendimet e qytetarëve, përkatësisht rritjen e vëllimit të të dhënave që janë publikisht të disponueshme e cila arrihet me iniciativat e deritanishme, dhe duhet të kontribuojë drejt zmadhimit të aktivitetit të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, nuk i japin rezultatet e dëshiruara. Gjendja e tillë paraqitet për dy arsye, edhe atë: kompleksiteti i të dhënave të cilat publikohen dhe pamundësia që qytetarët ti kuptojnë të njëjtat, si dhe përshkak mos ekzistimit të mekanizmave të vendosur për komunikim dyanësh mes atyre që publikojnë të dhëna dhe atyre për të cilat janë të destinuara të dhënat.

Mungesa e mekanizmave për komunikim dyanësh mes institucioneve dhe qytetarëve tek Agjencioni për punësim dhe njësitë e saj rajonale kontribuon në besimin e ulët të përdoruesve në këto institucione dhe përgjigje e ulët, me fokus grupet dhe mjediset e pambrojtura.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor dhe afatgjat i zotimit është të vendoset sistem i organizuar dhe praktikë e komunikimit dyanësh në mes qytetarëve dhe atyre që i marrin vendimet gjatë planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të politikave për punësim.

Si do të kontriboj zbatimi në zgjidhjen e problemit publik?

Zotimi me aktivitetet e veta do të kontriboj në ndryshime dhe vendosje të praktikave pozitive në dy nivele, edhe atë: nivel kombëtar dhe lokal, përmes bashkëpunimit institucionet publike të mësipërme me organizatat e shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal. Të gjithë aktivitetet e këtij zotimi do të fokusohen në vendosjen e mekanizmave për përfshirje të qytetarëve të cilët janë të përcaktuara si grupe të synuara të politikave aktive dhe shërbimeve për punësim (persona të papunësuar dhe kompani).

Zotimi do të fokusohet në: 1) ndjekje dhe zbatim të politikave aktive dhe shërbimeve për punësim dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira në këtë zotim, të cilat pas mbarimit të planit për veprim do të vazhdonin bashkëpunimin dhe do të punonin në vazhdimësi në zhvillimin e politikave të synuara. 2) zhvillim i platformave për konsultime dhe transparencë dhe punë me qytetarë të grupeve të pambrojtura në drejtim të njohjes së tyre me të drejtat e politikave në fjalë, përmbledhje të rekomandimeve dhe mendimeve të tyre, mundësim i përgjigjeve për rekomandimet e qytetarëve si dhe njohje me mundësitë për përfshirje të ardhshme në proceset e vendimmarrjes. 3) Promovim i platformave të zhvilluara mes publikut më të gjërë me qëllim përdorim të gjërë dhe përfshirje të qytetarëve në proceset e planifikimit, ndjekjes dhe vlerësimit të shërbimeve nga sfera që është objekt i këtij zotimi. 4) Përmirësim i politikave/praktikës në bazë të rekomandimeve të fituara dhe pjesëmarrje e qytetarëve, me mundësim të përgjigjes kthyesë për statusin e hapave të ndërmarra pas rekomandimeve të dorëzuara.

Përse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse parasheh zhvillim dhe vendosje të mjeteve dhe mekanizmave për publikim të më shumë informacioneve për punën dhe programin buxhetor të institucioneve të cilat mundësojnë punësim. Poashtu, zotimi mundëson përmirësim të kualitetit dhe disponueshmërisë së informacioneve të reja dhe atyre ekzistuese.


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE sepse mundëson zhvillim të mjeteve për komunikim dhe konsultim me grupet e synuara para dhe gjatë kohës së marrjes dhe zbatimit të politikave nga sfera përkatëse dhe parasheh qasje që do të nënkuptonte mobilizim dhe motivim i qytetarëve për pjesëmarrje aktive dhe përdorim i mjeteve të vendosura.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe i njëjti mundëson vendosjen e mekanizmave që do kontribojnë në përmirësimin e përgjegjësisë së funksionerëve publik në punën e tyre.

Informacione shitesë

Ky zotim në vete përmban aktivitete të cilat mundësojnë vendosjen dhe praktikimin e mekanizmave për përfshirje të qytetarëve në proceset e marrjes së vendimeve në sferën e punësimit. Prandaj, të gjithë zgjidhjet e propozuara kontribuojn drejt realizimit të qëllimeve të përcaktuara dhe veprimeve të Qeverisë së RMV-së pas dorëzimit të rishikimit vullnetar të zbatimit të QZHQ në forumin e lartë politik në vitin 2020. Përkatësisht, **kah QZHQ 1. Hapi i radhës:** Mbështetje për punësim të personave të pambrojtur përmes masave të parapara në Strategjinë kombëtare për punësim dhe Strategjinë për formalizim të ekonomisë joformale, si dhe Planet operative për programe aktive dhe masa për punësim dhe shërbime në tregun e punës. **QZHQ 5 Hapi i radhës:** Një nga prioritetet kyçe të vendit në vitet e ardhshme do të jetë përmirësimi i mundësive për punësim të grave dhe mbrojtja e tyre në vendin e punës. **QZHQ 8 Hapi i radhës:** Qeveria do të ndjekë programet dhe aktivitetet e përmendura në planet përkatëse për veprim për krijim të vendeve të punës, përmirësim të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe rritje e kërkesës për fuqi punëtore dhe rritje e konkurrencës. Poashtu, do vazhdojë të harmonizojë legjislacionin e punës me standardet ndërkombëtare mbi punën si dhe me legjislacionin e BE-së.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet. Me masat e këtij zotimi kontribuohet drejt përmirësimit të planifikimit, zbatimit dhe ndjekjes së shërbimeve publike e cila do të kontribuojë drejt rritjes së kënaqshmërisë së qytetarëve nga përvoja me shërbimet e marra publike.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.1.1	Është krijuar trup koordinues i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët do të punojnë në koordinimin e aktiviteteve edhe atë: nga një përfaqësues nga secila organizatë e shoqërisë civile e përfshirë në këtë aktivitet (5 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, nga të cilat një kombëtare dhe katër të nivelit lokal), një përfaqësues nga sektori i punës në kuadër të Ministrisë së punës dhe politikës sociale dhe një përfaqësues nga Agjencioni për punësim.	1. Është vendosur trup koordinues (po/jo)	APRMV dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave ESB	tetor 2021	tetor 2021
3.1.2	Është zhvilluar platformë elektronike për informim, ndjekje, përfshirje të qytetarëve në politikat aktive dhe shërbime për punësim dhe parashikim i detyrueshmërisë i mekanizmit për përmbledhje, rishikim dhe mundësim të përgjigjes për secilin nga rekomandimet e qytetarëve.	1. Numri i dokumenteve/ raporteve të publikuara për zbatim të politikave aktive dhe shërbimeve për punësim 2. Numri i rekomandimeve të dorëzuara për politika aktive dhe shërbime nga ana e qytetarëve			


		3. Numri i aplikimeve për mospërputhje dhe parregullsi të masave aktive dhe shërbimeve	APRMV dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave ESB	tetor 2021	dhjetor 2021
		4. Numri i komenteve/lëvdatave pozitive për masat aktive			
		5. Numri i rekomandimeve të qytetarëve si bazë për përmirësimin e politikave/praktikave (objektiv: më së paku 25%)			
3.1.3	Është ndërmarrë fushatë për informim të publikut për mundësitë të cilat i ofron platforma, përmes zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë komunikuese.	1. % i aktiviteteve të parapara në Strategjinë për komunikim janë të zbatuara	APRMV dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave ESB	janar 2022	qershor 2023
3.1.4	Është vendosur pilot bashkëpunim me OSHC nga Tetova, Kumanova, Shuto Orizare dhe Prilep për identifikim të qytetarëve të papunësuar të peregjistruar dhe qytetarëve nga kategoritë e pambrojtura me qëllim zbatim të aktiviteteve për njohje të qytetarëve me të drejtat e tyre të cilat rrjedhin nga politikat aktive dhe	1. Numri i ekonomive familjare të zgjedhura për identifikim të qytetarëve të papunësuar dhe të peregjistruar në evidencën e APRMV (Objekti: 250 për komunë) 2. Numri i takimeve të realizuara me ekonomitë familjare të identifikuar (Objektiv: 1 takim për ekonomi familjareo)	APRMV, njësitë rajonale të agjencionit, prej Tetove, Kumanove, Shkup dhe Prilep dhe Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barabarësi të grave ESB, në bashkëpunim me katër	tetor 2021	dhjetor 2021

shërbime për punësim përmes përdorimit të qasjes multidisiplinare, si dhe lehtësim të procesit të shprehjes së mendimeve dhe rekomandimeve të qytetarëve para institucioneve kompetente duke përdorur platformën e zhvilluar.

3. Numri i qytetarëve të anketuar (Objektiv: 1000)
4. Numri i planeve të përgatitura për adresim të problemeve të identifikuara mes qytetarëve (objektivi 1).

organizata lokale të shoqërisë civile dhe Stanica Pet, Romano Çaçipe, "Forumi i Grave" dhe "Nëna".

Të gjithë aktivitetet e rekomanduara nën këtë zotim janë të reja dhe nënkuptojnë plotësim të aktiviteteve nga PKV 4.



Institucion udhëheqës
për zbatim

APRMV

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Bojana Simonoviq, APRMV

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

Bojana.Simonovic@av.gov.mk

Telefon

/


Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

Ministria për punë dhe politikë
sociale,
vladimir.krasic@mtsp.gov.mk

Organizatrat e
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilateral

1. Shoqata ESB – Darko Antiq,
dantik@esem.org.mk
2. Stanica PET- Vesna
Shapkoski,
risteska.vesna@live.com
3. Romano Çaçiçe – Enensija
Usein,
romanocacipe@yahoo.com
4. Nëna – Lidija Ilievska,
lidija63@hotmail.com
5. Forumi i Grave – Sllagjana
Josifoska,
forumigruastetovo@gmail.com





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.2. Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e mbrojtjes shëndetësore preventive

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Vendet e rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore, në të cilat bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, mbeten pas vendeve evropiane perëndimore në aspekt të treguesve kryesorë për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Niveli i lartë i mbylljes së institucioneve publike dhe niveli i ulët i njohjes së qytetarëve me të drejtat e tyre elementare, si dhe mungesa e partneritetit të vërtetë mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, kufizojnë procesin e përmirësimit të shërbimeve publike dhe qasjen në to. Si shtesë, zhvillimi i teknologjive dhe mundësive për digjitalizim në botë, kanë inkurajuar Qeveritë në rajon, duke përfshirë edhe Qeverinë e RMV-së të inicojnë procese të digjitalizimit të shërbimeve të caktuara dhe vendosje të teknologjive për publikim automatik të të dhënave. Shumica e iniciativave të deritanishme kanë të bëjnë me zhvillimin e produkteve të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e nivelit të transparencës së institucioneve, por në pjesë më të madhe këto iniciativa e neglizhojnë aspektin e përfshirjes së qytetarëve dhe nuk i marrin parasysh mendimet e qytetarëve, përkatësisht rritjen e vëllimit të të dhënave që janë publikisht të disponueshme që arrihet me iniciativat e deritanishme, ndërsa duhet të kontribuojë drejt aktivitetit më të madh të qytetarëve në proceset e vendimmarjes, por nuk i japin rezultatet e dëshiruara. Gjendja e tillë paraqitet për dy arsye, edhe atë: kompleksiteti i të dhënave që publikohen dhe pamundësia e qytetarëve ti kuptojnë të njëjtat, si dhe përshkak të mosekzistimit të mekanizmave të vendosur për komunikim të dyanshëm mes atyre që publikojnë dhe atyre për të cilët synohen ata të dhëna. Mungesa e mekanizmave për komunikim të dyanshëm mes Ministrisë së shëndetësisë dhe qytetarëve kontribon për besim të ulët të përdoruesve në këta institucione dhe përgjigje të ulët të qytetarëve, me fokus në grupet dhe mjediset e pambrojtura.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllim kryesor afatgjat i zotimit është të vendoset sistem i organizuar dhe praktikë e komunikimit të dyanshëm mes qytetarëve dhe atyre që i marrin vendimet gjatë planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të politikave dhe shërbimeve shëndetësore.

**Si do të
kontriboj zotimi
për zgjidhje
të problemit
publik?**

Zotimi me aktivitetet e veta do të kontriboj për inicim të ndryshimeve dhe vendosjen e praktikave pozitive në dy nivele, edhe atë: nivel kombëtar dhe lokal, përmes bashkëpunimit të institucioneve publike të lartpërmendura dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal. Të gjithë aktivitetet e këtij zotimi do të fokusohen në vendosjen e mekanizmave për përfshirje të qytetarëve të cilat janë të përcaktuara si përdorues të programeve parandaluese për mbrojtje shëndetësore me fokus në ata të destinuar për gra dhe fëmij.

Zotimi do të fokusohet në: 1) vendosjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes ministrit/sekretarit shtetëror për planifikim, ndjekje dhe zbatim të programeve parandaluese shëndetësore dhe organizatave të shoqërisë civile përfshirë në këtë zotim, të cilat pas mbarimit të planit të veprimit do ta vazhdonin bashkëpunimin dhe do të punonin vazhdimisht në zhvillimin e politikave qëllimore. 2) zhvillim i platformës për konsulta dhe transparencë dhe punë me qytetarët nga grupet e pambrojtura në drejtim të njohjes së tyre me të drejtat nga politikat në fjalë, mbledhje e rekomandimeve dhe mendimeve të tyre, si dhe njohje me mundësitë për përfshirje të ardhshme në proceset e vendimmarrjes. 3) Promovim i platformave të zhvilluara mes publikut të gjërë me qëllim përdorim të gjërë, përmes përfshirjes direkte të përgjegjësve për marrëdhënie me publikun në ministrinë e shëndetësisë/Kabineti i ministrit dhe përfshirje e qytetarëve në proceset e planifikimit, ndjekjes dhe vlerësimit të shërbimeve nga sfera që është lëndë e këtij zotimi. 4) Përmirësim i politikave/praktikës në bazë të rekomandimeve të mara dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, duke mundësuar përgjigje kthyesë për statusin dhe hapat e ndërmarra pas rekomandimeve të dorëzuara.

**Përse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse e njëjta parasheh zhvillim dhe vendosje të mjeteve dhe mekanizmave për publikim të më shumë informacioneve për punën buxhetore dhe programore të institucioneve të cilat mundësojnë mbrojtje shëndetësore të grave, nënave dhe fëmijëve. Poashtu zotimi mundëson përmirësim të kualitetit dhe disponueshmërisë së informacioneve ekzistuese dhe atyre të reja.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE përkatësisht mundëson zhvillim të mjeteve të komunikimit dhe konsultimit me grupet qëllimore para dhe gjatë kohës së miratimit dhe zbatimit të politikave të sferave përkatëse. Poashtu parasheh edhe qasje që do të nënkuptonte mobilizim dhe motivim të qytetarëve për pjesëmarrje aktive dhe shfrytëzim i mjeteve tashmë të vendosura.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe e njëjta mundëson vendosje të mekanizmave që do të kontribojn për përmirësim të përgjegjësisë së funksionerëve publik në punën e tyre.

Informacione shtesë

Ky zotim në vete përmban aktivitete që mundësojnë vendosje dhe praktikim të mekanizmave për përfshirje të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes në sferën e shëndetësisë. Prandaj, të gjithë zgjidhjet e propozuara kontribuojn drejt realizimit të qëllimeve të vendosura dhe veprimeve të Qeverisë së RMV-së pas dorëzimit të rishikimit vullnetar për zbatim të QZHQ në forumin e lartë politik në vitin 2020. Përkatësisht, drejt QZHQ 3. Hapi i rradhës: Ministria e shëndetësisë do të vazhdojë me implementimin e iniciativave dhe aktiviteteve të vendosura në dokumentet strategjike dhe planet për veprim dhe do të fillojë me përgatitje të Strategjisë kombëtare shëndetësore të re për periudhën deri në vitin 2030. Strategjia do të mundësojë kahje për reformat në sistemin shëndetësor në të gjitha nivelet. Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Page, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet. Me masat e këtij zotimi kontribuohet drejt përmirësimit të planifikimit, zbatimit dhe ndjekjes së shërbimeve pubike që do të kontribuojn drejt rritjes së kënaqshmërisë së qytetarëve nga përvoja me shërbimet e marra publike.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.2.1	Është krijuar trup koordinativ i përbërë nga shtatë anëtarë të cilët do të punojnë në koordinimin e aktiviteteve, i cili do të përbëhet nga: nga një përfaqësues nga secila organizatë e shoqërisë civile e përfshirë në këtë aktivitet (5 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, nga të cilat njëra nga niveli kombëtar dhe katër nga niveli lokal) dhe katër përfaqësues të Ministrisë për shëndetësi nga të cilat njëri përgjegës për mbrojtje parandaluese shëndetësore, një përfaqësues nga sektori për planifikim strategjik. Një përfaqësues nga kabineti i ministrit dhe një përgjegës për financa.	1. Vendosje e trupit koordinues (po/jo)	MSH, Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me katër organizata të shoqërisë civile në nivel lokal dhe Stanica PET, Romano Çaçipe, "Forumi i Grave" dhe "Nëna".	janar 2022	janar 2022

3.2.2

Zhvillim dhe publikim në platformën elektronike për informim, ndjekje, përfshirje të qytetarëve në programet për mbrojtje parandaluese shëndetësore dhe parashikim i detyrueshëm i mekanizmave për përmbledhje, rishikim, dhe mundësim i përgjigjes të secilit nga rekomandimet e mbledhura nga qytetarët.

1. Numri i dokumenteve/ raporteve të publikuara për zbatim të programeve për mbrojtje shëndetësore
2. Numri i rekomandimeve të dorëzuara për programet për mbrojtje shëndetësore nga ana e qytetarëve
3. Numri i aplikimeve për mospërputhje dhe parregullësi në zbatimin e programeve për mbrojtje parandaluese shëndetësore
4. Numri i komenteve/ lëvdatave pozitive për programet për mbrojtje shëndetësore
5. Numri i rekomandimeve të qytetarëve marrë si bazë për përmirësim të politikave/ praktikave (objektiv: më së paku 25%)

MSH, Drejtoria për shëndetësi elektronike dhe Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me katër organizata të shoqërisë civile në nivel lokal dhe Stanica PET, Romano Çaçipe, "Forumi i Grave" dhe "Nëna"

shkurt 2022

dhjetor 2022

3.2.3	Fushatë e zhvilluar për informim të publikut për mundësitë që i ofron platforma, përmes zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë komunikuese.	1. % e aktiviteteve të parapara në Strategjinë për komunikim që janë zbatuar	MSH, Përgjegjësit për marrëdhënie me publikun/ Kabineti i ministrit dhe Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barabarësi të grave, ESB në bashkëpunim me katër organizata të shoqërisë civile në nivel lokal dhe Stanica PET, Romano Çaçipe, "Forumi i Grave" dhe "Nëna".	janar 2023	qershor 2023
3.2.4	Është vendosur bashkëpunim pilot me OSHC nga Tetova, Kumanova, Shuto Orizare dhe Prilepi për identifikim të grave dhe fëmijëve nga kategoritë e pambrojtura me qëllim zbatimin e aktiviteteve për njohje të tyre me të drejtat e tyre që rrjedhin nga programet për mbrojtje parandaluese. ⁴	1. Numri i ekonomive familjare të zgjedhura për identifikim të qytetarëve të papunësuar dhe të paregjistruar në evidencën e APRMV (Objektiv: 250 për komunë) 2. Numri i takimeve të realizuara me ekonomitë familjare të identifikuar (Objektiv: 1 takim për ekonomi familjare) 3. Numri i qytetarëve të anketuar (Objektiv: 1000) 4. Numri i planeve të përgatitura për adresim të problemeve të identifikuar mes qytetarëve (Objektiv 1).	MSH, njësitë rajonale ISHP nga Tetova, Kumanova, Shkupi dhe Prilepi dhe Shoqata për emancipim, solidarizim dhe barabarësi të grave, ESB në bashkëpunim me katër organizata të shoqërisë civile në nivel lokal dhe Stanica PET, Romano Çaçipe, "Forumi i Grave" dhe "Nëna".	shkurt 2022	qershor 2023

Të gjithë aktivitetet e propozuara nën këtë zotim janë të reja dhe nënkuptojnë plotësim të aktiviteteve të PKV4.

⁴ Programi për mbrojtje aktive shëndetësore të nënave dhe fëmijëve, Programi për zbulim të hershëm të sëmundjeve malinje, programi për kontrolle sistematike, Programi për lirim nga participimi, programi për shëndet publik të cilat në vete përmbajnë shërbime të destinuara për ata, përmes përdorimit të qasjes multidisiplinare, si dhe lehtësim të procesit të shfaqjes së mendimeve dhe rekomandimeve të grave para institucioneve kompetente duke përdorur platformën e zhvilluar. Pilotimi do të zbatohet vetëm për ata programe të destinuara për kujdes parandalues shëndetësor të grave, nënave dhe fëmijëve.

Institucion udhëheqës
për zbatim

MSH

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

m-r Biljana Babushkovska

Funksioni,
Departamenti

Udhëheqës i departamentit për auditim të
brendshëm

Email

biljana.babushkovska@zdravstvo.gov.mk

Telefon

/


Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

Institucione shëndetësore

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

1. Shoqata ESB – Darko Antiq,
dantik@esem.org.mk
2. Stanica PET- Vesna
Shapkoski,
risteska.vesna@live.com
3. Romano Çaçipe – Enensija
Usein,
romanocacipe@yahoo.com
4. Nëna – Lidija Ilievska,
lidija63@hotmail.com
5. Forumi i grave – Sllagjana
Josifoska,
forumigruastetovo@gmail.com





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKEE

3.3. Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e arsimit

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Vendet e rajonit të Evropës juglindore dhe qendrore, në të cilat bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, mbeten pas vendeve evropiane përëndimore në aspekt të treguesve kryesorë për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Niveli i lartë i mbylljes së institucioneve publike dhe niveli i ulët i njohjes së të drejtave të tyre elementare nga ana e qytetarëve, si dhe mungesa e partneritetit të vërtetë mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, kufizojnë procesin e përmirësimit të shërbimeve publike dhe qasjen në to. Si shtesë, zhvillimi i teknologjive dhe mundësive për digjitalizim të botës, nxitën Qeveritë në rajon. Përfshirë edhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut të iniciojnë procese të digjitalizimit të shërbimeve të caktuara dhe vendosje të teknologjive për publikim automatik të të dhënave. Shumica e iniciativave të deritanishme kanë të bëjnë me zhvillimin e produkteve që do kontribonin për përmirësim të nivelit të transparencës së institucioneve, por në pjesë të madhe një pjesë e këtyre iniciativave e shpërfillin aspektin e përfshirjes së qytetarëve dhe nuk i marrin parasysh mendimet qytetare, përkatësisht rritjen e vëllimit të të dhënave të cilat janë publikisht të disponueshme që arrihet me iniciativat e deritanishme, e duhet të kontriboj drejt aktivitetit të zmadhuar të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, e nuk i japin rezultatet e dëshiruara. Gjendja e tillë paraqitet për dy arsye, edhe atë: kompleksiteti i të dhënave që publikohen dhe pamundësia që qytetarët ti kuptojnë të njëjtat, si dhe përshkak të mosekzistimit të mekanizmave të vendosura për komunikim dyanësh mes atyre që publikojnë dhe atyre për të cilët janë të destinuara të dhënat.

Mungesa e mekanizmave për komunikim të dyanshëm mes Ministrisë së arsimit dhe shkollave të mesme me qytetarët, kontribon për besim të ulët në këto institucione dhe përgjigje e vogël, me fokus në grupet dhe mjediset e pambrojtura.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kyç afatgjat i zotimit është të vendoset sistem i organizuar dhe praktike e komunikimit të dyanshëm mes qytetarëve dhe miratuesve të vendimeve gjatë planifikimit, zbatimit dhe politikave arsimore.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi me aktivitetet e veta do të kontriboj për iniciimin e ndryshimeve dhe vendosjen e praktikave pozitive në dy nivele, edhe atë: në nivel kombëtar dhe lokal, përmes bashkëpunimit institucionet publike të lartpërmendura me organizatat e shoqërisë civile në nivel kombëtar dhe lokal. Të gjitha aktivitetet e këtij zotimi do të fokusohen në vendosjen e mekanizmave për përfshirje të mësimdhënësve dhe nxënësve në shkollat e mesme.

Zotimi do të fokusohet në: 1) vendosjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes institucionit dhe mësimdhënësve/nxënësve dhe organizatave të shoqërisë civile të përfshira në këtë zotim, ndjekje dhe zbatim i programeve arsimore, të cilat pas mbarimit të planit për veprim do ta vazhdonin bashkëpunimin dhe do të punonin në vazhdimësi në zhvillimin e politikave qëllimore. 2) zhvillim i platformave për konsulta dhe transparencë dhe punë me qytetarët e grupeve të pambrojtura në drejtim të njoftimit të tyre me të drejtat nga politikat subjekt i zotimit, përmbledhje e rekomandimeve dhe mendimeve të tyre, si dhe njoftim me mundësitë për përfshirje të ardhshme në proceset e vendimmarrjes. 3) Promovim i platformave të zhvilluara mes publikut të gjërë me qëllim të shfrytëzimit të gjërë. 4) Përmirësim i politikave/praktikës në bazë të rekomandimeve të mara dhe pjesëmarrje e qytetarëve, duke siguruar përgjigje kthyesë për statusin e hapave të ndërmarra pas rekomandimeve të dorëzuara.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse e njejta parasheh zhvillim dhe vendosje të mjeteve dhe mekanizmave për publikim të më shumë informacioneve për punën buxhetore dhe programe të institucioneve që sigurojnë shërbime arsimore. Poashtu zotimi mundëson përmirësim të kualitetit dhe disponueshmërisë e informacioneve ekzistuese dhe atyre të reja.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE përkatësisht mundëson zhvillim të mjeteve për komunikim dhe konsulta me grupet qëllimore para dhe gjatë kohës së miratimit dhe zbatimit të politikave nga sfera përkatëse. Poashtu parasheh qasje që do të nënkuptonte mobilizim dhe motivim të mësimdhënësve dhe nxënësve për pjesëmarrje aktive dhe shfrytëzim të mjeteve të vendosura.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe i njejti mundëson vendosje të mekanizmave që do të kontribojnë për përmirësimin e përgjegjësisë së funksionerëve publikë në punën e tyre.

Informacione shitesë

Ky zotim në vete përmban aktivitete që mundësojnë vendosje dhe praktikim të mekanizmave për përfshirje të mësimeve/nxënësve në proceset e vendimmarrjes në sferën e arsimit. Prandaj, të gjithë zgjidhjet e propozuara kontribuojnë drejt realizimit të qëllimeve të vendosura dhe aktiviteteve të Qeverisë së RMV-së pas dorëzimit të rishikimit vullnetar për zbatim të QZHQ në forumin e lartë politik në vitin 2020. Përkatësisht, drejt QZHQ 4. Hapi i rradsës: përmirësim i kualitetit dhe qasjes në programet arsimore për arsim të mesëm, me fokus në grupet e pambrojtura dhe përmirësim të zhvillimit të karrierës së mësimeve/nxënësve. Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet. Me masat e këtij zotimi kontribuohet drejt përmirësimit të planifikimit, zbatimit dhe ndjekjes së shërbimeve publike që do të kontribuojnë për rritjen e kënaqshmërisë së qytetarëve nga eksperiencia me shërbimet e marra publike.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.3.1	Kapacitete dhe mundësi të përmirësuara të nxënësve, mësimeve, shkollave dhe MASH bashkarisht të ndërtojnë shkollim të mesëm llogaridhënës, të disponueshëm, efektiv dhe efikas.	1. Numri i palëve të prekura të përfshira në ndërtimin e kapaciteteve për arsim të mesëm llogaridhënës, të disponueshëm, efektiv dhe efikas 2. Numri i trajnimeve të mbajtura 3. Numri i pjesëmarrësve në trajnimet e grupuara sipas kategorive në vijim (mësimeve/nxënës)	MASH, Integrity Action dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëri e Hapur-Maqedoni dhe organizata tjera që kanë eksperiencë në këtë sferë.	tetor 2021	Shtator 2023
3.3.2	Sfera prioritare të definuara për nxënësit, prindërit dhe mësimeve	1. Numri i standardeve të zhvilluara për shërbime arsimore 2. % e zbatimit të planit për investime kapitale 3. Numri i pyetjeve të identifikuar që kanë qenë subjekt i monitorimit	MASH, Integrity Action dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëri e Hapur-Maqedoni dhe organizata tjera që kanë eksperiencë në këtë sferë.	tetor 2021	shtator2023

3.3.3

Vendosje e mjeteve për monitorim:

1. Numri i pjesëmarrësve në monitorim të ndarë sipas kategorive në vijim (nxënës, prindër, mësimdhënës)

2. Numri i përdoruesve të mjeteve teknologjike

MASH, Integrity Action dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëri e Hapur-Maqedoni dhe organizata tjera që kanë eksperiencë në këtë sferë.

tetor 2021

shtator 2023

3.3.4

Aktivitete të ndërmarra për zgjidhje të problemeve të identifikuara:

1. Numri i takimeve të mbajtura
2. Numri i zgjidhjeve të identifikuara
3. Numri i takimeve me institucionet lokale dhe kombëtare për diskutim të problemeve dhe zgjidhjeve të identifikuara.
4. Numri i informacioneve të ndara për nivelin e realizimit të problemeve të identifikuara.


MASH, Integrity Action dhe Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave, ESB, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëri e Hapur-Maqedoni dhe organizata tjera që kanë eksperiencë në këtë sferë.

tetor 2021

shtator 2023

3.3.5	Transparencë e përmirësuar përmes publikimit të të dhënave dhe informacioneve në web faqet e institucioneve (institucioneve kombëtare, komunave dhe shkollave)	1. Përqindje e informacioneve të publikuara nga ata plotësisht të përgatitura 2. Përqindje e komunave që kanë publikuar së paku 2/3 e informacioneve	NJVL dhe ILA, ISHA, BZHA, Metamorfozis	tetor 2021	shtator 2023
3.3.6	Mekanizëm i vendosur për publikim ligjor të resurseve të hapura kualitative arsimore në platformat zyrtare arsimore	1. Numri i resurseve të publikuara nga fillimi i kampanjës nga ana e institucioneve (BZHA).	MASH, BZHA, FSHHM dhe Metamorfozis	tetor 2021	shtator 2023

Të gjithë aktivitetet e propozuara nën këtë zotim janë të reja dhe nënkuptojnë plotësim të aktiviteteve nga PKV 4.



Institucion udhëheqës
për zbatim

Ministria e arsimit dhe shkencës

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Dushan Tomshiq, MASH

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

dusan.tomsik@mon.gov.mk

Telefon

/

Ministri/
Agjencione

Shkollat e mesme, Byroja për
zhvillim të arsimit dhe Inspektorati
shtetëror për arsim

andrijana.tomovska@gmail.com

marijaisovska@bro.gov.mk

Subjekte të tjera të
përfshira


Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

1. Fondacioni Shoqëri e Hapur-
Maqedoni – Natasha Angeleska,
natasa.angjeleska@fosm.mk

dhe Suzana Pecakovska,
suzana.pecakovska@fosm.mk

2. Metamorfozis – Qëndresa
Sulejmani, qendresa@metamorphosis.org.mk

3. IntegrityAction, JasminaHaynes,
jasmina.haynes@integrityaction.org





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.4. Shërbime publike dhe politika të bazuara në prioritetet qytetare nga sfera e ofrimit të shërbimeve publike lokale

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Vendet e rajonit të Evropës juglindore dhe qendrore, në të cilat bën pjesë edhe Republika e Maqedonisë së Veriut, mbeten pas vendeve evropiane përëndimore në aspekt të treguesve kryesorë për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve. Niveli i lartë i mbylljes së institucioneve publike dhe niveli i ulët i njohjes së të drejtave të tyre elementare nga ana e qytetarëve, si dhe mungesa e partneritetit të vërtetë mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, kufizojnë procesin e përmirësimit të shërbimeve publike dhe qasjen në to. Si shtesë, zhvillimi i teknologjive dhe mundësive për digjitalizim të botës, nxitën Qeveritë në rajon. Përfshirë edhe Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut të inicojnë procese të digjitalizimit të shërbimeve të caktuara dhe vendosje të teknologjive për publikim automatik të të dhënave. Shumica e iniciativave të deritanishme kanë të bëjnë me zhvillimin e produkteve që do kontribonin për përmirësim të nivelit të transparencës së institucioneve, por në pjesë të madhe një pjesë e këtyre iniciativave e shpërfillin aspektin e përfshirjes së qytetarëve dhe nuk i marrin parasysh mendimet qytetare, përkatësisht rritjen e vëllimit të të dhënave të cilat janë publikisht të disponueshme që arrihet me iniciativat e deritanishme, e duhet të kontriboj drejt aktivitetit të zmadhuar të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, e nuk i japin rezultatet e dëshiruara. Gjendja e tillë paraqitet për dy arsye, edhe atë: kompleksiteti i të dhënave që publikohen dhe pamundësia që qytetarët ti kuptojnë të njejtat, si dhe përshkak të mosekzistimit të mekanizmave të vendosura për komunikim dyanësh mes atyre që publikojnë dhe atyre për të cilët janë të destinuara të dhënat. Mungesa e mekanizmave për komunikim të dyanshëm mes vetëqeverisjes lokale dhe qytetarëve, kontribon për besim të ulët të shfrytëzuesve në shërbimet lokale dhe përgjigje e vogël, me fokus në grupet dhe mjediset e pambrojtura në nivel lokal.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllim kryesor afatgjat i zotimit është të vendoset sistem i organizuar dhe praktikë e komunikimit të dyanshëm mes qytetarëve dhe atyre që i marrin vendimet gjatë planifikimit, zbatimit dhe evaluimit të shërbimeve lokale publike.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi me aktivitetet e veta do të kontriboj për inicim të ndryshimeve dhe vendosje të praktikave pozitive në nivel lokal, përmes bashkëpunimit të institucioneve publike të lartpërmendura me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal. Të gjithë aktivitetet e këtij zotimi do të fokusohen në vendosjen e mekanizmave për përfshirje të qytetarëve që shfrytëzojnë shërbime të ofruara nga vetëqeverisja lokale nëpër vend.

Zotimi do të fokusohet në: 1) vendosjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm mes ministrit/drejtorit/sekretarit shtetëror për planifikim, ndjekje dhe zbatim të shërbimeve publike lokale dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira në këtë zotim, të cilat pas mbarimit të planit për veprim do ta vazhdonin bashkëpunimin dhe do punonin në vazhdimësi për zhvillimin e politikave qëllimore dhe shërbimet. 2) zhvillim i platformave për konsulta dhe transparencë dhe punë me qytetarët nga grupet e pambrojtura në drejtim të njoftimit të tyre me të drejtat nga politikat lëndore, përmbledhje e rekomandimeve dhe mendimeve të tyre, si dhe njoftim me mundësitë për përfshirje të ardhshme në proceset e vendimmarrjes. 3) Promovim i platformave të zhvilluara mes publikut të gjërë me qëllim shfrytëzim të gjërë. 4) Përmirësim i politikave/shërbimeve/praktikës në bazë të rekomandimeve të marra për pjesëmarrje të qytetarëve, me ofrim të përgjigjes kthyesë për statusin dhe hapat e ndërmarra pas propozimeve të dorëzuara.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse i njehti parasheh zhvillim dhe vendosje të mjeteve dhe mekanizmave për publikim të më shumë informacioneve për punën buxhetore dhe programore të institucioneve që mundësojnë shërbime publike lokale. Poashtu, zotimi mundëson përmirësim të kualitetit dhe disponueshmërisë së informacioneve ekzistuese dhe atyre të reja.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE sepse mundëson zhvillim të mjeteve për komunikim dhe konsulta me grupet qëllimore para dhe gjatë kohës së miratimit dhe zbatimit të politikave nga sfera përkatëse dhe parasheh qasje që do nënkuptonte mobilizim dhe motivim të qytetarëve për pjesëmarrje aktive dhe shfrytëzim i mjeteve të vendosura.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe i njehti mundëson vendosje të mekanizmave që do kontribojn për përmirësim të përgjegjësisë së funksionerëve publik në punën e tyre.

Informacione shitesë

Ky zotim në vete përmban aktivitete që mundësojnë vendosje dhe praktikim të mekanizmave për përfshirje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në sferën e shërbimeve lokale publike. Prandaj, të gjithë zgjidhjet e propozuara kontribuojnë drejt realizimit të qëllimeve të vendosura dhe veprimeve të Qeverisë së RMV-së pas dorëzimit të rishikimit vullnetar për zbatim të QZHQ në forumin e lartë politik në vitin 2020. Përkatësisht, drejt QZHQ 2.Hapi i rradhës: Qeveria do të fokusohet në masat për përmirësim të strukturës së tokës bujqësore si parakusht për zhvillim dhe konkurrencë në sektor, përmirësim të kushteve për jetesë dhe punë në pjesët rurale dhe ofrim i qasjes në njohuri dhe investime në kapital njerëzor përmes shërbimeve të reformuara për zhvillim dhe edukim të bujqërve. QZHQ 5 Hapi i rradhës: Një nga prioritetet kyçe të vendit në vitet e ardhshme edhe më tej do të jetë përmirësimi i mundësive për punësim të grave dhe mbrojtja e tyre në vendin e punës. Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet. Me masat e këtij zotimi kontribuohet drejt përmirësimit të planifikimit, zbatimit dhe ndjekjes së shërbimeve publike që do të kontribuojnë drejt zmadhimit të kënaqshmërisë së qytetarëve nga eksperiencia me shërbimet e marra publike.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.4.1	Është vendosur mekanizëm uniform i zbatueshëm për të gjithë komunat për konsulta dhe komunikime me qytetarët për dhënie të inputit nga qytetarët gjatë krijimit të shërbimeve lokale dhe alokimit të mjeteve për zbatim të tyre në buxhetet lokale, me fokus të qytetarëve nga hapësira rurale dhe të marginalizuara	1. Vendorsje e mekanizmit uniform për publikim të informacionve(po/ jo) 2. Numri i informacioneve të publikuara 3. Vendorsje e mekanizmit uniform për përfshirje të qytetarëve (po/ jo) 4. Numri i qytetarëve të përfshirë 5. Vendorsje e mekanizmit uniform për ofrim të mendimit kthyes të qytetarëve në bazë të rekomandimeve të tyre (po/ jo) 6. Numri i qytetarëve të cilët kanë dhënë informacion kthyes	MVL dhe Koalicioni Rural	tetor 2021	shtator 2023

Ky zotim mundëson vendorsje të qëndrueshmërisë së zotimit 5.3. nga PKV4.

Institucion udhëheqës
për zbatim

MVL

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Eli Çakar, MVL

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

elicakar@gmail.com

Telefon

/


Ministri/
Agjencione

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

1. Koalicioni Rural- Liljana
Jonoski,
liljana.jonoski@gmail.com





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.5. E-shërbime të disponueshme në zonat rurale

Tetor 2021 – qershor 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Mospasja e informacionit për ekzistim të portalit Kombëtar për shërbime elektronike uslugi.gov.mk (Portali) dhe të gjithë të dhënat e disponueshme në të; mospasja e njohurive të mjaftueshme digjitale nga popullata lokale për përdorim të e-shërbimeve të Portalit; mospasja e besimit në institucione dhe besimit në komunikimin elektronik.

Në programin e parë IPARD kemi shfrytëzuar vetëm 16% ndërsa një pjesë e arsyeve vijnë nga dokumentacioni vëllimor dhe shëtitja nga sporteli në sportel që për bujqërit nënkupton kohë të harxhuar, dhe mjete të cilat edhe nuk i kanë shumica në dispozicion.

Ngarkesa e tepërt e institucioneve që tregohet me informacionet përshkruese në vijim: në periudhën e aplikimit për subvencione ose për thirrje publike në njësitë rajonale të MBPEU grupimet nga bujqërit, edhe atë disa persona për një të punësuar, me çka edhe vetë të punësuarit nuk arrijnë në kohë të evidentojnë dhe të kontrollojnë gjithçka, dhe shpesh bëhen gabime në evidentime në sistemin elektronik gjë e cila shpesh mund të nënkuptojë mosmiratim i pagesës së subvencioneve; grupimet para sporteleve ishin të dukshme edhe gjatë kohës së krizës së Koronës, shembull nëse të gjithë kishin mundësi lejet për lëvizje gjatë orës policore ti marrin në mënyrë elektronike, nuk ishte rasti i tillë me bujqërit në emër të të cilëve aplikonin nëpunësit në njësitë rajonale të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, e pastaj përsëri krijoheshin grupime që të merren lejet në verzionin letër, dhe kjo ishte njëra nga arsyet përse MBPEU pastaj vendosi leja e dhënë një herë të vlejë për gjithë kohëzgjatjen e orës policore.

Shtyrrja e kohës dhe kualitetit të shërbimit të marrë, shembull për një vërtetim nga komuna se investimi juaj është në pajtim me strategjinë e ZHEL dhe se nuk ka ndikim mbi ndotjen e mjedisit jetësor shkoni 10 ditë me radhë dhe në fund mund të ndodh ta marrin me të dhëna të gabuara, që shpeshherë bujqërve ju kushton me mos aprovimin e investimit. Numër të madh të shembujve i kemi në rajonin e Pellagonisë, saktësisht në Krivogashtan. Vendosja e të dhënave të gabuara nga ana e nëpunësve që shpesh rezulton me humbjen e mbështetjes financiare, shembull subvencioneve etj, veçanërisht në pjesën e vendosjes së të dhënave dhe parcelave të pronës dhe kulturave që i ka

bujku veçanërisht gjatë aplikimit elektronik për subvencione të cilën e bëjnë ata sepse bujqërit nuk dijnë, e atë e bëjnë për mbi 90.000 bujqër të cilët shpesh paraqiten 10 ditë para skadimit të afatit, ose komunat vendosin të dhëna të gabuara për personin ose ekonominë bujqësore dhe ajo shkon deri në pafundësi; varësia e tepërt nga nëpunësit në institucionet lokale; më shumë kohë dhe mjete harxhojnë banorët në mjediset rurale krahasuar me ata që jetojnë në mjediset urbane etj; parë nga aspekti i bujqërve dhe popullatës rurale të cilët janë marrë si grup qëllimor që të zbërthehet problemi, edhe pse këta shërbime nuk do ti shfrytëzojnë vetëm bujqërit por në përgjithësi popullata lokale, gjë që e konfirmon edhe hulumtimi i fundit në teren i Koalicionit Rural- Një pjesë e deklaratave të tilla ose mendimeve të tilla mund ti gjeni edhe në hulumtimin e fundit të KR - <https://rural.mk/wp-content/uploads/2021/04/%D0%B0%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0-%D0%B4%D0%B8%D0%B3%D0%B8%D1%82%D0%B0%D0%BB%D0%B8%D0%B7%D0%B0%D1%86%D0%B8%D1%98%D0%B0-1.pdf> bëhet fjalë për më shumë se 170.000 ekonomi familjare bujqësore të evidentuara që shumë herë gjatë vitit kanë nevojë për shërbimet e lartpërmendura, siç janë subvencione, aplikime për thirrje publike nga IPARD dhe programi për zhvillim rural ku jano të nevojshme mes të tjerash edhe M1/M2, vërtetim për tatime të paguara, vërtetime nga komuna për pajtueshmëri të investimit me ZHEL, vërtetime për procedura falimentimi, likuidimi, gjendje aktuale, se nuk është shqiptuar ndalesë për kryerje të detyrës ose veprimtarisë etj. Domethënë, numri më i madh i dokumenteve, përkatësisht shërbimeve që janë përmendur më lartë kërkohen gjatë aplikimit për subvencione, për aplikime për mbështetje financiare nga Programi për zhvillim rural ku mundësohen investime për modernizim të ekonomive bujqësore dhe përparim të zhvillimit rural, me çka bëhet fjalë për shfrytëzim të mjeteve në vlerë më të madhe se 200 milionë euro në vit. Poashtu, dokumentacioni i tillë nevojitet gjatë aplikimit për IPARD programin që është shumë i rëndësishëm, sepse ndikon direkt në përqindjen e shfrytëzimit të programit IPARD.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i zotimit është përafrimi i portalit kombëtar për e-shërbime tek qytetarët nga zonat rurale dhe rritje e besimit dhe sigurisë në komunikimin elektronik me institucionet

Rezultate:

- Informim më i madh i qytetarëve në hapësirën lokale për portalin uslugi.gov.mk
- Njohuri më të mëdha dhe aftësi të popullatës rurale për përdorim të e-shërbimeve të disponueshme në Portal uslugi.gov.mk

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Përmes rritjes së disponueshmërisë dhe shfrytëzimit të e-shërbimeve në zonat rurale, jo vetëm që kontribuohet drejt zgjidhjes së problemit por në të njejtën kohë kontribuohet drejt përmirësimit të procesit të digjitalizimit të shoqërisë, e që gjatë këtij procesi asnjë qytetarë të mos lihet anash. Poashtu, përmes shfrytëzimit të rritur të e-shërbimeve rritet edhe besimi në institucione, edhe në përgjithësi në shtet, dhe në të njejtën kohë përmirësohet edhe kualiteti i jetës në bashkësi. Poashtu, realizimi i këtij zotimi do ta përshpejtojë procesin e digjitalizimit të shërbimeve që i japin komunat, dhe do të rriten kapacitetet dhe njohuritë e popullatës lokale me vendosjen e kurikulës së veçantë për përparim të njohurive dhe aftësive për digjitalizim dhe kontribuohet drejt realizimit të agjendës digjitale dhe kahjeve strategjike në këtë temë të vendosura në nivel kombëtar.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të shumta dhe të reja, si dhe përmirëson qasjen në informacione nga ana e publikut.

Informacione shtesë

Zotimi i këtillë është në pajtim dhe kontribon drejt realizimit të prioriteteve dhe qëllimeve të parapara në disa dokumente strategjike edhe atë: Strategjia për transparencë e Qeverisë së RMV 2019-2021

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhëse dhe transparente në të gjitha nivelet. Me masat e këtij zotimi kontribuohet drejt përmirësimit të njohurive dhe aftësive të qytetarëve për ofrim të shërbimeve publike elektronike dhe në mënyrë të shpejtë.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.5.1	Është zbatuar fushatë për promovim të shërbimeve drejt qytetarëve të cilat qytetarët mund ti marrin në formë elektronike, në vend se në sportel. (Aktiviteti do të jetë përfshirë në aktivitetet e rregullta këshilldhënëse të ANZHB, ndërsa informacionet e distribuara tek bujqërit dhe përmes njësive rajonale të MBPEU dhe përmes AMFBZHR.)	1. Numri i informacioneve të publikuara dhe të shpërndara për e-shërbimet e disponueshme në uslugi.gov.mk në zonat rurale 2. Numri i e-shërbimeve të realizuara përmes portalit uslugi.gov.mk në nivel vjetor	MSHIA, Koalicioni Rural, ANZHB, njësitë rajonale të MBPEU, AMFBZHR	tetor 2021	Qershor 2023
3.5.2	Është vendosur rrjet lokal i ndërmjetësuesve mobilë për promovim dhe ndërmjetësim në qasjen në Portalin uslugi.gov.mk	1. numri i ndërmjetësuesve mobilë për përdorim të e-shërbimeve nëpër komuna 2. Numri i e-shërbimeve të marra përmes Portalit uslugi.gov.mk	Koalicioni rural, MSHIA	tetor 2021	qershor 2023

3.5.3

Është përpiluar „Analizë dhe përshkrim i shërbimeve në sektorin bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave me priorizim të shërbimeve, si dhe evidentim i të dhënave“ dhe evidentim dhe verifikim i shërbimeve të identifikuar në Katalogun e shërbimeve (në pajtim me Ligjin për menaxhim elektronik të shërbimeve elektronike)

1. Numri i shërbimeve të reja të përfshira në Katalogun nga ana e MBPEU
2. Numri i informacioneve të publikuara për shërbime nga MBPEU në Portalin uslugi.gov.mk
3. Numri i e-shërbimeve të reja të disponueshme në Portalin uslugi.gov.mk
4. Numri i shërbimeve të digjitalizuara në sektorin bujqësi dhe zhvillim rural (objektivi 10)

MSHIA, MBPEU, Koalicioni rural, grupet nënsektoriale të përhershme dhe partnerët tjerë socio-ekonomik të MBPEU

tetor 2021

qershor 2023

3.5.4

Është zhvilluar kurikulë për edukim të qytetarëve për aftësi elementare digjitale i destinuar për mjedise rurale dhe të marginalizuara (njohuri elementare kompjuterike-zoom, internet etj) dhe zbatim i trajnimeve.

1. Numri i trajnimeve të zbatuara në zona rurale në nivel vjetor
2. Numri i qytetarëve të trajnuar në zona rurale dhe të marginalizuara
3. Numri i ndërmarrjes së materialeve për trajnim


Koalicioni rural, MSHIA dhe MBPEU

tetor 2021

qershor 2023

Zotim i ri

Institucion udhëheqës për zbatim	MSHIA	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Rozalinda Stojova Nadica Josifovski	
Funksioni, Departamenti	Udhëheqës sektori Këshilltar shtetëror	
Email	rozalinda.stojova@mioa.gov.mk nadica.josifovski@mioa.gov.mk	
Telefon	/	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	MBPEU, Aleksandar Musalevski, a.musalevski@mzsv.gov.mk MNPEU, Femi Isen, femi.isen@mzsv.gov.mk
	Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	Koalicioni rural, Liljana Jonoski, liljana.jonoski@gmail.com





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIK

3.6. Rritje e qasjes në format e organizuara të mbrojtjes së viktimave të tregëtisë me njerëz

tetor 2021 – qershor 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Në periudhën prej vitit 2005 deri në 2019 janë identifikuar 116 viktima të trafikimit me njerëz (TNJ). Që nga viti 2014 e këtej, i vogël është numri i viktimave të identifikuar e cila para së gjithash, vjen si pasojë e mungesës së identifikimit aktiv nga ana e institucioneve kompetente. Përvojat në praktikë shpesh tregojnë që identifikimi i viktimave mbetet diku mes labirinteve të institucioneve shtetërore. Në kontekst të njejtë, është vërejtur rast në vitin 2019 në të cilin një vajzë e mitur, vullnetarisht, me mbështetje të një miku, ka vendosur të paraqesë në një nga institucionet kompetente se është viktimë e tregëtisë me njerëz. Mirëpo, nga rasti ka rezultuar që vajza e mitur veçmo ka pasur kontakte me atë institucion kompetent, ndërsa institucioni nuk e ka njohur rastin si rast i viktimës së tregëtisë me njerëz.

Përshtypje e përgjithshme është se përmbajtja dhe formati i të dhënave të prezantuara në raportet vjetore për tregëti me njerëz, nuk korespondojnë me nevojën për përcaktim të progresit që e bën shteti në këtë drejtim. Si shtesë, mungon qasja analitike e gjendjeve të prezantuara, si dhe evaluimi i të arriturave kundrejt qëllimeve të vendosura përmes të cilave do të matet progresi në të ardhmen. Ky ndikimi mbi paraqitjen e përshtypjes negaitve mbi përparimin e shtetit nga ana e trupave ndërkombëtare dhe qytetarëve por nga ana tjetër edhe vështirësi në vendimmarje dhe zbatim të ndryshimeve të harmonizuara me standardet ndërkombëtare.

Në Ministrinë e drejtësisë ekziston program përmes të cilit duhet të sigurohet pagesë e kompenzimit për fëmijët-viktimë e tregëtisë me njerëz nëse ajo nuk mund të sigurohet nga kryerësi.

Viktimat pas lënies së strehimores më shpesh ballafaqohen me papunësi, problem me vendbanimin edhe pse në programin për riintegrim të viktimave të TNJ punësimi, vendbanimi, vazhdimi i shkollimit janë renditur si elemente kryesore në procesin e tyre të riintegrit. Në vendin tonë nuk ekzistojnë programe të veçanta dhe masa me të cilat viktimat do të mund të jenë të përfshirë në procesin e punës në drejtim të përforcimit ekonomik. Viktimat e tregëtisë me njerëz nuk i shfrytëzojnë masat aktive për punësim të siguruara nga shteti përmes Agjencionit për punësim për arsye sepse APRMV nuk ka sistem të veçantë me të cilin do garantohet mbrojtja e të dhënave personale dhe statusi i personave-viktima.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i këtij zotimi është përforcim i luftës kundër tregëtisë me njerëz në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe ofrimi i mbrojtjes efikase të viktimave.

Si rezultate specifike që priten nga ky zotim janë:

- Numër i rritur i viktimave të identifikuara të tregëtisë me njerëz dhe shërbime të ofruara
- Transparencë dhe llogaridhënie e zmadhuar e institucioneve që punojnë në çështjen e tregëtisë me njerëz
- Informim më i madh dhe qasje për viktimat e tregëtisë me njerëz në shërbimet shëndetësore, punësim dhe drejtësi

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi do të kontriboj drejt zgjidhjes së problemit publik përmes vendosjes së masave efektive nga ana e institucioneve në drejtim të qasjes më të mirë në shërbime dhe informimit më të madh të viktimave të tregëtisë me njerëz. Zgjidhjet do të zbatohen përmes realizimit të më shumë aktiviteteve që do të zbatohen në partneritet me organizatat e shoqërisë civile. Në këtë mënyrë, masat përfshijnë vendosjen e ekipeve që do punojnë në teren dhe do kontribojnë drejtë identifikimit të përmirësuar të viktimave të tregëtisë me njerëz. Do të vendoset bazë funksionale e të dhënave dhe do të punohet në revidimin dhe përmirësimin e sistemit ekzistues për mbledhje të të dhënave, me çka do të mundësohet ofrim i të dhënave publikisht të disponueshme përmes të cilave do mund të ndiqet progresi i shtetit në drejtim të ndalim të tregëtisë me njerëz dhe mbrojtje të viktimave.

Si shtesë zotimi do të kontriboj drejt rritjes së kapaciteteve të personelit mjekësor për njohje dhe veprim në rast të tregëtisë me njerëz. Viktimat e tregëtisë me njerëz dhe publiku do të informohen për ekzistimin e REP qendrave dhe për disponueshmërinë e tyre për shërbim.

Poashtu, masat do të kontribojnë për informim më të madh të viktimave dhe përfaqësuesve të tyre për të drejtën e kompenzimit të dëmit për fëmijët dhe të rriturit viktimat të tregëtisë me njerëz. Do të krijohen programe dhe masa me të cilat viktimat do të mund të jenë të përfshirë në procesin e punës në drejtim të përforcimit ekonomik.

**Pse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN

Zotimi ndikon direkt në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve që punojnë në çështjen e tregëtisë, veçanërisht në kontekstin e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Propozim zgjidhjet janë në drejtim të qasjes në informacione më të shumta dhe të reja për publikun dhe viktimat e tregëtisë me njerëz në drejtim të shërbimeve për mbrojtje dhe drejtësi.

Masa konkrete parashohin ofrimin e qasjes në informacione kualitative fillimisht për viktimat por edhe për përfaqësuesit e publikut të përgjithshëm në R.M.V nga ana e institucioneve.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE

Propozim zgjidhjet do të mundësojnë bashkëpunim më të mirë mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve përmes shpërndarjes së informacioneve dhe veprimit në rast të tregëtisë me njerëz mes MPB, shoqatave qytetare dhe institucioneve tjera kompetente. Viktimat do të jenë aktivisht të përfshirë në përmirësimin e masave dhe politikave të propozuar. Veçanërisht do të jenë të përfshirë në drejtim të pjesëmarrjes në krijimin e kampanjave, rritje të informimit dhe përgatitje e programeve specifike për viktimat e tregëtisë me njerëz..

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE

Një pjesë e masave në mënyrë direkte parashohin llogaridhënie të rritur të institucioneve në drejtim të të dhënave të disponueshme për tregëtinë me njerëz. Me krijimin e sistemit dhe ofrimin e të dhënave publikisht të disponueshme përmes të cilave do të mund të ndiqet progresi që shteti e bën në fushën e ndalimit të tregëtisë me njerëz dhe mbrojtje të viktimave.

**Informacione
shtesë**

Këto zotime janë direkt të lidhura dhe në drejtim të njejtë me Strategjinë e re dhe Planin për veprim (PKV) për luftë kundër tregëtisë me njerëz dhe migrimi ilegal 2021-2025. Si shtesë një pjesë e zotimeve janë në pajtueshmëri me Planin për veprim për zbatim të konventës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunën familjare në RMV 2018-2023.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.3: Promovim i sundimit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe ofrim i qasjes së njejtë në drejtësi për të gjithë. Me masat e këtij zotimi do të përmirësohen masat e institucioneve për evidencë dhe ofrim të qasjes më të mirë në shërbime dhe informim më i madh i viktimave të tregëtisë me njerëz.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.6.1	Janë vendosur ekipe mobile për punë në teren në zonat e Ohrit dhe Strugës, dhe në zonën e Shtipit dhe qyteteve përreth	1. Numri i ekipeve mobile të vendosura	MPPS, Komisioni kombëtar	tetor 2021	dhjetor 2021
3.6.2	Mbledhje sistematike e të dhënave për tregëti me njerëz përmes shfrytëzimit të mjeteve të disponueshme për monitorim dhe evaluim të gjendjeve të tregëtisë me njerëz në RMV dhe publikimin e tyre të rregullt.	2. Numri i treguesve të zgjedhur të përshtatshëm për ndjekje dhe mbledhje të të dhënave 3. Vendosje e zgjidhjes funksionale për mbledhje të të dhënave (po/jo) 4. Numri i analizave të publikuara për gjendjen e tregëtisë me njerëz në RMV	Komisioni kombëtar dhe organizatat e shoqërisë civile dhe Porta e Hapur	tetor 2021	qershor2023 (aktuale)
3.6.3	Vendosje e bazës së të dhënave për procedura të ngritura dhe raste të identifikuara të eksploatimit online të fëmijëve dhe publikim i rregullt i tyre. Raportet me të dhënat e ndjeshme (raporte interne) do të përdoren për udhëheqje të rasteve. Të dhënat	1. Vendosje e bazës funksionale të të dhënave (po/jo) 2. Numri i raporteve të publikuara me karakter privat/publik	MPB, organizatat e shoqërisë civile, Porta e Hapur	tetor 2021	Qershor 2022

do të publikohen edhe në raporte me karakter publik të cilat do të jenë në formë gjenerale në pajtim me ligjin për mbrojtje të të dhënave personale, mbrojtje të identitetit dhe privatësisë në pajtueshmëri me Konventën e Këshillit të Evropës për mbrojtje të personave gjatë përpunimit automatik të të dhënave (ETS No. 108).

3.6.4

Realizim i të drejtës së kompenzimit të fëmijëve- viktimat të tregëtisë me njerëz përmes miratimit dhe publikimit të:
-Programit për kompenzim të fëmijëve viktimat në pajtim me Ligjin për drejtësi për fëmijët dhe
-Informacion për zbatimin e Programit për kompenzim të fëmijëve viktimat.

1. Përqindje e zbatimit të Programit për kompenzim të fëmijëve viktimat
2. Numri i publikimeve publike informative për të drejtën e kompenzimit dhe qasjen në Programin për kompenzim në web faqet dhe rrjetet sociale të MD.

MD, Organizatat e shoqërisë civile, Porta e Hapur

tetor 2021

korrik 2022

3.6.5

Janë zbatuar aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe informimit të publikut dhe të viktimave për realizim të të drejtave të parapara me Ligjin për pagesë të kompensimit në të holla të viktimave nga veprat penale (ky aktivitet do të fillojë me zbatim pasi të miratohet ligji)

1. Numri i publikimeve publike informative në rrjetet sociale dhe web platformë për të drejtën e kompensimit dhe qasjen në Komisionin për kompensim
2. Materiale të printuara dhe të distribuara për të drejtën e kompensimit në të holla dhe procedurën në pajtim me Ligjin.

MD

tetor 2022

qershor 2023

3.6.6

Janë zbatuar trajnime të rregullta të personelit mjekësor për përforcim të njohurive të tyre për format e paraqitura të tregëtisë me njerëz, sistemin ekzistues për aplikim dhe ndihmë dhe mbështetje, në drejtim të identifikimit, paraqitjes dhe udhëzimit të viktimave të tregëtisë me njerëz.

1. Numri i trajnimeve të zbatuara (objektiv: 2 në vit)
2. Numri i pjesëmarrësve në trajnime

MSH,
Organizatat e shoqërisë civile dhe Porta e hapur

tetor 2021

qershor 2023
(aktuale)

3.6.7	Janë zbatuar fushata informative për inkurajim të grave dhe vajzave të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje në rast të dhunës seksuale, përmes njohjes së publikut me punën dhe shërbimet që i ofrojnë REP Qendrat.	1. Numri i fushatave të zbatuara (objektiv: 1 në vit) 2. Numri i publikimeve në media	MSH, Organizatat e shoqërisë civile dhe Porta e hapur	tetor 2021	qershor 2023 (aktuale)
3.6.8	Vendosje e standardeve minimale për mundësim të kujdesit mjekësor për viktimat e tregëtisë me njerëz.	1. Është përpiluar analizë komparative (po/jo) 2. Është zbatuar vizitë studimore (po/jo) 3. Standarde të përgatitura (po/jo) 4. Numri i takimeve të zbatuara për përgatitje të standardeve	MSH, Mekanizëm kombëtar për udhëzim (MKU), organizatat e shoqërisë civile dhe Porta e hapur	tetor 2021	qershor 2023 (aktuale)
3.6.9	Janë vendosur programe për rikualifikim dhe ndërtim të aftësive për të rriturit dhe fëmijët potencial dhe/ose viktimat të TNJ me qëllim përgatitje e tyre më e madhe për punësim, përforcim riintegrim.	1. Numri i pjesëmarrësve në trajnimet për rikualifikim dhe arritje të aftësive për viktimat dhe/ose potenciale të TNJ.	MPPS, Komunitat/ komisionet lokale për luftë kundër TNJ, organizatat e shoqërisë civile dhe Porta e hapur	tetor 2021	qershor 2023 (aktuale)

Zotim i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

MPPS
MPB

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

E. Grozdanova
Susana Novakovska

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror,
Mekanizmi kombëtar për udhëzim të viktimave të TNj

Email

EGrozdanova@mtsp.gov.mk
Susana_Novakoska@moi.gov.mk

Telefon

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

MD,
TKikerekova@mjustice.gov.mk


MSH,
biljana.babushkovska@zdravstvo.gov.mk

Komunat/ Komisionet lokale për
luftë kundër tregëtisë me njerëz

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Porta e Hapur, Marija Todorovska
mtodorovska@lastrada.org.mk

Maja Varoshlija,
mvaroslija@lastrada.org.mk





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBBIMEVE PUBLIKE

3.7. Përmirësim i mekanizmave për mbrojtje të viktimave të shqetësimit në vend të punës

tetor 2021 - qershor 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Në RMV mungon statistika për numrin e viktimave të mobingut. Sidoqoftë sipas hulumtimeve të ONP mbi 4% e të punësuarve janë subjekt i dhunës psikike, 2% të keqpërdorimit seksual dhe 8% të frikësimit dhe keqtrajtimit. Nëse meret parasysh kjo statistikë, në RMV nga numri i përgjithshëm i të punësuarve llogaritet se ka 111.936 viktimave të mobingut. Që nga viti 2013 kur është miratuar ligji për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës, ka vetëm dy raste të inicuar dhe të zgjidhura me sukses dhe njëri është në vijim. Sipas të dhënave nga SOS linja për paraqitje të shqetësimit në vend të punës për vetëm dy muaj në vitin 2020 janë evidentuar 65 thirrje për ndihmë dhe mbështetje, në të cilat më shumë se gjysma janë gra. Gjendja e tillë është rezultat i mosinformimit të mjaftueshëm të të punësuarve në lidhje me këtë dukuri, duke përfshirë edhe mekanizmat për mbrojtje. Ndërmjetësuesit në këta procedura të emëruar tek çdo punëdhënës janë jo mjaftueshëm të edukuar për ato se cili është vendi dhe roli i tyre në sistemin e mbrojtjes së të punësuarit. Moszbatimi i plotë i marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtje në lidhje me këto çështje, përkatësisht mosratifikimi i Konventës 190 dhe rekomandimit 206 të ONP, dhe moszbatimi i proceseve konsultuese me të gjitha palët e prekura gjatë përgatitjes së zgjidhjeve ligjore me këtë dukuri në shtet.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i zotimit është të përmirësohet mekanizmi tashmë i vendosur për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Përmes zbatimit të këtij zotimi do të mundësohet informim i të punësuarve për të drejtat e tyre për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës që rrjedhin nga ligji mbi marrëdhëniet e punës për çka deri më tani nuk është vendosur sistem, edukim i personave të pavarur të zgjedhur si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhje të rasteve të identifikuar të mobingut për çka deri më tani nuk është vendosur sistem, ratifikim i Konventës 190 dhe rekomandimit 209 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës e cila deri më tani nuk është ratifikuar, vendosje e sistemit elektronik dhe publik për paraqitje dhe ndjekje të statusit dhe zbatimit të procedurave të inicuar për shqetësim në vend të punës, dhe vendosje dhe funksionim i grupit të punës nga praktikues për inicim të ndryshimeve të ligjit për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN, dhe i njeiti mundëson qasje në informacione më të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën mbi informacione.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE dhe i njeiti krijon mundësi dhe kushte për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve, dhe i rrit mundësitë e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIEN PUBLIKE dhe i njeiti mundëson vendosjen e mekanizmave që do të kontribuojnë për përmirësim të përgjegjësisë së funksionerëve publikë në punën e tyre.

Informacione shtesë

Ky zotim në vete përmban aktivitete që do të kontribuojnë drejt realizimit të qëllimeve të vendosura dhe veprimeve të Qeverisë së RMV pas dorëzimit të rishikimit vullnetar për zbatim të QZHQ të forumit të lartë politik në vitin 2020. Përkatesisht, drejt **QZHQ 1. Hapi i rradhës:** Mbështetje për punësim të personave të pambrojtur përmes masave të parapara në Strategjinë kombëtare për punësim dhe Strategjinë për formalizim të ekonomisë joformale, si dhe Planet operative për programe aktive dhe masat për punësim dhe shërbimet në tregun e punës; **QZHQ 2. Hapi i rradhës:** Qeveria do të fokusohet mbi masat për përmirësim të strukturës së tokës bujqësore si parakusht për zhvillim dhe konkurrencë në sektor, përmirësim të kushteve për jetesë dhe punë në zonat rurale dhe ofrim i qasjes në njohuri dhe investime në kapital njerëzor përmes shërbimeve të reformuara për zhvillim dhe edukim të bujqërve. **QZHQ 5 Hapi i rradhës:** Një nga prioritetet kyçe në vitet e ardhshme dhe më tej do të jetë të përmirësohen mundësitë për punësim të grave dhe mbrojtja e tyre në vendin e punës. **QZHQ 8 Hapi i rradhës:** Qeveria do të ndjek programet dhe aktivitetet e përmendura në planet relevante për veprim dhe krijim të vendeve të punës, përmirësim të pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe rritje e kërkesës për fuqi punëtore dhe rritje e konkurrencës. Poashtu, do të vazhdojë të harmonizojë legjislacionin e punës me standardet ndërkombëtare të punës dhe me legjislacionin e BE-së.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm, lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet.

Informim i të punësuarve për të drejtat e tyre për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës që rrjedhin nga ligji mbi marrëdhëniet e punës

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.7.1	Të informuar të punësuar në sektorin publik dhe privat për të drejtat e tyre për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës të cilat rrjedhin nga ligji mbi marrëdhëniet e punës	1. Udhëzim i përgatitur (po/jo)	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut	tetor 2021	shtator 2023
		2. Numri i punëdhënësve deri tek të cilët është distribuuar udhëzimi i përpiluar.	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut		
3.7.2	Edukim i personave të zgjedhur të pavarur në sektorin publik dhe privat si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhje të rasteve të identifikuara të mobingut.	3. Plan i përgatitur për promovim (po/jo)	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut	tetor 2021	shtator 2023
		4. Numri i personave të përfshirë në promovim	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut		
3.7.2	Edukim i personave të zgjedhur të pavarur në sektorin publik dhe privat si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhje të rasteve të identifikuara të mobingut.	5. Plan i përgatitur për promovim (po/jo)	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut	tetor 2021	shtator 2023
		6. Numri i personave të përfshirë në promovim	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut		
3.7.2	Edukim i personave të zgjedhur të pavarur në sektorin publik dhe privat si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhje të rasteve të identifikuara të mobingut.	1. Numri i punëtorive të zbatuara	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut	tetor 2021	shtator 2023
		2. Numri i pjesëmarrësve në punëtori	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut		
3.7.2	Edukim i personave të zgjedhur të pavarur në sektorin publik dhe privat si ndërmjetësues në procedurat për zgjidhje të rasteve të identifikuara të mobingut.	3. Përqindja e rritjes së numrit të paraqitjeve për shqetësim në vend të punës.	ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut	tetor 2021	shtator 2023
			ISHP dhe organizata sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut		

3.7.3

Zbatim i procesit konsultativ me të gjithë palët e interesuaraa për finalizim të propozim ligjit për mbrojtje nga shqetësimi në vend të punës

1. Numri i palëve të përfshira të interesuara
2. Përqindja e palëve të interesuara të dorëzojnë propozime të tyre dhe komente në lidhje me propozim ligjin (objektiv: 50%)
3. Përqindje nga propozimet e mara dhe komentet që janë të përfshira në mënyrë të duhur në zgjidhjen e propozim ligjit(objektiv: së paku 50% nga propozimet e mara)
4. Ratifikim i konventës 190 dhe rekomandimit 206 të Organizatës ndërkombëtare të punës (po/jo)

MPPS, MPJ dhe organizata sociale dhe sindikale e organizatave të grave pranë unionit të sindikateve të pavarura autonome të Maqedonisë së Veriut

tetor 2021

shtator 2023

Zotim i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

Inspektorati Shtetëror i Punës

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Lençe Kocevski

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

LKocevski@mtsp.gov.mk

Telefon

/


Ministri/
Agjencione

1. MPPS, Svetlana Cvetkovska,
scvetkovska@mtsp.gov.mk
2. MPJ, Amon Bajramovski, Amon.
Bajramovski@mfa.gov.mk

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

1. Organizata sindikale e
organizatave të grave pranë
unionit të sindikateve të
pavarura autonome të
Maqedonisë së Veriut ,
Divna Zmejkovska
divna.zmejkovska@yahoo.com





3. PËRMIRËSIM I DHËNIES SË SHËRBIMEVE PUBLIKE

3.8. Mundësim i qasjes në terapi dhe shërbime mjekësore për personat që konsumojnë droga pas vuajtjes së dënimit me burg

tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Qasje e vështirë drejt realizimit të të drejtës së shërimit të personave që konsumojnë droga, pas vuajtjes së dënimit me burg, sepse lëshohen pa dokumente për identifikim persona dhe sigurim shëndetësor, të cilat janë të nevojshme për të vazhduar mjekimin me trajtim zëvendësues me terapi metadoni. Në bazë të hulumtuimit të kryer nga ana e HOPS (POSHSH) për problemet juridike dhe nevojat me të cilat ballafaqohen njerëzit që konsumojnë droga në territorin Republikës së Maqedonisë së Veriut, 58% e personave që konsumojnë droga kanë qenë të liruar nga burgju pa dokumente valide personale. Që nga viti 2012 e deri më tani, HOPS ka regjistruar rreth 63 raste të personave që konsumojnë droga që kanë kryer dënimin me burg, e për arsye se nuk kanë dokument për identifikim personal dhe sigurim shëndetësor, nuk kanë qenë në mundësi menjëherë të vazhdojnë me mjekimin. Përshkak të faktit se këta persona menjëherë pas lirimit nga institucioni nuk mund të vazhdojnë me mjekimin, tek të njejtit përkeqësohet gjendja shëndetësore, sepse në atë periudhë mbeten pa terapi, bien në krizë apstenimi, duke patur parasysh se sëmundjet e varësisë janë gjendje komplekse dhe se stresi më i vogël mund ta përkeqësojë gjendjen, rritet rreziku nga përdorimi i sërishëm i drogave, që edhe më shumë mund të sjellë tek mbidozimi dhe përfundimi fatal. Ky problem në praktikë ekziston edhe pse Ligji për zbatim të sanksioneve qartë parasheh që të dënuarit për gjithë kohën e vuajtjes së dënimit me burg duhet të përgatiten për lirimin nga institucioni.

Qasja e pabarabartë dhe trajtimi deri tek shërbimet shëndetësore për personat që konsumojnë droga. Në bazë të hulumtimit të realizuar nga HOPS për problemet juridike dhe nevojat me të cilat ballafaqohen personat që injektojnë droga dhe punëtorët seksualë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 57% e personave që konsumojnë droga kanë paraqitur të paktën një problem lidhur me të drejtat e mbrojtjes shëndetësore. 38% i personave që konsumojnë droga janë ballafaquar me diskriminim nga ana e personelit mjekësor (përdorim i mbrojtjes shtesë, kontroll në hapësira të veçanta që nuk janë të rregulluara si ordinanca, pritja e marrjes së trajtimit të duhur mjekësor deri në fund të kohës së punës, ofendimi dhe të ngjashme.). 21% i personave që konsumojnë droga kanë paraqitur se kanë qenë të refuzuar për mjekim gjatë problemeve serioze shëndetësore (operacione, lidhje e plagëve, pranim në spital dhe të ngjashme.). 25% janë ballafaquar me vështirësi gjatë zgjedhjes së mjekut për mbrojtje primare shëndetësore përshkak të diskriminimit.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i zotimit është trajtim i njëjtë dhe qasje e lehtësuar në të drejtat nga mbrojtja shëndetësore për personat që konsumojnë droga, përmes përfshirjes së personave të pa siguruar që konsumojnë droga në programin për sigurim të personave të pasiguruar, rritje të bashkëpunimit ndërsektorial mes Qendrave Ditore për parandalim dhe trajtim të keqpërdorimit dhe varësisë nga drogat, Drejtoria për ekzekutim të sanksioneve, Fondi për sigurim shëndetësor dhe Ministria e punëve të brendshme, sensibilizim i personelit mjekësor gjatë ndërveprimit me persona që konsumojnë droga përmes trajnimeve, njohjes së organizatave joqeveritare si dhënës të shërbimeve me Ligjin për mbrojtje shëndetësore, nxjerrja dhe azhurimi në kohë të duhur i dokumenteve për identifikim personal dhe miratim i aktit për procedurë të lehtësuar për nxjerrje të letërnjoftimit për personat që nuk kanë nxjerrur fare letërnjoftim.

Rezultatet e pritura:

- Mundësimi dhe azhurimi në kohë të duhur i letërnjoftimeve për personat që konsumojnë droga gjatë kohës së vuajtjes së dënimit me burg dhe pas lëshimit nga institucioni.
- Trajtim i barabartë dhe mosdiskriminim nga ana e personelit mjekësor për personat që konsumojnë droga.
- Qasje e lehtësuar në të drejtat nga mbrojtja shëndetësore për personat që konsumojnë droga.
- Vendosje e bashkëpunimit ndërsektorial mes Qendrave Ditore për parandalim dhe trajtim të keqpërdorimit dhe varësisë nga drogat, Drejtoria për ekzekutim të sanksioneve, Fondi për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e punëve të brendshme.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Përmes bashkëpunimit të vendosur ndërsektorial mes Qendrave ditore për parandalim dhe trajtim të keqpërdorimit dhe varësisë nga drogat, Drejtorisë për ekzekutim të sanksioneve, Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së punëve të brendshme, personave që konsumojnë droga, me theks të veçantë personave të dënuar që konsumojnë droga do iu mundësohet nxjerrje dhe azhurim i njëkohësishëm i dokumenteve për identifikim personal dhe sigurim shëndetësor deri sa janë në vuajtje të dënimit me burg dhe pas daljes nga institucioni.

Mundësimi në kohë të duhur i dokumenteve për identifikim personal dhe sigurim shëndetësor për personat që konsumojnë droga do iu lehtësojë qasjen në realizimin e të drejtës për shërim nga varësia.

Përmes prezantimit të trajnimeve për personelin mjekësor për trajtim të personave që konsumojnë droga do të rritet sensibilizimi i personelit mjekësor kundrejt këtij komuniteti.

Përmes trajnimeve për sensibilizim të personelit mjekësor (mjekëve specialistë, motrave medicinale, laborantëve, mjekëve amë, mjekëve të mjekësisë dhe të tjerë) qëllimi është që pjesëmarrësve të iu ofrohet stigma, diskriminimi dhe problemet me të cilat ballafaqohen personat që konsumojnë droga gjatë shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore, me theks të veçantë gratë të cilat përveç diskriminimit nga shoqëria, ballafaqohen edhe me diskriminimin nga vetë komuniteti. Poashtu qëllimi i këtyre trajnimeve është të sensibilizohet personeli mjekësor në drejtim që mos iu rëndoje qasjen në shërbime mjekësore personave që konsumojnë droga, veçanërisht duke patur parasysh që këta persona kanë nevojë të madhe për ata. Përmbajtje e trajnimeve si shtesë do të përpilohet në bashkëpunim me Ministrinë e shëndetësisë, por në pajtim me eksperiencën e HOPS në zbatimin e këtij lloji të trajnimeve. Trajnimet do të përfshijnë tema për Zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave, Llojet e drogave, ndikimin dhe pasojat e tyre, Të drejtat e njeriut, stigmën, diskriminimin, temat tjera mund të caktohen në bazë të nevojave të personelit mjekësor. Trajnimet do të mund të mbahen nga persona të trajnuar të angazhuar nga HOPS. Roli i Ministrisë do të ishte, mbështetje dhe realizim i këtij lloji të trajnimeve. Personat që konsumojnë droga do të kenë trajtim dhe qasje të barabartë në të drejtat e mbrojtjes shëndetësore si të gjithë qytetarët.

**Pse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN dhe i njëjti mundëson qasje në informacione të shumt dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën mbi informacione, ashtu që do të ketë evidencë për trajnimet e realizuara për sensibilizim të personelit mjekësor për trajtim të personave që konsumojnë droga, si dhe evidencë për numrin e personave të trajnuar për punë me këto persona.

Miratimi i programit për procedurë të lehtësuar dhe të shkurtë për nxjerrje të dokumenteve për identifikim personal dhe implementimi i saj do të mundësojë evidentim të numrit të personave që konsumojnë droga që kanë siguruar dokumente për identifikim personal.

Me përfshirjen e personave që konsumojnë droga që nuk kanë sigurim shëndetësor në programin për sigurim të personave të pasiguruar, do të mundësohet kontroll në numrin e këtyre personave që janë përfshirë në programe dhe kanë siguruar shërbime shëndetësore.

Memorandumi i nënshkruar për bashkëpunim mes institucioneve relevante do të kontribuoj për rritje të numrit të personave të dënuar që konsumojnë droga, dhe njëkohësisht evidentim të numrit të personave që kanë vazhduar me mjekim me terapi zëvendësuese pas vuajtjes së dënimit me burg. Evidenca e tillë njëkohësisht do të tregojë edhe nëse ekziston bashkëpunim i vendosur ndërsektorial mes institucioneve kompetente në zgjidhjen e kësaj problematike.

Informacione shitesë

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE dhe i njeiti krijon mundësi dhe kushte për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve, dhe rrit mundësitë për përfshirje të shoqërisë civile. Personat që konsumojnë droga, përshkak të stigmës dhe diskriminimit me të cilën ballafaqohen vite të gjata, ka sjellur deri në mosbesim në sistem, e me atë edhe motivim të ulët për paraqitje dhe zgjidhje të problemeve me të cilat ballafaqohen që të përmirësojnë pozicionin e tyre në shoqëri. Pikërisht përshkak të këtyre arsyeve përfshirja e sektorit civil në këtë zotim është me rëndësi të madhe. Njëkohësisht, përfshirja e sektorit civil do të kontribuojë edhe në përfshirjen direkte të personave nga komuniteti të cilët direkt mund të marrin pjesë në krijimin e politikave dhe praktikave.


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE dhe i njeiti mundëson vendosje të mekanizmave që do të kontribuojnë për përparimin e përgjegjësisë së funksionerëve publik në punën e tyre. Trajnimet e realizuara dhe kuadrot medicinale të sensibilizuar do të kontribuojnë në qasjen e barabartë dhe trajtimin kundrejt të gjithë personave, duke përfshirë edhe personat që konsumojnë droga, si dhe mundësinë e rishikimit të parregullsive në punën e tyre.

Njëkohësisht, përmbushja/mospërmbushja e detyrimeve që do të dalin nga memorandumit i nënshkruar për bashkëpunim mes institucioneve relevante, si dhe numri i personave të dënuar që konsumojnë droga që kanë vazhduar me mjekim me terapi zëvendësuese pas daljes nga vuajtja e dënimit me burg, do të jap pamje të qartë se sa institucionet kompetente angazhohen për zgjidhje të këtij problemi i cili zgjatet shumë vite me rradhë, kontroll mbi parregullsitë në punën e tyre dhe mundësi të kërkohej largim i të njejtave.

- Program për mbrojtje të popullatës nga HIV – infeksioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021
- Programi për mbrojtje shëndetësore për personat me sëmundje të varësisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021
- Strategjia kombëtare për drogë për Republikën e Maqedonisë për vitin 2014 – 2020
- Strategjia lokale për droga e qytetit të Shkupit (parandalim, mjekim, rehabilitim, risocializim, zvogëlim i dëmeve dhe siguri e qytetit, viti 2015 – 2020 година)
- Strategji kombëtare për barabarësi dhe mosdiskriminim, viti 2016 – 2020
- Programi për personat e pasiguruar
- Strategjia kombëtare për zhvillim të sistemit penitenciar, viti 2015 – 2019

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim, Qëllimi 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“ Objektivi 16.6: Të zhvillohen institucione efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet, objektivi 16.3: Promovim i sundimit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mundësim i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë, Qëllimi 3 „Shëndet i mirë dhe mirëqenie“ Objektivi 3.8: Të arrihet mbrojtje univërzale shëndetësore duke përfshirë edhe mbrojtjen nga rreziku financiar, qasje në shërbime të nevojshme kualitative shëndetësore dhe qasje në barna elementare dhe vaksina të sigurta, efektive dhe kualitative si dhe të përballueshme për të gjithë.

Me masat e këtij zotimi do të përmirësohet trajtimi i barabartë dhe do të lehtësohet qasja në të drejtat e mbrojtjes shëndetësore për personat që konsumojnë droga dhe do të rritet bashkëpunimi ndërsektorial.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
3.8.1	Rritje e vëllimit të informacioneve mes personelit mjekësor në drejtim të mundësimit të trajtimit të duhur dhe shërbimit për personat që konsumojnë droga, përmes trajnimit.	1. Numri i personelit mjekësor të trajnuar për punë me persona që konsumojnë droga 2. Përqindje e personelit mjekësor i cili përmes trajnimeve ka zmadhuar njohuritë 3. Përqindje e personelit mjekësor që kanë njoftuar se e zbatojnë diturinë nga trajnimet në punën e përditshme 4. Numri i personelit mjekësor të sapo punësuar me shkollim të duhur	MSH dhe HOPS	tetor 2021	tetor 2023
3.8.2	Vendosje e procedurës dhe praktikës për bashkëpunim mes institucioneve të përfshira në këtë aktivitet dhe organizatave të shoqërisë civile në identifikimin e problemeve me të cilat ballafaqohen personat që konsumojnë droga dhe krijimi i zgjidhjeve të duhura për tejkallim të tyre (detyra e parë është vendosje	1. Është sjellur Program për procedurë të shkurtuar dhe të lehtësuar për nxjerrje të dokumentave për identifikim personal (po/jo) 2. Numri i personave që konsumojnë droga që kanë siguruar letërnjoftim valid deri sa kanë vuajtur dënimin me burg	MPB, MD (DES) dhe HOPS	tetor 2021	janar 2022

3.8.3

e Programit për procedurë të shkurtuar dhe të lehtësuar për nxjerrje të dokumentit për identifikim personal të personave që konsumojnë droga e që nuk posedojnë dokumenta valide ose nuk posedojnë asnjë dokument për identifikim deri sa janë në vuajtje të dënimit me burg)

3. Numri i personave që konsumojnë droga që kanë siguruar letërnjoftim të parë deri sa kanë vuajtur dënimin me burg

Vendosje e sistemit të hapur, transparent dhe publik të bashkëpunimit ndërsektorial mes Qendrave ditore për parandalim dhe trajtim të keqpërdorimit dhe varësisë nga drogat, Drejtorisë për ekzekutim të sanksioneve, Fondit për sigurim shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrisë së punëve të brendshme dhe organizatave të shoqërisë civile.

1. Numri i personave të dënuar që konsumojnë droga që në mënyrë të papenguar kanë vazhduar me mjekimin me terapi zëvendësuese lirimit nga vuajtja e dënimit me burg

MSH, MD (DES),
FSSHRMV,MPB
dhe HOPS

tetor 2021

shtator 2023

Zotim i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

Ministria e shëndetësisë

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

m-r Biljana Babushkovska

Funksioni,
Departamenti

Udhëheqës i Departamentit për auditim të brendshëm

Email

biljana.babushkovska@zdravstvo.gov.mk

Telefon

/


Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

1. MD (DES),
BiljanaZefik@mjustice.gov.mk
2. FSSHRMV
3. MPB, Susana_Novakoska@moi.gov.mk
4. MSH,
biljana.babushkovska@zdravstvo.gov.mk

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

1. Shoqata HOPS- Opsione për jetë të
shëndetshme, Shkup
hajdis@hops.org.mk
mgligoroska@yahoo.com
advokat.spirovska@gmail.com





4. QASJE NË DREJTËSI

4.1. Përmirësim i mbrojtjes së punëtorëve seksualë dhe personave që konsumojnë droga

tetor 2021 – gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Qëllimi kryesor i policisë në një shoqëri demokratike është respektimi dhe mbrojtja e lirive dhe të drejtave elementare njerëzore të të gjithë qytetarëve, mosdiskriminimi dhe respektimi dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor. Mirëpo, në shumë raste policia në veprimtarinë e vete i thyen të drejtat e personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë. Personat që konsumojnë droga shpesh paraqesin raste se mbi të njëjtët është kryer kontroll joligjor nga ana e nëpunësve policorë, se janë keqtrajtuar në stacione policore, kanë qenë pre e torturës (të detyruar të pranojnë se kanë kryer ndonjë vepër, që të munden nëpunësit policorë të ngrisin procedura kundër atyre personave), trajtim jonjerëzor dhe/ose degradues, nuk u janë cituar të drejtat e tyre në stacionin policor, mbi të njëjtët është përdorur forcë e tepruar nga ana e policisë në veprimtarinë policore, dhe si pasojë e asaj, personat që konsumojnë droga kanë marrë lëndime trupore. Përveç asaj që personat që konsumojnë droga janë pre e torturës nga ana e policisë, të njëjtët janë pre e torturës edhe nëpër burgje. Punëtorët seksualë nga ana tjetër, shpesh paraqesin se policia nuk vepron pas paraqitjeve nga ana e tyre për rastet e dhunës dhe se përfetojnë forma të ndryshme të dhunës nga ana e policisë. Ajo që poashtu paraqitet si problem serioz është fakti që as policia, as prokuroria publike nuk veprojnë drejt hetimit të detajuar në raste kur bisedohet për punëtorë seksualë, e veçanërisht jomjaftueshëm i hetojnë rastet e femicidit të punëtoreve seksuale.

- ➔ Diskriminimi, trajtimi i pabarabartë dhe shkelja e të drejtave të njeriut të personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë nga ana e policisë.

Në bazë të hulumtimit të realizuar nga ana e HOPS për problemet juridike dhe nevojat me të cilat ballafaqohen personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksualë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 85% nga personat që konsumojnë droga dhe 62% nga punëtorët seksualë ka paraqitur së paku një problem me policinë:

- ▶ 69% nga personat që konsumojnë droga dhe 49% nga punëtorët seksualë janë ballafaquar me kontroll antiligjor, profilim dhe të ngjashme, nga ana e policisë,
- ▶ 65% nga personat që konsumojnë droga dhe 41% nga punëtorët seksualë janë ballafaquar me keqtrajtim fizik dhe psikik nga ana e nëpunësve policorë (ofendim, nënvlerësim, rrahje dhe të ngjashme.),
- ▶ 37% nga personat që konsumojnë droga dhe 20% nga punëtorët seksualë janë viktimë e keqpërdorimit të detyrës zyrtare nga ana e policisë(keqpërdorim i të dhënave personale, shantazhe dhe të ngjashme.),
- ▶ 47% nga personat që konsumojnë droga dhe 27% nga punëtorët seksualë janë ballafaquar me arrestim të pabazë, mbajtje ose heqje nga liria,
- ▶ 33% nga personat që konsumojnë droga dhe 28% nga punëtorët seksualë janë ballafaquar me refuzim nga ana e policisë të evidentohen ose të ndërmerret hetim për vepër/problem të paraqitur,

→ Policia nuk vepron pas paraqitjeve të personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë,

Në bazë të hulumtimit për analizën e qëndrimeve të punëtorëve seksualë për nevojat e ndryshimit të rregullores ligjore për punë seksuale në Maqedoni, vetëm 1,3% e punëtorëve seksualë janë përgjigjur se presin ose kanë marrë ndihmë nga policia, që vjen si pasojë e mosreagimit nga ana e policisë, trajtimit diskriminues dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.

→ Tortura dhe veprime degraduese ndaj personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë nëpër burgje

Në bazë të hulumtimit të realizuar nga ana e HOPS për problemet juridike dhe nevojat me të cilat ballafaqohen personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksualë në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 92% e personave që konsumojnë droga dhe 60% e punëtorëve seksualë janë ballafaquar së paku me një problem gjatë vuajtjes së dënimit me burg.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i zotimit është sensibilizimi i nëpunësve policorë dhe personave të punësuar nëpër burgje në sjelljen me personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksualë përmes trajnimeve.

Rezultatet e pritura:

- Veprim nga ana e policisë pas rasteve të paraqitura nga persona që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë.
- Trajtim i barabartë nga ana e policisë dhe personave të punësuar nëpër burgje kundrejt personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksualë.
- Besim i rritur në polici tek personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Përmes kycjes së trajnimeve për nëpunësit policorë dhe personat e punësuar nëpër burgje për punën me persona që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual do të rritet sensibilizimi i policisë dhe personave të punësuar në burgjet gjatë sjelljes me këta dy komunitete. Personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual do të kenë trajtim të njejtë si të gjithë qytetarët, me atë që tek ata do të rritet besimi në polici, që do rezultojë me numër më të madh të rasteve të paraqitura.

Vendosja e regjistrimeve audio dhe video në hapësirat e policisë gjatë kohës së marrjes në pyetje do të kontribuojë në zgjidhjen e rasteve dhe eliminimin e torturave, sjelljes johumane dhe degraduese kundrejt personave që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksual.

Përdorimi i mjeteve teknike për inçizim audio dhe video është e rregulluar me nenin 93-a të Ligjit mbi policinë ku është paraparë se policia, gjatë ndërmarrjes së veprimeve në kuadër të kompetencave policore, të përdorë mjete teknike për audio dhe video inçizim, me qëllim mundësimin e materialit të inçizuar për mënyrën se si ndërmerret veprimi nga ana e nëpunësve policorë.

Përdorimi i mjeteve teknike për audio dhe video inçizim është i rregulluar edhe me ligje tjera dhe këta mjete teknike tashmë përdoren në gjykata dhe prokurori publike.

Përveç ligjeve ekzistuese, nga maji i vitit 2021 do të aplikohet Ligji për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë dhe dhuna familjare i cili poashtu me masat për mbështetje të viktimave nga riviktimizimi i detyron institucionet kompetente, që deklarata e viktimës në stacion policor dhe prokurori publike të merret me përdorimin e inçizimit video dhe zanor.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të shumta dhe të reja, ashtu që do të kishim evidencë për trajnimet e realizuara për sensibilizim të personave të punësuar në polici dhe burgje, si dhe evidencë për numrin e personave të trajnauar për punë me persona që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual. Regjistrimi i detyrueshëm audio dhe video në hapësirat e policisë gjatë kohës së marrjes në pyetje përmirëson kualitetin e informacioneve, në mënyrë që pëersonat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual të cilëve u janë shkelur të drejtat (diskriminimi, shkelja e të drejtave dhe tortura, sjellja johumane dhe degraduese) nga ana e nëpunësve policorë do mund që regjistrimet e tilla të iu shërbejnë si dëshmi në procedurën për vërtetim të rasteve të shkeljes së të drejtave të tilla. Regjistrimet audio dhe video nuk do të jenë të disponueshme për publikun, por të njejtat do të shërbejnë për mbrojtje nga viktimizimi ose riviktimizimi shtesë. Përmes të njejtave do të mundësohet ndjekje më e lehtë dhe kontroll në atë nëse dhe sa institucionet kompetente e zbatojnë këtë zotim. Me evidencën e trajnimeve të zbatuara dhe kuadrove të trajnuara do të mundësohet ndjekje më e lehtë e punës së institucioneve dhe ministrive kompetente. Si shtesë, përmes qasjes së informacioneve nga publiku do të kihet kontroll në atë nëse dhe sa institucionet kompetente e zbatojnë këtë zotim.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual, përshkak të stigmës dhe diskriminimit me të cilin ballafaqohen për shumë vite, ka sjellur deri në mosbesim në sistem, e me atë edhe motivim të zvogëluar që ata vetë të paraqesin dhe të zgjidhin problemet me të cilat ballafaqohen dhe ta përmirësojnë pozicionin e tyre në shoqëri. Pikërisht për këta arsye përfshirja në sektorin civil në këtë zotim është e rëndësishë së veçantë, në drejtim të motivimit nga paraqitja dhe mbështetjes së plotë në drejtim të këshillimit në procedura.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse vendosja e regjistrimit të detyrueshëm audio dhe video në stacionet policore gjatë kohës së marrjes në pyetje, do të kontriboj në zgjidhje më efikase të rasteve të shkeljes së të drejtave nga ana e nëpunësve policorë dhe njëkohësisht do të jap pamje më të qartë për atë sa dhe nëse personat që konsumojnë droga janë të njohur me të drejtat e tyre gjatë kohës së marrjes në pyetje, për të cilat nëpunësit policor janë të detyruar ti informojnë. Regjistrimet audio dhe video nuk do të jenë të disponueshme për publikun por të njejtat do të shërbejnë për mbrojtje nga viktimizimi ose riviktimizimi shtesë, si dhe si provë në proceset për vërtetim të rasteve të shkeljes së të drejtave (diskriminim, torturë, sjellje johumane, degraduese) nga ana e nëpunësve policor.

Informacione shitesë

Trajnimet e realizuara dhe kuadrot e sensibilizuara do të kontribuojnë në qasjen e barabartë dhe trajtimin e njëjtë kundrejt të gjithë personave, duke përfshirë edhe personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual, si dhe mundësinë për rishikim të parregullësive në punën e tyre.

E gjitha kjo do të kontribuoj drejt krijimit dhe përmirësimit të rregullave, rregulloreve dhe mekanizmave për përgjegjësi publike të funksionerëve.

Lidhje me Rregulloren oër trajnim në Ministrinë e punëve të brendshme; Strategjia kombëtare për barabarësi dhe mosdiskriminim, viti 2016 – 2020; Strategjia kombëtare për zhvillim të sistemit penitenciar, viti 2015 – 2019.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.3 Promovim i sundimit të së drejtës në nivel ombëtar dhe ndërkombëtar dhe mundësim i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë. Me masat nga ky zotim do të kontribuohet në ndalimin e diskriminimit, trajtimin të pabarabartë dhe shkeljen e të drejtave njerëzore të njerëzve që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksual nga ana e policisë.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
4.1.1	Rritje e vëllimit të informacioneve mes nëpunësve policorë në drejtim të veprimit me personat që konsumojnë droga dhe punëtorëve seksual përmes organizimit të trajnimeve për sensibilizim të nëpunësve policor	1. Numri i nëpunësve policor të trajnuar 2. Përqindje e nëpunësve policor të cilët përmes trajnimeve kanë zmadhuar njohuritë e tyre 3. Përqindje e nëpunësve policor që kanë njoftuar se po përdorin njohurinë nga trajnimet në punën e përditshme	MPB	tetor 2021	gusht 2023
4.1.2	Rritje e vëllimit të informacioneve mes personave të punësuar në burgje në drejtim të veprimit me personat që konsumojnë droga dhe punëtorët seksual përmes organizimit të trajnimeve për sensibilizim të personave të punësuar në burgje	1. Numri i personave të trajnuar të punësuar në burgje 2. Përqindje e pjesëmarrësve që përmes trajnimeve kanë rritur njohuritë e veta 3. Përqindje e pjesëmarrësve që kanë njoftuar se përdorin njohuritë nga trajnimi në punën e përditshme 4. Numri i personave të sapo punësuar me shkollim adekuat	MD (DES)	tetor 2021	gusht 2023

4.1.3

Qasje në informacione nga advokatët dhe të dënuarit përmes të cilave më lehtë do të vërtetohet shkelje e të drejtave njerëzore përmes vendosjes së regjistrimit të detyrueshëm audio dhe video në nga një stacion policor në çdo qytet në territorin e RMV gjatë kohës së marrjes në pyetje, fillimisht në Shkup, Gostivar, Strumic, Ohër dhe Gjevgjeli.

1. Numri i hapësirave policore të pajisura me pajisje audio dhe video (objektiv: minimum 5)

MPB

tetor 2021

gusht 2023

Zotim i ri



Institucion udhëheqës për zbatim	MPB	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Susana Novakoska	
Funksioni, Departamenti	Këshilltar policor në OOJSP pranë MPB	
Email	susana_novakoska@moi.gov.mk	
Telefon	/	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri/ Agjencione	MPB
	Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	HOPS-Opsione për jetë të shëndoshë Shkup Hajdi Shterjova Simonoviq hajdis@hops.org.mk Margarita Gliguroska mgligoroska@yahoo.com Milka Spirovaska advokat. spirovska@gmail.com





4. QASJE NË DREJTËSI

4.2. Përmirësim i qasjes në drejtësi për personat e rrezikuar social dhe personat në rrezik social

tetor 2021 – gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Për shfrytëzim të të drejtës së ndihmës së garantuar minimale (NGM) si e drejtë financiare nga mbrojtja sociale, ose për transformim të të drejtës për ndihmë të përhershme financiare në NGM, ekziston nevoja e vërtetimit se kërkuesi (ose shfrytëzuesi) nuk mund të siguroj kujdes për veten në asnjë bazë. Kjo praktikisht do të thotë se nevojitet që kërkuesi/shfrytëzuesi të dorëzoj padi kundër anëtarit të familjes ose ekonomisë familjare për kujdes (përkujdesje). Në praktikë, paraqitja e padisë do të thotë inicim i procedurës gjyqësore, e cila : është proces i panjohur për këto kategori qytetarësh; është procedurë e shtrenjtë për personat me pak pasuri dhe kategoritë sociale të qytetarëve (e gjithë procedura do të kushtonte rreth 2000,00 denarë që është çmim i lartë për individ ose familje pa të hyra, për çka do që të kërkojë KNJ nëse e humb kontestin do duhet ti kthejë mjetet e fituara në këtë bazë); ndikon në prishjen e marrëdhënieve tashmë të dobësuar mes kërkuesit dhe familjarëve të tjerë me detyrë për përkujdesje reciproke. Aq më shumë, ekziston mundësi për ngritjen e procedurës së tillë në emër dhe për llogari të kërkuesit nga ana e qendrës kompetente për punë sociale (QPS) nëse është person i vjetër, i pafuqishëm, i paaftë, invalid dhe fëmij por në praktikë kjo thuhet nuk shfrytëzohet.

Nga ana tjetër, ekzistojnë numër i madh i personave që janë shfrytëzues të NGM, ndërsa mjetet që i marrin në këtë bazë iu bllokohen nga ana e Përmbaruesve përshkak borxheve të pa paguara. Ligji për ekzekutim i përjashton nga bllokimi shfrytëzuesit e NGM, të ndihmave humanitare, kompenzimeve sociale dhe të tjera, me qëllim që të mundësojë të hyra minimale që familja të ekzistojë. Por në fakt, një numër i madh i shfrytëzuesve të NGM nuk e dijnë se janë të përjashtuar nga përmbarimi. Në çdo rast edhe nëse përjashtohen nga përmbaruesi me dorëzim të vërtetimit nga Qendra për punë sociale, përsëri që të çbllokohet llogaria e bllokuar nga banka duhet që shfrytëzuesi të paguaj provizion bankar prej rreth 1400 denarë.

Qëllimi kryesor i zotimit

Në çdo rast shfrytëzuesit e NGM janë me arsim më të ulët, më së shpeshti palë të pa arsimuara dhe e pranojnë bllokimin e llogaris, por edhe tërheqjen e parave pa ankesë. Nga kjo kanë dëm ata vetë dhe familjet e tyre, me çka kthehen në lypje, grumbullim nëpër shporta dhe janë të mundshme aktivitete kriminale siç janë vjedhja e drunjve, vjedhje dhe të ngjashme. Në vitin 2018 u nënshkrua Memorandum mes MPPS dhe Dhomës së Përmbauesve që të mos bllokohet numri social. Por ajo në mënyrë të dukshme ndryshoi gjendjen dhe ende ekzistojnë disa lëshime. Numri social nuk është i dukshëm për përmbauesit, vetëqeverisjet lokale dhe bankat. Nëse "vërtetohet" se bëhet fjalë për mjete të fituara nga sfera e mbrojtjes sociale, shfrytëzuesit e NGM mbeten pa mjete edhe nga 6 muaj. Gjendja e tillë i dekurajon një numër të madh të shfrytëzuesve të NGM që të aplikojnë për masa nga APRMV përshkak të frikës se përmbauesit do ua marrin mjetet financiare.

Qëllimi kryesor i këtij zotimi është të mundësoj qasje në procedurën për realizim të të drejtave nga mbrojtja sociale për kategoritë e rrezikuara sociale pa udhëheqje të procedurave të shtrenjta gjë e cila në afat të gjatë do të ndikoj në kthimin e besimit në sistemin për mbrojtje sociale.

Sipas shembullit të marrjes së të dhënave nga QPS për gjendjen pasurore të anëtarëve të familjes mund të krijohet praktikë e marrjes së të dhënave për vërtetim të gjendjes materiale dhe financiare të anëtarëve të familjes me të cilat kërkuesi nuk jeton në shtëpi të përbashkët e të cilët kanë detyrim ligjor për përkujdesje ndaj tij/saj. Në mënyrë më të lehtë do të mund të vërtetohet dhe vlerësohet nëse kushëri ka pasur të hyra të mjaftueshme gjatë vitit që të ndaj për përkujdesje të kërkuesit. Me atë, do të përforcohet funksioni i marrjes së të dhënave në rrugë zyrtare në bazë të të cilave QPS do mund të vlerësojë nëse shfrytëzuesit/shfrytëzuesit potencial mund të sigurojnë përkujdesje e pastaj të drejtohen në kontest gjyqësor; ose të mbrohen nga fillimi i procedurave të shtrenjta dhe afatgjata për ata.

Rezultate të pritshme janë: kapacitete të përforcuara të QPS gjatë vlerësimit të gjendjes materiale, financiare dhe pasurore të kërkuesve/shfrytëzuesve përmes përdorimit të mekanizmit të mbledhjes së të dhënave në rrugë zyrtare; përpilim i udhëzuesit të brendshëm cirkular me udhëzime të përfshira për mbedhje dhe vlerësim të të dhënave; përpilim i doracakut për inicim të procedurave në interes të popullatës së pambrojtur nga e cila varen përdorimi i të drejtave nga mbrojtja sociale.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Njëkohësisht, zotimi do të kryej parandalim nga bllokimi i numrit social të shfrytëzuesve të NGM. Rezultat do të jetë që përfundimisht numri social të jetë i mbrojtur nga përmbarimi. Me mbrojtjen e tij do të mundësohet ndarje përfundimtare e llogarive që munden dhe që nuk munden të bllokohen.

Zotimi i ka parasysh parimet e procedurës së përgjithshme administrative edhe atë: parimi i proporcionalitetit, parimi i ekonomisë dhe efikasitetit të procedurës; parimi i orientimit të shërbimit kundrejt realizimit të të drejtave dhe interesave të palëve; parimi i vërtetimit të të drejts materiale të të gjitha fakteve me rëndësi të veçantë për vërtetim të duhur të gjendjes faktike përmes grumbullimit, rishikimit dhe përpunimit të informacioneve dhe të dhënave në rrugë zyrtare; parimi i ndihmës aktive të palës për realizim dhe mbrojtje të të drejtave të saj në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë, derisa mosdija dhe paaftësia e palës nuk duhet të jenë në dëm të të drejtave dhe interesave të saj ligjore.

Në këtë mënyrë, përmes vlerësimit të duhur dhe të plotë të gjendjeve të palëve, do të veprohet drejt parandalimit të shtyrjes së proceseve dhe shtyrje e saj e qëllimshme në procedura të gjata gjyqësore. Që të arrihet deri aty, nevojitet të ndërmerren disa aktivitete:

1. Përpilim i udhëzimit të brendshëm cirkular për shfrytëzim të mundësisë ligjore nga neni 269 paragrafi 1 i Ligjit mbi mbrojtjen sociale për mbledhje të të dhënave për gjendjen materiale financiare dhe pasurore të anëtarëve të familjes- ky udhëzim do të përmbaj udhëzime faktike se cilat fakte duhet të vërtetohen, si të vërtetohen dhe si të përdoren në mënyrë të duhur gjatë vendimmarrjes pas kërkesës së deponuar. Për zbatim të këtij aktiviteti, nevojitet takim paraprak për përcaktim të strukturës, kornizës dhe përmbajtjes së udhëzimit që është e rëndësishme në aspekt praktik. Me rëndësi të veçantë është udhëzimi të jetë diskutuar edhe brenda në QPS sepse do të duhet të dalë në ndihmë për nevojat e tyre. Udhëzimi është i nevojshëm të jetë përgatitur nga MPPS, Entit për veprimtari sociale, e sipas nevojës në konsultim me njohës të jashtëm të temës (OJQ, profesorë dhe të ngjashme).

2. Kapacitete të përforcuara të QPS për shfrytëzim të mundësisë ligjore nga neni 298 i Ligjit për mbrojtje sociale – me rëndësi të veçantë është të bëhet vlerësim i nevojave të QPS kur bëhet fjalë për mundësi ligjore për ngritje të procedurës gjyqësore në emër dhe në llogari të kërkuarit edhe kur bëhet fjalë për person të vjetër, të pafuqishëm, të paaftë, invalid dhe fëmi. Mënyrë më e mirë dhe më e përshtatshme

është përmes organizimit të 3 deri në 5 punëtorive/konsultimeve njëditore me juristët e qendrave për punë sociale në gjithë vendin. Fokusi i këtyre punëtorive do të ishte përcaktimi i problemeve praktike dhe nevojave të QPS për shfrytëzim të kësaj mundësie ligjore në praktik, si dhe tejkalim i pengesave që ekzistojnë dhe për shkak të të cilave nuk përmbushet mbrojtja e plotë e palës. Punëtoritë/këshillimet nevojitet të jenë të organizuara dhe të zbatuara nga MPPS, në konsultim me Entin për veprimtari sociale, e sipas nevojës edhe nga njohës të jashtëm të kësaj teme (OJQ e të ngjashme).

3. Përpilim i doracakut në bazë të aktivitetit Nr. 2 me formularë për kërkesat fillestare dhe udhëzime tjera për vijimin e procedurës gjyqësore me interes nga ana e QPS-ky aktivitet, përveç se do zbatohet në bazë të aktivitetit Nr. 2, duhet të zbatohet nga MPPS, e komunikuar në mënyrë të duhur nga praktikues të përfaqësimit juridik dhe OJQ-të.

Siç është sqaruar tashmë, për momentin shfrytëzuesit e NGM ballafaqohen me sfida serioze gjatë realizimit të kësaj të drejte të garantuar me kushtetutë.

Me realizimin e këtij zotimi do të rikthehet para së gjithash sundimi i ligjeve dhe pikërisht kategoria më e pambrojtur e qytetarëve do ta rikthejnë besimin në institucione. Që e njejta të realizohet nevojitet të ndërmerren aktivitetet si në vijim::

- Ndryshime ligjore të Ligjit për ekzekutim.
Memorandumi për bashkëpunim mes MPPS dhe Dhomës së Përmbartuesve të ndërrohet me akt më të lartë juridik me të cilin do të përjashtohet mundësia e bllokimit të numrit social.
- Krijimi i zgjidhje s softuerike për llogaritë e pranuesve të NGM dhe të hyra tjera, që janë të ndërlydhura me numrin social që të pamundësohet bllokimi i mjeteve nga ana e institucioneve. MPPS të përpiloj softuer i cili realisht do të mbrojë numrin social përmes të dhënave për shfrytëzuesit me të cilat disponon MPPS, ndërsa Ministria e Financave dhe Ministria e shoqërisë informatike dhe Administratës të konsultohen gjatë procesit. Për ndihmë humanitare nevojitet të regjistrohet ndihma dhe e njejta të fitojë numër social. Numri social definitivisht duhet të jetë i ndryshëm nga llogaria transaksionale e shfrytëzuesit dhe i njejti duhet të jetë numër qëllimor social. Kështu eksperiencë tashmë kemi pasur me paketën e dytë dhe të tretë të masave të Qeverisë për luftë kundër KOVID-19 dhe Ministrinë e lartëpërmendura mund ta shfrytëzojnë eksperiencën.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve përmes zgjidhje të problemit me bllokim të llogarive, sepse në kohë të duhur përmbaruesit, bankat, vetëqeverisjet lokale do të kenë informacione të duhura për statusin e transaksionit dhe me atë do të shmangen problemet e panevojshme të të gjitha palëve të përfshira. Përmirëson qasjen në informacione nga publiku dhe mundëson të drejtën mbi informacione sepse QPS do të ishin më transparente, më të hapura dhe më të përshtatshme për bashkëpunim përmes vetë faktit që do duhet edhe më shumë të angazhohen për informim të duhur të këtyre kategorive dhe mbështetje të plotë dhe realizim të të drejtave të tyre. Të gjithë palët e prekura realizojnë të drejtën e informimit, qasja në informacione rritet dhe ligjet falë asaj janë më efikase dhe më efektive. Mundëson rregulla precize të veprimit të institucioneve në pajtim me një ligj të vetëm, i cili siguron siguri si të institucioneve përgjegjëse, ashtu edhe të personave shfrytëzues të të drejtave nga mbrojtja sociale. Më saktë, largohet paqartësia e interpretimit të ligjeve që mundëson veprim pas interpretimit.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon ose i përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve, dhe rekomandohet konsultim me sektorin joqeveritar për zbatim të aktiviteteve. Krijon ose e përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile përmes aktiviteteve të tilla, përveç atë që do punohet në tejkalimin e një problemi tejet të madh të pranishëm i cili i prek personat më pak të pasur dhe të pambrojtur, me çka do të përmirësohet edhe komunikimi mes përfaqësuesve të shoqërisë civile të cilët punojnë pikërisht me këtë kategori dhe MPPS si institucion i rëndësishëm së veçantë për këtë popull. Nëse realizohet zotimi, arrihet në rezultatin se qeveria ka ndëgjuar zërin e qytetarëve dhe qytetarët në mënyrë aktive ndikojnë për ligje më të mira që janë në shërbim të qytetarëve. Zotimi do të jetë i mbështetur edhe me databazë të personave që kanë dëshmuar për të drejta të shkelura dhe do të përgatiten video me dëshmi në të cilat propozohen zgjidhje.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon dhe përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve.

Informacione shitesë

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.3 Promovim i sundimit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mundësim i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë. Me masat e këtij zotimi do të përparohet dhe thjeshtësohet procedura e realizimit të tëdrejtave nga mbrojtja sociale për kategoritë e rrezikuara sociale të qytetarëve pa ndërmarrë procedura gjyqësore të shtrenjta dhe kthim të besimit në sistemin për mbrojtje sociale.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
4.2.1	Përpilim i udhëzimit cirkular të brendshëm për shfrytëzim të mundësisë ligjore nga neni 269 paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtje sociale për marrjen e të dhënave për gjendjen materiale dhe financiare të anëtarëve të familjes	- Numri i takimeve të mbajtura për përcaktim të strukturës, kornizës dhe përmbajtjes së udhëzimit cirkular (objektiv 3-5 takime) - Udhëzimi cirkular është ndarë me QPS (po/jo)	MPPS, Organizatat e shoqërisë civile	janar 2022	qershor 2022
4.2.2	Kapacitete të përforcuara të QPS për shfrytëzim të mundësisë ligjore nga neni 298 nga Ligji për mbrojtje sociale	- Numri i të punësuarve në QPS pjesëmarrës në punëtori/këshillime për përcaktim të problemeve praktike të këtij lloji - Numri i problemeve të vërtetuara Numri i zgjidhjeve të mundshme të problemeve	MPPS, Organizatat e shoqërisë civile	janar 2022	prill 2022
4.2.3	Përpilim i doracakut në bazë të aktivitetit Nr. 2 me formularë për paraqitje fillestare dhe udhëzime tjera për vijimin e procedurës gjyqësore me interes për QPS dhe e ndarë me QPS	Numri i pjesëmarrësve në procesin e vërtetimit të strukturës dhe përmbajtjes së doracakut	MPPS, Organizatat e shoqërisë civile	mars/prill 2022	dhjetor 2022

4.2.4	Krijim i databazës nga ana e organizatave të shoqërisë civile për të drejtat e shkelura me bllokim të numrit social	1. Numri i rasteve të përfshira në databazë të cilave u janë shkelur të drejtat me bllokimin e numrit social	Organizatave të shoqërisë civile dhe përdoruesit e NGM	tetor 2021	dhjetor 2021
4.2.5	Inçizimi i videove me persona të cilëve u janë bllokuar llogaritë dhe do flasin për të drejtën e shkelur e do kërkojnë përgjegjësi e do ofrojnë zgjidhje	1. Numri i videove të inçizuara	Organizatave të shoqërisë civile	tetor 2021	dhjetor 2021
4.2.6	Krijim i zgjidhjes softuerike për llogaritë e pranuesve të NGM dhe të hyra tjera, të cilat janë të lidhura me numrin social që të mund të pamundësohet bllokimi i mjeteve nga ana e institucioneve	1. Zgjidhje softuerike e korigjuar (po/jo)	MF, MPPS, DHP, SB	janar 2022	Në vazhdimësi

Zotim i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

MPPS

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Mabera Kamberi
Sofija Spasovska
Aleksandra Nedeva
Elka Todorova
Tatjana Popovska
Zira Memeti
Svetlana Cvetkovska
Elena Grozdanova
Kadrije Mustafa
Ljubica Panova

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

MKamberi@mtsp.gov.mk
sspasovska@mtsp.gov.mk
aleksandra.nedeva@mtsp.gov.mk
etodorova@mtsp.gov.mk
tatjana.popovska@mtsp.gov.mk
zmemeti@mtsp.gov.mk
SCvetkovska@mtsp.gov.mk
EGrozdanova@mtsp.gov.mk
kadrije.mustafa@mtsp.gov.mk
ljubica.panova@mtsp.gov.mk

Telefon

/

Ministri/
Agjencione

MF

Goran Mojanoski

goran.mojanoski@finance.gov.mk

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Shoqata maqedonase e juristëve
të rinj

Elena Georgievska

egeorgievska@myla.org.mk

KHAM Dellçevë

Zoran Bikovski

z_bikovski@yahoo.com

DHP

SB



4. QASJE NË DREJTËSI

4.3. QASJE NË DREJTËSI PËR GRA QË KANË PËRJETUAR DHUNË FAMILJARE

tetor 2021 – gusht 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Mungesë e transparencës dhe llogaridhënies tek institucionet kompetente që janë të përfshira në sistemin e mbrojtjes nga dhuna e bazuar në gjini, mbi gratë dhe dhuna familjare, që kontribon për mbrojtje joefektive të grave që kanë përjetuar dhunë familjare në periudhë më të gjatë kohore.

Mospasja e evidencës së veçantë dhe përkatëse për rastet e dhunës së bazuar në gjini, mbi gratë, është problem sistematik që pamundëson ndjekje të rregullt të gjendjes, vërtetim të trendeve dhe planifikim përkatës të politikave dhe ligjeve për parandalim dhe mbrojtje të grave që kanë përjetuar dhunë familjare. Mungesa e sistemit të tillë pamundëson identifikimin e problemeve specifike me të cilat ballafaqohen gratë që kanë përjetuar dhunë familjare, në qasjen e tyre në drejtësi, që rezultojnë me miratim dhe zbatim të ligjeve dhe politikave që nuk mundësojnë mbrojtje efektive nga dhuna familjare.

Edhe pse dhuna familjare është e rregulluar me ligj në shtet nga viti 2004 dhe institucionet kompetente kanë detyrim për mbajtje të evidencës së veçantë për rastet e dhunës familjare, në praktikë mungon mbajtja e rregullt e evidencës së veçantë dhe informimi i publikut për gjendjet me dhunën familjare.

Në kapitullin 4, neni 28 i Ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë dhe dhuna familjare është theksuar detyrimi për vendosje të evidencës së veçantë për lëndët e dhunës së bazuar në gjini mbi gratë dhe dhunës familjare nga ana e ministrive kompetente, institucioneve dhe NJVL. Ligji parasheh detyrim për MPPS për përpilim të formës dhe përmbajtjes së formularit për mbledhje të informacioneve mes institucioneve kompetente në pajtim me Ministrin e punëve të brendshme, Ministrin e drejtësisë dhe Ministrin e shëndetësisë. Përkundër detyrimeve të tilla ligjore, në praktikë mungon sistem i mirëfilltë për mbledhje të të dhënave dhe publikim i rregullt i tyre nga ana e institucioneve të lartpërmendura.

Gjykatat dhe PP nuk kanë evidencë të veçantë për lëndën civile dhe penale për dhunë të bazuar në gjini mbi gratë dhe dhunë familjare në sistemin ekzistues AKMIS, aq më pak nuk publikojnë rregullisht të dhëna për lëndët e këtij lloji dhe veprimi nga ana e gjykatësve.

Ekziston edhe praktikë e ndryshme e evidentimit të procedurave civile për masa të përkohshme në bazë të ndryshme nga ana e gjykatësve. Gjatë ndarjes së lëndëve për dhunë familjare tek gjykatës i caktuar, sistemi ekzistues AKMIS, nuk lejon që gjykatësi të jetë i informuar për procedurat tjera gjyqësore që udhëhiqen për të njejtin rast (që është e nevojshme për marrjen e vendimit të duhur). Njëkohësisht, nuk ekziston mundësi për kërkim të aktvendimeve gjyqësore në bazë të dhunës familjare, në web faqen sud.mk. Në ligjin e ri⁵ është paraparë detyrimi për gjykatat dhe PP të mbajnë evidencë të veçantë për dhunën e bazuar në gjini mbi gratë dhe dhunën familjare në bazë të formularit të përgatitur paraprakisht nga ana e Ministrit të drejtësisë.

MPB nuk publikon të dhëna për lëndët e dhunës familjare të regjistruara si vepra penale, ankesa dhe kundërvajtje. Vlen të përmendet se para 10ra viteve MPB kishte praktikë pozitive të publikimit kuartal të të dhënave për lëndët e dhunës familjare (për periudhë prej tre muajsh) në nivel të sektoreve për punë të brendshme. Paralelisht, nuk ekziston regjistër për kryerës të dhunës familjare i cili do ti informonte personat profesional nga institucionet që janë të përfshirë në veprimin në lëndët e dhunës së bazuar në gjini mbi gratë dhe dhunën familjare.

QPS nuk ka sistem të mirëfilltë për mbledhje të të dhënave dhe publikim të tyre në publik. Në web faqen e MPPS mund të gjinden të dhëna vetëm për rastet e paraqitura në muajin maj dhe qershor të vitit 2020, mirëpo të dhënat janë shumë të përgjithshme dhe nuk mundësojnë paraqitje më të detajuar të gjendjeve me dhunën familjare në shtet dhe veprimet e ndërmarra për mbrojtje të grave që kanë përjetuar dhunë familjare nga ana e QPS. Si shtesë, raportet e fundit për punën e QPS të publikuara nga Enti për veprimtari sociale janë që nga viti 2015. Aq më shumë që vetë Enti kishte konstatuar se QPS nuk mban evidencë të duhur të lëndëve të dhunës familjare, përkatësisht ekziston dallim mes të dhënave të mara nga baza LIRIKUS dhe anketat për veprim të dorëzuara nga QPS.

Shtuar kësaj, publiku nuk ka qasje në informacione për masat e përkohshme të shqiptuara dhe të zbatuara për mbrojtje nga dhuna familjare, që paraqesin mekanizëm parandalues që ndikon drejtëpërsëdrejtë në zvogëlimin e normës së dhunës familjare në shoqëri.

Përshkak të problemeve të lartpërmendura, nevojitet rritje e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve kompetente, përmes vendosjes së sistemit të duhur për mbledhje të të dhënave, shkëmbim të të dhënave mes personave profesionistë dhe informim i rregullt i publikut për gjendjet dhe trendet në lidhje me dhunën e bazuar mbi gjininë mbi gratë dhe dhunën familjare.

⁵ Neni.29 dhe neni. 30 i Ligjit për ndalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë dhe dhuna familjare, Gazeta zyrtare nr. 08-524 /1 nga 27.01.2021.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor është vendosje e evidencës së veçantë për lëndët e dhunës familjare nga ana e të gjithë ministrive kompetente dhe institucioneve të përfshira në sistemin e mbrojtjes.

Përveç zmadhimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve, ky zotim do të kontriboj në përforsimin e qasjes në drejtësi për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë familjare, duke patur parasysh se mbledhja e vazhdueshme e të dhënave të unifikuara do të mundësojë vërtetimin e nevojave juridike specifike të viktimave, përkatësisht do të kontriboj si bazë për planifikim, implementim, ndjekje dhe vlerësim të ardhshëm të politikave, ligjeve dhe praktikave në këtë fushë.

Megjithatë, vlen të theksohet se rekomandimet për përmirësim të sistemit të mbledhjes dhe publikimit të të dhënave për dhunë familjare janë përgatitur në bazë të eksperiencës së grave që kanë përjetuar dhunë familjare, si dhe eksperiencës së praktikuesve nga institucionet kompetente.

Në pjesën që vijon janë sqaruar zotimet dhe rezultatet e pritura.

1. Është plotësuar sistemi AKMIS në gjykata me vendosjen e evidencës së veçantë për rastet e dhunës familjare, me të dhëna të ndara për viktimat e dhunës familjare me qëllim:
 - Publikim të rregullt të të dhënave për numrin dhe llojin e lëndëve, të dhënat për viktimat sipas rajonit (qytet/fshat), përkatësi etnike;
 - Informim i gjykatësve për procedurat e ndryshme gjyqësore të lidhura me rast të njëjt të dhunës familjare të cilat udhëhiqen ose janë udhëhequr para gjyqit kompetent (psh. Gjykatës që vepron në procedurë gjyqësore civile për shqiptimin e MPM të marrë informacione për udhëheqjen paralele të procedurës penale për rastin e njëjt);
 - Dhënia e të gjithë procedurave civile lidhur me dhunën familjare tek i njëjti gjykatës, psh. Procedura për shkurorëzim, caktimi i fëmijëve dhe procedura për shqiptim të MPM;

- Publikim i rregullt i aktvendimeve penale dhe civile për mbrojtje nga dhuna familjare dhe vendosje e mundësisë për kërkim sipas fjalës kryesore „dhunë familjare“;
 - Publikim i rregullt i të dhënave publikisht të disponueshme për numrin dhe llojin e kërkesave të deponuara për lirim nga taksat gjyqësore dhe harxhimet në procedurë; numri dhe lloji i lirimeve të miratuara; lartësia e liritimit nga taksat gjyqësore dhe harxhime në procedurë.
2. Është rritur hapja e gjyqit përmes emërimit të gjykatësit kujdestar (dhe daktilografit) për shqiptim të MPM gjatë kohës së vikendeve dhe festave.
 3. Është përparuar sistemi ekzistues për mbledhje të të dhënave për dhunë familjare në QPS dhe policim me statistikë të ndarë për viktimat dhe mundësim të rregullt të të dhënave publikisht të disponueshme për dhunë familjare.
 4. MPB ti rishikojë dhe ti plotësojë formularët ekzistues (vepra penale, kundërvajtje dhe ankesa), me qëllim mbledhjen e të dhënave më të detajuara për dhunë familjare dhe publikim kuartal të të dhënave në lidhje me: numrin e veprave penale kundërvajtje dhe ankesa; informacionet elementare për viktimën (vendi i banimit qytet/fshat; niveli i arsimimit; gjendja e punës; përkatësia etnike); informacione elementare për kryerësin e dhunës familjare. Të vendoset evidencë e veçantë dhe publikim i të dhënave dhe trendeve në lidhje me propozimet e tërhequra dhe të deponuara përsëri për ndjekje penale për veprën penale "lëndim trupor" neni. 130, par. 2 nga KP. Poashtu të vendoset evidencë e veçantë për publikim të numrit të masave të zbatuara urgjente për mbrojtje nga ana e policisë „largim i dhunuesit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim në shtëpi“
 - Të vendoset regjistër i kryerësve të dhunës familjare me qëllim informimin e personave profesionist nga ana e institucioneve që veprojnë në rastet e dhunës familjare;
 - QPS në periudha kuartale të publikojë të dhëna për rastet e dhunës familjare, të dhëna të ndara për viktimat, numrin dhe llojin e masave të siguruara për mbrojtje sipas rajoneve (qytet/fshat) dhe përkatësi etnike;
 - QPS të vendos evidencë të veçantë për rastet ku ka nevojë për shqiptim të MPM dhe rregullisht të publikojë të dhëna për numrin e këtyre rasteve, numrin e propozimeve të deponuara në gjyq dhe MPM të shqiptuara; të jep vërtetim se ka vërtetim për shqiptim të masave që viktimat të mundet vet të deponojë propozim në gjyq.

5. Është vendosur sistem elektronik për mbledhje dhe shkëmbim të të dhënave nga ana e QPS, policia dhe institucionet mjekësore, në drejtim të masave të përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare të propozuara, të shqiptuara, të shfuqizuara, të ndryshuara ose të vazhduara.

**Si do të
kontriboj
zotimi për
zgjidhje të
problem
publik?**

Vendosja e evidencës së veçantë për rastet e dhunës familjare në çdo institucion kompetent direkt do të ndikojë në zmadhimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve. Sistemi i vendosur për mbledhje të të dhënave do të mundësojë ndjekje të rregullt të gjendjeve, vërtetimin e përshtatshëm të nevojave të viktimave dhe planifikim i politikave shtetërore dhe ligjeve bazuar në dëshmi.

**Pse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të shumta dhe të reja, përmirëson kualitetin e informacioneve, përmirëson qasjen në informacione nga publiku, ose mundëson të drejtën në informacione.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon ose i përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve, krijon ose përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon ose përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve.

**Informacione
shitesë**

Buxhet i nevojshëm/i siguruar për zbatim të zotimit
E rëndësishme është të theksohet se për realizim të zotimit të propozuar nuk nevojiten mjete buxhetore.

Domethënë, për përmirësimin sistemit ekzistues për mbledhje të të dhënave në QPS, policia dhe gjykatat (zotimi 1,3, dhe 4) nevojitet inicim i proceseve të brendshme në ministritë kompetente, përkatësisht vërtetim i formularëve dhe përdorim i tyre në praktikë.

Realizimi i zotimit 2, përkatësisht emërimi i gjykatës kujdestar për veprim në raste të dhunës familjare gjatë vikendit ose festave është veçmë praktikë e vendosur në një pjesë të gjykatave themelore dhe nevojitet e njëjta të zbatohet nga ana e të tjerëve.

Lidhshmëria me programet tjera qeveritare, Planin kombëtar zhvillimor ose plane tjera sektoriale/lokale

Zotimi është plotësisht në pajtim me strategjitë kombëtare dhe programet që e rregullojnë barazinë gjinore në nivel ndërkombëtar dhe rajonal. Në pajtim me planin për veprim për implementim të Konventës së ratifikuar të Këshillit të Europës për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna mbi gratë dhe dhuna familjare. (Konventa e Stambollit).

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimin 16 „Paqe, drejtësi dhe institucione të fuqishme“, Objektivi 16.3 Promovim i sundimit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mundësim i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë.

Lidhje me Strategjinë për luftë kundër korupsionit, Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm të OKB dhe të tjera.

Mbajtja e evidencës së veçantë dhe publikimit të rregullt të të dhënave për dhunë familjare kontribon direkt për implementimin e Qëllimit 16 Objektivi 16.3. Sundimi i së drejtës dhe qasja e barabartë në drejtësi për të gjithë. Domethënë, për ndjekje të implementimit të këtij qëllimi për zhvillim të qëndrueshëm në shtet nevojitet mbajtje e të dhënave për gjendjen e grupeve të pambrojtura të qytetarëve, përfshirë edhe gratë që kanë përjetuar dhunë familjare. Këto të dhëna duhet të shërbejnë si përgatitje në plan nacional për implementim të Qëllimit 16.3., përkatësisht plan për përparim të qasjes në drejtësi për grupet e pambrojtura të qytetarëve.

Shoqata ESB dhe Koalicioni Margjina me mbështetje të Fondacionit Shoqëri e Hapur Maqedoni (FSHHM) në vitet e kaluara punojnë në mënyrë aktive për përshpejtim të procesit të implementimit të 16 Objektivi 16.3 nga ana e Qeverisë. Në këtë drejtim, një pjesë e aktiviteteve për përfaqësim janë të drejtuara drejt sistemit të mbledhjes së të dhënave për gjendjen e grupeve të pambrojtura të qytetarëve.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
4.3.1	Organizim i takimeve të punës për plotësim të rregullores së gjykatës nga ana e MD	1. Numri i plotësimeve të Rregullores së gjykatës 2. Numri i plotësimeve në sistemin AKMIS	MD	tetor 2021	dhjetor 2021
4.3.2	Evidencë e veçantë dhe publikim kuartal i të dhënave për lëndët gjyqësore për dhunë familjare	1. Numri i lëndëve penale dhe civile; Numri dhe lloji i aktvendimeve.	MD/GJTH	qershor 2022	gusht 2023
4.3.3	Vendosje e gjykatësve kujdestar në gjithë gjykatat themelore.	1. Numri i gjykatësve të emëruar kujdestar.	GJTH	tetor 2021	dhjetor 2022
4.3.4	Formim i grupit të punës dhe organizim i takimeve të punës për revidim dhe plotësim të formularëve (vepra penale, kundërvajtje, ankesa) për mbledhje të të dhënave nga ana e policisë.	1. Numri i formularëve të reviduar për mbledhje të të dhënave për dhunë familjare për policinë	MPB (Sektori për analitikë)	tetor 2021	mars 2022

4.3.5

Evidencë e veçantë dhe publikim i të dhënave për propozimet e deponuara dhe të tërhequra për veprën penale lëndim trupor (neni.130 par.2); Evidencë e veçantë dhe publikim i të dhënave në lidhje me masën e shqiptuar dhe të zbatuar urgjente për mbrojtje "largim i dhunuesit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim “

1. Numri i veprave penale, kundërvajtjeve dhe ankesave
2. Numri i propozimeve për vepër penale lëndim trupor (neni. 130 par. 2) që janë publikuar
3. Numri i rasteve për masën e shqiptuar dhe të zbatuar urgjente për mbrojtje "largim i dhunuesit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim" të cilat janë të publikuara

MPB (Sektori për analitikë)

qershor 2022

gusht 2023

4.3.6

Organizim i takimeve të punës dhe koordinim me MPB, MD dhe MSH për përgatitje të formularit për mbledhje dhe publikim kuartal të të dhënave të ndara për dhunën familjare nga ana e QPS, përfshirë edhe të dhëna të detajuara për numrin e rasteve ku ka patur nevojë, numri i propozimeve të deponuara për MPM, numri i propozimeve për ndryshim, shfuqizim ose vazhdim të MPM.

1. Numri i takimeve të punës të realizuara për përgatitje të formularit
2. Numri i palëve të prekura të përfshira në procesin e përgatitjes së formularit.

MPPS (Enti për veprimtari sociale)

tetor 2021

mars 2022

4.3.7	Evidencë e veçantë dhe publikim kuartal i të dhënave për numrin e rasteve të dhunës familjare, si dhe të dhëna të detajuara për numrin e propozimeve për shqiptim, ndryshim ose shfuqizim të MPM.	1. Numri i lëndëve për dhunë familjare 2. Numri i lëndëve në të cilët ka pasur shqiptim, ndryshim ose shfuqizim të MPM	MPPS, QPS (Enti për veprimtari sociale)	tetor 2021	gusht 2023
4.3.8	Miratim i udhëzimeve për publikim të detyrueshëm të rregullt të të dhënave për dhunën familjare nga ana e policisë dhe QPS	1. Numri i takimeve/ mbledhjeve për miratim të udhëzimeve për publikim të rregullt të të dhënave për dhunë familjare 2. Numri i personave profesionistë të përfshirë në procesin e miratimit të udhëzimeve	MPB (Saktori për analitikë) MPPS (Enti për veprimtari sociale)	mars 2022	maj 2022
4.3.9	Krijim i sistemit elektronik për mbledhje dhe shkëmbim të të dhënave nga ana e QPS, gjykatave, policisë dhe institucioneve mjekësore, në lidhje me masat e përkohshme për mbrojtje nga dhuna familjare.	1. Numri i testimeve 2. Numri i ndryshimeve teknike dhe plotësimeve 3. Numri i lëndëve në të cilat janë shqiptuar, ndryshuar ose shfuqizuar MPM	MPPS, MPB, MD	mars 2022	gusht 2022

Zotim i ri

Institucion udhëheqës
për zbatim

MD -Sektor për drejtësi
(gjykatat dhe PTHP)
MPPS
(Qendrat për punë sociale, Enti për veprimtari
sociale)
MPB
(Sektor për analitikë, polici)

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Slavica Zheraiq
Mabera Kamberi
Sofija Spasovska
Lidija Sterjov
Aleksandra Nedeva
Elka Todorova
Tatjana Popovska
Zira Memeti
Svetlana Cvetkovska
Elena Grozdanova
Kadrije Mustafa
Ljubica Panova
Susana Novakoska

Funksioni,
Departamenti

Nëpunës shtetëror

Email

MKamberi@mtsp.gov.mk
sspasovska@mtsp.gov.mk
lidijasterjov@mtsp.gov.mk; lststerjov@mtsp.gov.mk
aleksandra.nedeva@mtsp.gov.mk
etodorova@mtsp.gov.mk
tatjana.popovska@mtsp.gov.mk
zmemeti@mtsp.gov.mk
SCvetkovska@mtsp.gov.mk
EGrozdanova@mtsp.gov.mk
kadrije.mustafa@mtsp.gov.mk
ljubica.panova@mtsp.gov.mk
susana_novakoska@moi.gov.mk

Telefon

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/ Agjencione	MSHIA
Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barabarësi të grave- ESB Jasminka Frishçiq jasminkafriscik@esem.org.mk Stojan Mishev stojanmisev@esem.org.mk





4. QASJE NË DREJTËSI

4.4. Përforcim juridik i qytetarëve përmes informacioneve të disponueshme dhe institucioneve të hapura

tetor 2021 – gusht 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Me ligjin e ri për ndihmë juridike pa pagesë (LNJPP), i cili filloi të zbatohet që në tetor të vitit 2019, në mënyrë të konsiderueshme u përmirësua qësja në drejtësi për qytetarët. Sidoqoftë, ligji në praktikë tregoi se ka dobësi dhe nevojiten ndryshime me qëllim zbatim efikas të tij. Një nga problemet është në drejtim të ekzaminimit i cili duhet të sigurohet nga ana e Byrosë për ekzaminime gjyqësore. Problemi që u identifikua është pamundësia e Byrosë të sigurojë persona specialist për sferat juridike më të shpeshta për të cilat qytetarët kërkojnë ndihmë juridike pa pagesë (NJPP) mes të cilave gjeodezi/gjeodetë si persona profesionist dhe analiza ADN- biologjia molekulare). Problemi i dytë është i lidhur me aprovimin përkatësisht mosaprovimin e kërkesave për ndihmë juridike sekondare kur bëhet fjalë për viktimat e veprave të rënda kriminale në procedurat penale. E njëjta është e nxitur nga kundërshtimi i dispozitave kalimtare dhe përfundimtare të LNJPP dhe mekanizmat kufizuese që ekzistojnë në Ligjin për procedurë penale (LPP). Problemi i tretë është i lidhur me nevojën nga shërbimet për përforcim juridik dhe aftësim kur bëhet fjalë për qasje të bazuar në të drejtat njerëzore.

Ekzistojnë dy dilema në lidhje me rregullimin ligjor të ekspertizës në sistemin e vendosur për NJPP. E para, në Strategjinë për reforma në sektorin gjyqësor 2017-2022 është paraparë aktivitet i heqjes së Byrosë. Kjo e sjell në pikëpyetje nenin 13 par. 6 të LNJPP. E dyta, nuk është mjaftueshëm e rregulluar mënyra, procedura dhe afatet për sigurim të mendimit profesional dhe mendimit nga organi ose eksperti që kryen ekspertizën. Nuk ekziston plan ndihmës në rast të heqjes së Byrosë. Nga ana tjetër, në zhvillim e sipër është Projekt Propozimi i ligjit për ekzaminim, në të cilin ende përmbahen dispozita për funksionim të Byrosë. Pasiguria është në drejtim të rregullimit momental për mbulim të harxhimeve për ekzaminim ose plotësim të zbrazëtirave nga personat ekspert në fusha të caktuara në të cilat popullata e pambrojtur kanë probleme juridike.

Nga aspekti i qasjes në drejtësi të viktimave të veprave të rënda penale, LNJPJ është kontradiktues kur sipas një dispozite shprehimisht rregullon se mbrojtja dhe përfaqësimi në procedurë penale sigurohen në pajtim me LPP (neni 38 i LNJPJ), ndërsa sipas një dispozite tjetër ende e lë në përdorim ligjin e vjetër i cili parasheh ndihmë juridike në të gjithë procedurat gjyqësore që të jepet mbrojtje për viktimat e veprave penale dhe viktimave të tregëtisë me njerëz (neni 49 nga ligji i ri për NJPP në lidhje me nenin 8 të ligjit të vjetër për NJPP). Mirëpo, edhe që të sigurohet përfaqësimi i viktimave të veprave penale sipas LPP, edhe pse ekziston version pune i LPP të ri me qëllimin që të gjindet zgjidhje, sidoqoftë nuk largohet problemi me kufizimin e mekanizmave që janë në dispozicion në LPP për viktimat. Mundësia për ndihmë juridike pa pagesë është e unifikuar në nenin 53 paragraf 3 në lidhshmëri me nenin 55 paragraf 1 pika 1 nga LPP. Aty formulacioni është shumë strikt dhe thuhet se viktima ka të drejtë për këshilltar në barrë të mjeteve buxhetore, përkatësisht bisedë pa pagesë me këshilltar ose përfaqësues para dhënies së deklaratës (nëse në procedurë merr pjesë si i dëmtuar), përkatësisht deklaratë ose dorëzim të kërkesës për të drejtat e pronës, nëse ka dëmtime të rënda psikofizike ose pasoja më të këqija nga vepra penale dhe vetëm nëse është viktimë e veprës penale për të cilën është përshkruar dënim me burg prej më së paku 4 vite (si kufi i ulët për dënimin e paraparë për veprën). Formulimi i tillë nuk e përfshin përfaqësimin e plotë nga ana e përfaqësuesit gjatë kohës së procedurës penale, por është e reduktuar në këshillim vetëm gjatë kohës deri sa jepet deklarata e parë. Lënia e viktimës së veprës së rëndë penale vetë pa përfaqësim përkatës të kalojë nëpër procedurën gjyqësore, vetëm sepse LPP apo LNJPJ nuk e lejojnë at, është seriozisht në kundërshtim me gjithë standardet ndërkombëtare dhe principet që flasin për ndihmë juridike dhe shërbime të viktimave.

Përveç NJPP si metodë formalisht e pranuar, ekzistojnë edhe format joformale që janë të disponueshme më së shumti për personat e marginalizuar, sepse janë siguruar nga ana e organizatave të shoqërisë civile, por edhe nga personat e trajnuar nga komuniteti i tyre.

Bashkëpunimi mes aktorëve të ndryshëm që punojnë në përforcimin juridik dhe qasjen në drejtësi në nivel lokal është ende shumë i dobët. Ekziston mungesë e veprave konkrete të përbashkëta dhe mbështetja e ndërsjellë, për arsye të së cilës edhe implementimi në nivel tereni në të cilën pasqyrohet qasja në drejtësi, është lënë në vullnetin momental të subjekteve të ndryshme pa zgjidhje të qëndrueshme konkrete.

Departamentet rajonale (DR) nuk janë shumë të dukshme dhe të njohshme nga qytetarët në sens fizik. Në shumë vende, për arsye të ekonomisë, DR të MD gjinden në ndërtesa ku janë të vendosura më shumë institucione bashkë, me shënim jo të përshtatshëm fizik ose mungesë e të njejtës. Paarritshmëria fizike mund të nënkuptojë qasje të rënduar në drejtësi, varësi nga persona tjerë dhe demotivim i tyre gjatë përdorimit të të drejtës së NJPP. Personat me pengesë vizuale dhe pengesa në të dëgjuarit poashtu janë të painformuar për të drejtën e NJPP sepse nuk ekzistojnë materiale informative të përshtatura me nevojat e tyre. Nga web faqja e MD nuk mund të shihet cili advokat është në radhë për veprim në kërkesën për NJPP. Poashtu, web faqja nuk është e adaptuar për personat me disleksi, as nuk përmban informacione të mjaftueshme në gjuhët e pakicave. Nuk ekziston as udhëzim ku dhe si mundën qytetarët të ankohen nga puna e ofruesve të autorizuar të NJPP. Sipas hulumtimit të fundit të nevojave juridike të qytetarëve nga viti 2015, çdo i dyti qytetar në RMV ballafaqohet me problem juridik. Ajo që shqetëson është që qytetarët nuk i njohin problemet juridike dhe si ti kualifikojnë juridikisht vetëm problemet të cilat do të mbaronin në gjyq.

Është e dukshme se qytetarët e RMV kanë nevojë për shërbime dhe përforcim juridik, por veçanërisht vëmendje duhet të iu kushtohet grupeve të cënuara të cilat për shkak të cënueshmërisë gjinden në situatë të pavolitshme dhe me qasje të kufizuar në drejtësi.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor: Përforcim juridik dhe qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët në pajtim me nevojat dhe probemet e tyre juridike

Në bazë të arritjeve të arritura paraprake nga zotimi në PKV4, ky zotim i ri paraqet qëndrueshmëri të qasjes në drejtësi dhe përforcim juridik (duke marrë parasysh rekomandimet e mekanizmit të pavarur për njoftim - përfshirje të Strategjisë kombëtare për përforcim juridik) përmes arritjes së rezultateve të pritshme në vijim:

- Strategji kombëtare e krijuar për përforcim juridik
- Dukshmëri e rritur dhe disponueshmëri fizike e DR të MD
- Ndryshimet ligjore të miratuara me qëllim realizimin më efikas të qasjes në drejtësi, të cilat kanë të bëjnë me ekzaminimin dhe qasjen në ndihmë juridike të viktimave të veprave të rënda penale
- Është vendosur bashkëpunim mes Byrosë për ekzaminime gjyqësore dhe ekspertë nga të gjitha fushat dhe procedurë e rregulluar për sigurim të ekzaminimit;
- Janë informuar përfaqësues të MD, BEGJ, dhomës së advokatëve, institucioneve tjera që përpilojnë ekzaminime nga sferat që prekin qasjen në drejtësi për popullatën me prona të vogla;
- Informacione publikisht të disponueshme për ekspertë dhe siguries të shërbimeve juridike joformale dhe formale
- Bashkim i të dhënave në web faqet <https://pravnapomos.mk/> dhe <https://www.pravnozajakni.mk/>
- Hartëzim i ofruesve formalë dhe joformalë të ndihmës juridike
- Krijim dhe mbajtje të regjistrit publikisht të disponueshëm për dhënës formalë dhe joformalë të ndihmës juridike
- Bashkim i të dhënave me të cilat disponojnë organizatat e shoqërisë civile dhe MD
- Është vendosur databazë ndërvepruese gjithpërfshirëse me informacione nga të gjithë ofruesit e ndihmës juridike dhe shërbimeve me qëllim vlerësimin e gjendjeve aktuale dhe gjetjen e zgjidhjeve të ardhshme praktike dhe të besueshme
- Shërbime të disponueshme dhe informacione për personat me pengesa

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi është i drejtuar kah disa intervenime me qëllim që të kontribohet drejt qasjes më efektive në drejtësi për të gjithë qytetarët. Fillimisht, nevojiten ndryshime ligjore të LNJP me qëllim sigurimin e bazës për qasje efektive të qytetarëve në ekzaminime nga të gjitha sferat dhe të garantohet mbrojtje efektive e viktimave të veprave të rënda penale. Njëkohësisht, që të mundësohet ekzaminim në pajtim me LNJP për pyetjet juridike për të cilat garantohet NJPP, Byroja për ekzaminime gjyqësore do të lidhë kontratë me ekspert, ndjekur me aktivitete të cilat do të garantojnë përfshirje të të gjithë palëve në proces. Që të mundësohet mbrojtje efektive e viktimave të veprave të rënda penale, do të mbushet zbrazëtira për qasje në ndihmë juridike në procedura penale për viktimat të veprave të rënda penale për të cilët është paraparë dënim më i ulët me burg nga ai momental sipas LPP në më së paku 4 vite.

Më tutje, do të krijohet strategji kombëtare për përforsim juridik. Strategjia do të krijohet në proces transparent me përfshirje të të gjithë aktorëve relevant. Strategjia kombëtare do të jetë multi sektoriale dhe do të përfshijë të gjithë institucionet e prekura dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në sigurimin e shërbimeve, ndihmës juridike dhe përforsimit juridik. Strategjia do të parasheh aktivitete konkrete, buxhet dhe kornizë kohore për përforsim juridik për të gjithë qytetarët në nivel kombëtar dhe lokal.

Nevojitet qasje gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme që do të përmbledh veprimtarinë e institucioneve lokale dhe shoqatave të qytetarëve në veprime të përbashkëta për përmirësim të qasjes në drejtësi për të gjithë.

Veçanërisht në kohën e pandemisë së COVID-19, do të kontribohet kundrejt dukshmërisë më të madhe, transparencës dhe disponueshmërisë së ofruesve formalë dhe joformalë të ndihmës juridike. Dukshmëria më e madhe dhe disponueshmëria fizike e DR të MD do të nënkuptojë disponueshmëri më të madhe të shërbimeve të tyre për qytetarët.

Përmes materialeve të përshtatura personat me pengesa do të jenë të informuar dhe të përforsuar në kohë të duhur.

Përmes disponueshmërië së regjistrave të të gjithë ofruesve të ndihmës juridike do të ndikojë kundrejt informimit dhe udhëzimit të qytetarëve ku të adresojnë problemin që kanë në pajtim me natyrën e problemit.

Regjistrat e personave ekspertë do të ndikojnë kunderjt hapjes më të madhe të të dhënave dhe të drejtës së zgjidhjes nga ana e qytetarëve.

**Pse ky zotim
është relevant
për vlerat e
PHQ?**

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të reja dhe më gjithpërfshirëse dhe në kohë të duhur të lidhura me realizimin e të drejtës së ndihmës juridike pa pagesë dhe formave joformale të ndihmës juridike dhe përforsim të qytetarëve.

Përmirëon kualitetin e informacioneve të disponueshme për qytetarët, në nivel kombëtar dhe lokal, gjatë realizimit të të drejtës së vet për qasje në drejtësi. Përmirëson qasjen në informacione nga publiku dhe mundëson të drejtën në informacione për realizim të qasjes në drejtësi duke mundësuar ndihmë juridike të qytetarëve, veçanërisht grupeve më të marginalizuara.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse krijon dhe përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve ashtu që mundëson krijimin e aktiviteteve të krijuara sipas dëshirës së qytetarëve, të cilat rrjedhin direkt nga nevojat e tyre dhe në të cilat ata janë pjesëmarrës aktivë. Krijon ose përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile ashtu që i përfshin organizatat e shoqërisë civile dhe vetë qytetarët si aktorë aktiv në zhvillimin dhe përmirësimin e qasjes në drejtësi, i cili në mënyrë të këtillë do të krijohet në një cikël komplementar të aktiviteteve të dala nga nevojat e atyre për të cilat është i destinuar.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse krijon ose përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve përmes krijimit dhe publikimit të informacioneve publikisht të disponueshme për zgjidhjet e ndërmarra në bazë të të cilëve të gjithë qytetarët, edhe ata më të marginalizuarit, mund të gjejnë zgjidhje konkrete për problemet e tyre juridike të përditshme dhe të kërkojnë llogaridhënie nga autoritetet.

Informacione shtesë

- Buxhet i nevojshëm/i siguruar nga ana e MD për zbatim të një pjesë të zotimit
- Lidhje me Ligjin për ndihmë juridike pa pagesë, Strategjia për reforma të sektorit gjyqësor 2017-2022
- Lidhje me Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm të OKB - QZHQ 16.3.

RMV është përmendur si shtet shembull që është e dedikuar në përmirësimin e qasjes në drejtësi, duke përfshirë prioritetin Qasje në drejtësi në Planin kombëtar për veprim dhe Partneritet të hapur qeveritar 2018-2020.

Për ndjekje të implementimit të Qëllimit për zhvillim të qëndrueshëm 16.3 në shtet nevojitet evidentim i rregullt i të dhënave për gjendjet e grupeve të cënuara të qytetarëve. Këta të dhëna duhet të shërbejnë për përgatitje të planit kombëtar për implementim të Qëllimit 16.3., përkatësisht plan për përmirësim të qasjes në drejtësi për grupet e cënuara të qytetarëve. Në bazë të analizës së përgatitur për të dhënat e mbledhura sipas treguesve të definuar paraparak për ndjekje dhe implementim të QZHQ 16.3.

Si shtesë, si një nga problemet më të shpeshta juridike për të cilat qytetarët kërkojnë NJPP, është gjeodezia. SHMJR, me mbështetje të FSHHM përpiloi Dokument për politikë publike për ekzaminim dhe ndihmë juridike pa pagesë me titull “A do të lehtësojë qasjen në ndihmë juridike pa pagesë ligji i ri nga viti 2019 mbi ndihmën juridike pa pagesë për personat të cilëve u është miratuar ndihmë juridike sekondare?” Në këtë dokument janë përmbajtur më shumë informacione për problemin, si dhe rekomandime të formuluar dhe propozime për zgjidhje të të njëjtit.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
4.4.1	Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për ndihmë juridike pa pagesë në dispozitat 13, 38, 49	1. Ligj i ndryshuar dhe i plotësuar për ndihmë juridike pa pagesë në dispozitat përkatëse (po/jo)	MD, Këshilli i Evropës, organizata të shoqërisë civile dhe (deponuesit e zotimit dhe organizata të autorizuar për sigurim të NJPP)	tetor 2021	maj 2022
4.4.2	Kontrata për bashkëpunim mes Byrosë për ekzaminim gjyqësor dhe ekspertë të jashtëm të autorizuar nga sfera e gjeodezisë dhe biologjia molekulare	1. Numri i kontratave të lidhura për bashkëpunim me ekspertët	BEGJ	qershor 2022	tetor 2022
4.4.3	Sesione informative për nevojën e ekspertizës në sferat që prekin qasjen në drejtësi për popullatën me pronësi më të dobët me Ministrinë e Drejtësisë, BEGJ, dhoma e advokatëve, institucionet tjera të cilat përgatisin ekspertiza	1. Numri i pjesëmarrësve në sesionet/punëtoritë informative	MD,BEGJ, SHMJR	tetor 2021	mars 2022
4.4.4	Përpilim i udhëzimeve interne (ose si alternativë, Memorandum mes MD dhe BEGJ) për veprimin në rast të nevojës për ekspertizë kur është aprovuar ndihma juridike sekondare	1. Numri i takimeve për përgatitje të udhëzimeve interne 2. Numri i personave të përfshirë në përpilimin e udhëzimeve interne	MD,BEGJ	mars 2022	qershor 2022

4.4.5

Analiza me udhëzime afatshkurta (për zgjidhje të shpejtë momentare të problemit me ekspertizën dhe çbllokimin e lëndëve që momentalisht janë të bllokuara përshkak të asaj) dhe rekomandime afatgjate (ndryshime ligjore që në afat të gjatë do të zgjedhin problemin me ekzaminimin)

1. Numri i rekomandimeve afatshkurta të zhvilluara
2. Numri i rekomandimeve afatshkurta të pranuar
3. Numri i rekomandimeve afatgjate të zhvilluara

MD, Këshilli i Evropës

tetor 2021

dhjetor 2021

4.4.6

Krijim dhe mirëmbajtje e regjistrit gjithpërfshirës publik të ekspertëve për sferat me interes të NJPP

1. Numri i ekspertëve të evidentuar në regjistër

MD, BEGJ

janar 2022

maj 2023

4.4.7

Sigurim i disponueshmërisë fizike dhe dukshmëri për LNPP

1. Numri i DR pranë MD që kanë siguruar disponueshmëri fizike për ersonat me pengesa fizike dhe të shikimit

MD, Departamente rajonale t MD

tetor 2021

qershor 2023

4.4.8	Përshtatje e web faqes oficiale të Ministrisë së drejtësisë (ose në https://pravnapomos.mk/) për informim të papenguar në lidhje me LNJP (dukshmëri dhe disponueshmëri në informacione nga LNJP dhe DR për personat me disleksi, personat me pengesa vizale dhe auditive, si dhe persona nga bashkësitë etnike)	1. Numri i kategorive të personave për të cilët është përshtatur web faqja e Ministrisë së drejtësisë	MD, Departamente rajonale të MD, Këshilli i Evropës	tetor 2021	shtator 2022
4.4.9	Bashkimi i të dhënave në web faqet https://pravnapomos.mk/ dhe https://www.pravnozajakni.mk/	1. Numri i takimeve të mbajtura për koordinim mes MD, Këshillit të Evropës dhe FSHHM 2. Koha e nevojshme të bashkohen të dhënat në web faqet	MD, FSHHM, Këshilli i Evropës	tetor 2021	maj 2023
4.4.10	Hartëzimi i ofruesve formalë dhe joformalë të ndihmës juridike	1. Numri i ofruesve të hartëzuar formalë dhe joformalë të ndihmës juridike	MD dhe organizatat e shoqërisë civile anëtare të rrjetit joformal për përforsim juridik (FSHHM dhe 16 organizata të shoqërisë civile)	janar 2022	qershor 2022

4.4.11

Krijim dhe mirëmbajtje e regjistrit gjithpërfshirës publik pranë MD për dhënës formalë dhe joformalë të ndihmës juridike

1. Numri i ofruesve formalë/ joformalë të ndihmës juridike të disponueshëm në platformë

MD, FSHHM

korrik 2022

maj 2023

4.4.12

Bashkim i të dhënave me të cilat disponojë organizatat e shoqërisë civile dhe Ministria e drejtësisë

1. Koha e nevojshme për bashkim, përkatësisht migrim të të dhënave të organizatave të shoqërisë civile me databazën e Ministrisë së drejtësisë

MD, FSHHM dhe Këshilli i Evropës

tetor 2021

shkurt 2022

4.4.13

Ndërveprueshmëri e databazës ekzistuese të të dhënave duke mundësuar qasje në derjtësi

1. Numri i ofruesve të shërbimeve të përfshirë në databazën (shoqatat, departamentet rajonale pranë MD, klinika juridike dhe persona nga shoqëria që mundësojnë shërbime) .)

MD dhe Këshilli i Evropës

janar 2022

qershor 2023

4.4.14

Përgatitje e planit kombëtar (strategjisë) për përforcim juridik

1. Numri i palëve të prekura të përfshira në përgatitjen e Planit kombëtar (strategjisë) për përforcim juridik
2. Numri i takimeve/ punëtorive të mbajtura për përgatitje të planit kombëtar
3. Numri i aktiviteteve të përfshira në planin kombëtar

MD,
Departamentet
rajonale pranë
MD, rrjeti
joformal për
përforcim
juridik

janar 2022

qershor 2023

Zotim i ri
Duke marrë parasysh rekomandimeve të MHP (IRM



Institucion udhëheqës
për zbatim

MD

Emri i personit
përgjegjës për zbatimVesna Cekova
Zurija MemedovaFunksioni,
Departamenti

Udhëheqës

Email

vesnacekova@mjustice.gov.mk
ZurijaMemedova@mjustice.gov.mk

Telefon

/

Subjekte të tjera të
përfshiraMinistri/
Agjencione

BEGJ

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale**Shoqata maqedonase e juristëve të rinj**[Elena Georgievska egeorgievska@myla.org.mk](mailto:Elena.Georgievska@myla.org.mk)**Izbor Strumicë**[Boris Gudev borisgudev@gmail.com](mailto:Boris.Gudev@gmail.com)**EHO Shtip****Blagica Kirov blagicakirov@yahoo.com****Stacioni PET Prilep**[Vesna Shapkoskiristeska.vesna@live.com](mailto:Vesna.Shapkoskiristeska.vesna@live.com)**Këshilli i Europës****Irena Cuculoska Jakimovska**Irena.CUCULOSKA-JAKIMOVSKA@coe.int**Kristina Doda**Kristina.DODA@coe.int**Anamarija Nikolovska**anamarija.nikolovska@coe.int**Fondacioni shoqëri e hapur- Maqedoni****Ivona Stalevska**ivona.stalevska@fosm.mk**Hristina Vasilevska Dimçevska**hristina.vasilevska@fosm.mk



5. MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

5.1. ZVOGËLIM I EFEKTEVE NGA NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE MBROJTJE E MJEDISIT JETËSOR NGA AKTIVITETET BUJQËSORE

tetor 2021 –mars 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

- Informaci të pamjaftueshme të disponueshme në zonat rurale;
- Mungesa e vetëdijes së mjaftueshme të zhvilluar për pasojat e ndryshimeve klimatike;
- Qasje globale ndaj temës;
- Mungesa e edukimit të popullatës rurale për njohje të pasojave nga ndryshimet klimatike, por edhe për kontribut kundrejt shkaktimit të të njejtave;
- Mospërfshirje e qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve të lidhura me veprimet lidhur me klimën e të tjera.;
- Prodhim lokal i zvogëluar i udhqimit dhe të hyrave ekonomike;
- Ajër i ndotur dhe shëndet i rrezikuar i popullatës;
- Kontribut kundrejt efekteve negative nga ndryshimet klimatike;
- Veprimi ende në mënyrë tradicionale dhe mospraktikimi i masave dhe normave të miratuara ligjore;
- **Bujqërit menaxhojnë me 50% të tokës në RMV, shfrytëzojnë 60 deri në 80% nga ujërat e ëmbla të shtetit, në hambaret e tyre, kotecë pulash, kope ose thënë në mënyrë bashkëkohore ferma jetojnë numër i madh i kafshëve, shfrytëzojnë mijëra tona të materieve më shumë ose më pak të fuqishme toksike në formë të pesticideve, mbeturina dhe agro-kimikate të tjera.**
- Sipas hulumtimeve për struktura të ekonomisë bujqësore, të zbatuara nga Enti për statistika në vitin 2016, **në sektorin individual janë angazhuar vetëm 5,2% të njerëzve me çfarëdo lloj arsimi në bujqësi, ndërsa numri i kuadrove të kualifikuar të angazhuar në sferën e bujqësisë është vetëm 0,8%.**
- Në lidhje me informimin e qytetarëve, nga 473 të anketuar prej 48 komunave në RMV në hulumtimin e zbatuar nga ana e MMJPH më i përfaqësuar është qëndrimi se menaxhimi me ndryshimet klimatike nuk është detyrim i individit por i Qeverisë, industrisë dhe kompanive dhe se qytetarët nuk dijnë por edhe nuk kanë informacione të mjaftueshme se si mund të ndihmojnë në menaxhimin me ndryshimet klimatike.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllim kryesor i zotimit është përmes edukimit të rritur dhe informimit të popullatës rurale të zvogëlohet ndotja e mjedisit jetësor dhe efektet negative nga ndryshimet klimatike.

Rezultate:

- Përdorim i rritur i praktikës së mirë bujqësore si postulat elementar për mbrojtjen e mjedisit jetësor nga aktivitetet bujqësore.
- Informim i rritur tek 50% nga bartësit e ekonomive familjare bujqësore për rregullat e vlefshme për praktikë të mirë bujqësore si dhe për bazat penale për mospërdorim të të njejtave.
- Sistem i vendosur për informim të rregullt për ndryshimet klimatike dhe efektet negative nga të njejtat.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Arritjet e lartpërmendura do të kontribuojnë direkt në zgjidhjen e problemit publik i cili ka të bëjë me ndotjen e mjedisit jetësor dhe rritjen e efektit nga ndryshimet klimatike, sepse bëhet fjalë për më shumë se 170.000 ekonomi familjare bujqësore të cilat kryejnë aktivitete bujqësore, duke mos patur kujdes mbi ndotjen e mjedisit jetësor. Përmes vetëdijes së përforcuar, edukimit dhe informimit të rritur do të kontribuohet drejt ndryshimit të shprehive të popullatës rurale dhe në atë mënyrë drejt zvogëlimit të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse mundëson qasje në informacione të reja dhe të shumta, përmirëson kualitetin e informacioneve dhe përmirëson qasjen në informacione nga publiku.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse përmirëson mundësitë dhe kushtet për pjesëmarrje publike dhe ndikim në krijimin e vendimeve dhe përmirëson hapësirën mundësuese për shoqërinë civile.


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE ßsepse i përmirëson rregullat, rregulloret dhe mekanizmat për përgjegjësi publike të funksionerëve.

Informacione shtesë

Ky zotim është në pajtim dhe kontribon drejt realizimit të prioriteteve dhe qëllimeve të parapara në disa dokumente strategjike edhe atë:

- Strategjia kombëtare për bujqësi dhe zhvillim rural 2021-2027 ku njëri nga qëllimet strategjike është i drejtuar pikërisht kundrejt zvogëlimit të efekteve nga ndryshimet klimatike në prodhimtarinë bujqësore;
- Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm të OKB veçanërisht qëllimi 13 i cili është në mënyrë direkte i drejtuar kundrejt marrjes së masave për klimën;
- Plani kombëtar për veprim i MMJPH për klimën, strategjinë komunikuese për ndryshimet klimatike e të tjera.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me qëllimin 13 Aksion klimatik“Objektivi 13.3: Të përmirësohet arsimi, vetëdija dhe kapacitetet institucionale dhe njerëzore për zbutje të ndryshimeve klimatike, për rregullim, zvogëlim të ndikimeve për paralajmërim të hershëm. Me masat e këtij zotimi përmes vetëdijes së ngritur, edukimit dhe informimit të qytetarëve do të kontribuohet drejt ndryshimit të shprehive të popullatës rurale dhe në këtë mënyrë drejt zvogëlimit të ndotjes dhe mbrojtje së mjedisit jetësor.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
5.1.1	Rritje e vëllimit të informacioneve mes popullatës rurale për efektet negative të ndryshimeve klimatike dhe ndotjen e mjedisit jetësor	1. Numri i materialeve informative të përpiluara 2. Numri i punëtorive edukative të mbajtura në zonat rurale 3. Numri i prodhuesve bujqësor të informuar	MMJPH	tetor 2021	mars 2023
5.1.2	Rritje e vëllimit të informacioneve mes popullatës rurale dhe edukim mbi rregulloren për praktikë të mirë bujqësore si dhe ndryshimet në pjesën e sanksioneve për moszbatim të tij në teren.	1. Numri i ekonomive bujqësore të vizituara 2. Numri i materiale informative të shpërndara 3. Numri i sanksioneve të shqiptuara për moszbatim të rregullores	MBPEU (ANZHB, AMFBZHR), Koalicioni rural	tetor 2021	dhjetor 2021

5.1.3

Zgjerim i listës së kushteve minimale të veçanta për PMB dhe mbrojtje e mjedisit jetësor të cilat prodhuesit bujqësor do duhet ti përmbushin me zbatimin e praktikës së mirë bujqësore dhe përpilim të rregullores së re për praktikë të mirë bujqësore


1. Numri i kriteriumeve të definuara në Rregulloren për PMB
2. Numri i kushteve minimale ekzistuese të modifikuara të përcaktuara në rregullore
3. Numri i ekonomive bujqësore të informuara për ndryshimet dhe rregulloren e re

MBPEU

janar 2022

mars 2023

Zotim i ri



Institucion udhëheqës
për zbatim

MBPEU

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Aleksandar Musalevski,

Funksioni,
Departamenti

Udhëheqës sektori

Email

a.musalevski@mzsv.gov.mk

Telefon

/


Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

MMJPH

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Koalicioni rural, liljana.
jonoski@gmail.com





5. MJEDISI JETËSOR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

5.2. Qasje në informacione për nivelin e ndotjes së ajrit tetor 2021 – shtator 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Në total 18 stacione matëse fikse dhe 1 stacion matës mobil si pjesë e rrjetit shtetëror të monitorimit për kualitetin e ajrit janë vendosur në qytete të ndryshme të shtetit. Nga numri total i stacioneve matëse, 5 janë në Shkup, 2 në Manastir dhe nga 1 në Kumanovë, Miladinovc, Koçan, Veles, Strumic, Kavadar, Gjevgjeli, Kërçovë, Lazaropole, Gostivar dhe Tetovë. Stacioni mobil i monitorimit është funksional që nga viti 2017 dhe i njeiti vendoset në ata komuna që nuk janë të përfshira në stacionet fikse të monitorimit në periudhën një vjeçare. Deri më tani është vendosur në komunën Butel, Shkup dhe momentalisht është vendosur në Gjorçe Petrov, Shkup. Në qytetet tjera më të vogla të shtetit nuk janë vendosur stacione fikse matëse, por monitorimi i kualitetit të ajrit në këto qytete do të kryhet me stacionin mobil.⁶ Rrjeti shtetëror i monitorimit për kualitet të ajrit i përmbush kriteriumet për numrin minimal të vendeve matëse në zonë të caktuar dhe grumbullimi, të përshkruara me legjislacionin kombëtar dhe direktivat Europiane për kualitet të ajrit. Rrjeti shtetëror i monitorimit në vitet e kaluara ballafaqohet me probleme në lidhje me funksionalitetin e vazhdueshëm të instrumenteve matëse, veçanërisht përshkak të vjetërsisë të pajisjes. Një periudhë më të gjatë instrumenti për ndjekje të koncentrimit të grimcave PM 10 nuk ishte në funksion të stacionit matës Lisiçe, derisa problemi me këtë instrument, por edhe instrumenteve për ndjekje të koncentrimit të grimcave tjera (CO, NO₂, O₃, PM_{2.5} dhe SO₂) vërehen në stacionet tjera matëse në Shkup.⁷ Në Manastir, matja e koncentrimit të grimcave PM_{2.5} ka filluar në vitin 2017⁸ dhe ka vazhduar fillimisht vetëm përmes një stacioni matës (Manastir 2) ndërsa nga tetori i vitit 2020 e njehta matet edhe në stacionin e dytë matës (Manastir 1).

⁶ Burim: Web faqja „Kualitet i ajrit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor“ <https://air.moep.gov.mk/>

⁷ Burim: Raporte mujore të Sistemit shtetëror automatik për monitorim për kualitetin e ajrit, të publikuara në: https://air.moep.gov.mk/?page_id=290

⁸ Ibid

Në Kumanovë koncentrimi i grimcave PM2.5 matet që nga viti 2017 година. Në këtë drejtim ,përshebull, instrumentet për grimcat PM10 të stacionit matës Manastir 1 nuk kanë dhënë të dhëna 187 ditë në vitin 2019 , 26 ditë në vitin 2018, 79 ditë në vitin 2016 dhe 19 ditë në vitin 2015, derisa instrumentet për grimcat PM 10 të stacionit matës Manastir 2 nuk kanë dhënë të dhëna 192 ditë në vitin 2019, 56 ditë në vitin 2018, 66 ditë në vitin 2017, 6 ditë në vitin 2016 dhe 56 ditë në vitin 2015. Njëkohësisht, instrumentet për matje të koncentrimit të grimcave PM 2.5 në stacionin matës Manastir 2, që janë vendosur në vitin 2017, nuk kanë dhënë të dhëna 192 ditë në vitin 2019 dhe 56 ditë në vitin 2018.⁹ Por përsërim MMJPH punën në mënyrë aktive në rinovimin dhe plotësimin e sistemit shtetëror për monitorim të kualitetit të ajrit, përmes mundësisht të mjeteve nga buxheti kombëtar dhe projekte të ndryshme donatore. Vitet e fundit është evident përmirësimi i funksionalitetit të sistemit të monitorimit dhe pritet që i njëjti të jetë plotësisht i renovuar kah fundi i vitit 2022. Me qëllim planifikimin përkatës të aktiviteteve për zvogëlim të ndotjes së ajrit në shtet, nevojitet ekzistimi i rrjetit të besueshëm dhe gjithpërfshirës për monitorim të koncentrimit të grimcave. Informacione gjithpërfshirëse dhe të besueshme nga rrjeti i monitorimit janë të nevojshme para së gjithash për krijim të dokumenteve strategjike nga fusha (plane, strategji e të ngjashme) si dhe ndjekje e zbatimit të tyre, përkatësisht nëse dhe me çfarë dinamike realizohen qëllimet e parapara (a realizohen qëllimet e definuara si zvogëlim i koncentrimit të supstancave ndotëse, nëse dinamika e përmbushjes së këtij qëllimi është në nivel të kënaqshëm e të tjera). Për realizim të qëllimeve të vendosura në këtë mënyrë, nevojitet mirëmbajtje dhe servisim i rregullt dhe i duhur i stacioneve matëse tashmë të vendosura nga rrjeti shtetëror për monitorim. Të dhënat nga sistemi automatik shtetëror për monitorim për kualitet të ajrit nga viti 2012 publikohen në kohë reale në portalin për kualitet të ajrit (<https://air.moepp.gov.mk>). Të njëjtat rregullisht njoftohen në nivel kombëtar si dhe deri tek agjencioni europina për mjedis jetësor.

⁹ Ibid

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllimi kryesor i zotimit

Qëllim i përgjithshëm: Mundësim i informacioneve gjithpërfshirëse dhe të besueshme për nivelin e ndotjes së ajrit në RMV

Qëllim specifik 1: Rritja e numrit të stacioneve matëse në shtet

Qëllim specifik 2: Mirëmbajtje e rregullt dhe servisim i instrumenteve matëse që janë pjesë e stacioneve matëse në kuadër të rrjetit shtetëror për monitorim

Qëllim specifik 3: Përpilim i aplikacionit telefonik për prezantim të të dhënave nga sistemi automatik shtetëror për monitorim për kualitetin e ajrit.

Rezultate: zbatim i aktiviteteve do të kontribuoj në rritjen e përfshirjes së rrjetit shtetëror për monitorim përmes rritjes së numrit të stacioneve matëse në qytetet ku nuk janë të vendosur. Përmes mirëmbajtjes së rregullt dhe servisimit të instrumenteve matëse të reja dhe atyre ekzistuese, shteti do të mundësojë bazë të përshtatshme të të dhënave të nevojshme për krijim të politikave efikase për zvogëlim të ndotjes së ajrit dhe ndjekje të realizimit të qëllimeve në dokumentet strategjike. Mundsim i një set instrumentesh matëse rezervë, me qëllim vendosjen në funksion të të njejtave derisa instrumentet ekzistuese servisohen dhe përsëri vendosen në funksion që të mos ketë humbje në të dhënat nga matjet e kryera. Me përpilimin e aplikacionit të telefonit, do të mundësohet informim i qytetarëve për gjendjen me kualitetin e ajrit në mënyrë më të thjeshtë dhe më të pranueshme.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Përmes vendosjes së stacioneve të reja matëse për kualitet të ajrit në Prilep, Ohër dhe Shtip, si pjesë e rrjetit të monitorimit shtetëror do të rritet numri i stacioneve matëse, përkatësisht vëllimi i të dhënave për kualitetin e ajrit i cili në afat të gjatë do të kontriboj drejt planifikimit më të mirë të politikave nga sfera e nivelit lokal dhe qendror. Vendosja e stacionit matës për kualitet të ajrit në Berovë do të kontriboj për monitorim më të mirë të ndotjes ndërkufitare të ajrit. Vendosja e stacioneve shtesë matëse do të kontriboj për planifikim më të mirë të politikave lokale për mbrojtje të ajrit. Në këtë mënyrë do të vlerësohet nëse duhet të përdoren masa, si dhe zgjidhja e masave dhe politikave që në mënyrë efikase do të zgjedhin problemin.

Mirëmbajtja e rregullt dhe servisimi i instrumenteve nga sistemi automatik i monitorimit shtetëror, do të mundësojë monitorim efikas dhe përmbushje të qëllimeve për monitorim të parashikuara në Ligjin për kualitet të ajrit.

Mundësimi i një seti të instrumenteve matëse rezervë, do të kontribojë për mirëmbajtje të të gjitha stacioneve matëse, përkatësisht rrjetit shtetëror i cili në mënyrë efikase do të monitorojë kualitetin e ajrit, që do të kontribojë për:

- Mundësinë e përllogaritjes së koncentrimëve mesatare ditore të substancave ndotëse dhe njoftim të qytetarëve
- Aplikimi në kohë të duhur i masave afatshkurta për përmirësim të kualitetit të ajrit në nivel lokal gjatë tejkallimit të kufijv për alarmim
- Planifikim i politikave në nivel qendror dhe lokal për zvogëlim të ndotjes së ajrit
- Ndjekje e realizimit të masave të parapara me politikat në nivel qendror dhe lokal.

Përpilimi i aplikacionit të telefonit, do të mundësojë informim të qytetarëve për gjendjen me kualitetin e ajrit në mënyrë më të thjeshtë dhe bashkëkohore, mënyrë të pranueshme për të gjithë shfrytëzuesit e telefonëve celularë.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN sepse përmes vendosjes së instrumenteve të reja matëse si pjesë e rrjetit të monitorimit shtetëror, do të mundësoj më shumë informacione të cilat do të jenë të disponueshme për institucionet shtetërore, por edhe për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile. Ne vendosjen e stacioneve matëse në qytetet ku tanimë nuk janë vendosur, do të mundësohet përfshirje më e madhe e rrjetit të monitorimit shtetëror, që do të kontribuojë në shfaqje gjithpërfshirëse të gjendjeve me ndotjen e ajrit. Përmes mirëmbajtjes së rregullt të stacioneve matëse të vendosura dhe vendosjes së stacioneve të reja matëse në qytetet ku të njëjtat për momentin nuk janë vendosur, do të përmirësohet kualiteti dhe besueshmëria e informacioneve për ndotjen e ajrit në shtet. Rritje e numrit total të stacioneve matëse në shtet dhe mirëmbajtje e tyre e rregullt, të dhënat për matje të të cilit do të tregohen në web faqen tashmë të krijuar të MMJPH për kualitetin e ajrit, do të mundësoj publiku dhe institucionet shtetërore të kenë informacione gjithpërfshirëse dhe të besueshme për gjendjet.


ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJEN E SHOQËRISË CIVILE sepse me realizimin e saj do të mundësohet numër më i madh i informacioneve të organizatave të shoqërisë civile që do të kontribuojë që propozimet e tyre dhe pjesëmarrja në krijimin e politikave nga sfera e ndotjes së ajrit të jetë e bazuar në argumente dhe informacione të përpikta. Realizimi i zotimit do të mundësoj organizatat e shoqërisë civile të ndjekin realizimin e masave të miratuara për luftë kundër ndotjes së ajrit, por edhe realizim të dokumenteve shtetërore strategjike.

ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE sepse përmes sigurimit të informacioneve të besueshme për nivelin e ndotjes së ajrit, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile do të mundën rregullisht të ndjekin arritjen e qëllimeve të vendosura si dokumentet strategjike nga sfera dhe të reagojnë në publik, që do të kontribuojë në institucione të përgjegjshme shtetërore të cilat në kohë të duhur reagojnë në drejtim të zgjidhjes së sfidave dhe punojnë drejt përmbushjes efektive të qëllimeve të monitorimit dhe detyrimeve të cilat shteti i ka sipas rregullativës ligjore dhe konventës së Arhusit.

Informacione shitesë

Lidhur me Qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm të OKB, lidhje me Qëllimin 13: „Aksion klimatik“, Objektivi 13.3: Të përmirësohet arsimi, vetëdija dhe kapacitetet njerëzore dhe institucionale për zbutjen e ndryshimeve klimatike, për përshtatje, zvogëlim të ndikimeve dhe për paralajmërim të hershëm.

Lidhshmëri me qëllimet globale për zhvillim të qëndrueshëm -Lidhje me Qëllimet 13 Aksion klimatik“, Objektivi 13.3 Përmirësim i arsimit, ngritje e vetëdijes dhe kapacitetit njerëzor dhe institucional për zbutje të ndryshimeve klimatike, adaptimit, zvogëlimit të ndikimit dhe paralajmërimit të hershëm. Me masat e këtij zotimi përmes vetëdijes së përmirësuar, edukimit dhe informimit të qytetarëve do të kontribuohet drejt ndryshimit të shprehive të popullatës rurale dhe në këtë mënyrë drejt zvogëlimit të ndotjes së ajrit dhe mbrojtje të mjedisit jetësor.



Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
5.2.1	Janë vendosur 4 stacione të reja matëse për matje të kualitetit të ajrit si pjesë e rrjetit të monitorimit shtetëror (Prilep, Shtip, Ohër, Berovë) me qëllim plotësimin e vëllimit të informacioneve për nivelin e ndotjes në këta katër qytete të publikuara në Air Quality Portal (Air Quality Portal (moep.gov.mk)), në drejtim të mundësimit të informacioneve më të shumta për qytetarët me qëllim reagimin e duhur për ndërmsrre të zgjidhjeve përkatëse.	1. Numri i stacioneve të reja matëse të vendosura për matje të kualitetit të ajrit si pjesë e rrjetit të monitorimit shtetëror 2. Numri i informacioneve të publikuara në Air Quality Portal	MMJPH	tetor 2021	dhjetor 2022

5.2.2

Riparim i instrumenteve të grimcave PM 10 dhe instalim i instrumenteve të reja për PM2.5 tek ata stacione matëse që nuk janë në funksion me qëllim shmangien e ndalesës së sigurimit të informacioneve për publikun lidhur me ndotjen e ajrit në qytetet e tyre.

1. Numri i instrumenteve të reja të vendosura për grimcat PM 2.5
2. % e teritorit të shtetit për të cilën merren të dhëna për grimcat PM10 и PM2.5

MMJPH

tetor 2021

qershor 2022

5.2.3

Mirëmbajtje e rregullt e stacioneve matëse për matje të kualitetit të ajrit si pjesë e monitorimit shtetëror në shtet me qëllim shmangien e ndaljes së sigurimit të informacioneve për publikun në lidhje me ndotjen e ajrit në qytetet e tyre.

1. Numri i instrumenteve të ndryshuara
2. Numri i riparimeve të kryera
3. Numri i instrumenteve që kanë mbulesë vjetore prej 90% (Objektiv: të gjithë instrumentet në 19 stacione matëse)


MMJPH

tetor 2021

dhjetor 2023

5.2.4	Sigurim i një set instrumentesh matës rezervë me qëllim shmangjen e ndalimit me mundësimin e informacioneve për publikun për nivelin e ndotjes së ajrit në qytetet e tyre.	1. Numri i seteve të instrumenteve rezervë të siguruara	MMJPH	tetor 2021	qershor 2022
5.2.5	Përpilim i aplikacionit celular i cili do të mundësoj qasje në të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit përmes telefonit celular dhe njoftime të vazhdueshme të qytetarëve.	1. Numri i qytetarëve shfrytëzues të aplikacionit	MMJPH	tetor 2021	qershor 2022

Zotim i ri



Institucion udhëheqës
për zbatim

MMJPH

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Svetlana Gjorgjieva

Funksioni,
Departamenti

Udhëheqës sektori
Qendër maqedonase informative për mjedisin
jetësor

Email

S.Gjorgjieva@moepp.gov.mk

Telefon

075 266 053

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri/
Agjencione

MSHIA

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Shoqata maqedonase
për juristë të rinj,
btrpevski@myla.org.mk



* * *

Bazuar në suksesin e arritur nga zgjerimi i mëparshëm i kësaj iniciative në kuadër të Parlamentit, në këtë cikël përveç pjesës kryesore për zotimet për Parlament të hapur u krijuan edhe zotime për Gjyqësi të hapur. Prandaj, duke respektuar pavarësinë e punës së pushtetit ligjvënës dhe atij gjyqësor si pushtete të veçanta në RMV, Partneriteti i hapur qeveritar me plotë meritë kalon në Partneritet për qeverisje të hapur. Rrjedhimisht, në komunikimin e mëtutjeshëm dhe në realizimin e kësaj iniciative në vend të emërtimit të deritanishëm Partneritet i hapur qeveritar do të përdoret PARTNERITET PËR QEVERISJE TË HAPUR (PQH).

Më poshtë në shtojcë është dhënë shqyrtim i zhvillimit të planeve për aktivitet për Parlament të hapur dhe Gjyqësi të hapur si dhe rishikim përmbledhës i zotimeve dhe arritjeve të cilat i përmbajnë të njejtat.

Koordinimi, zbatimi dhe ndjekja e planeve për aktivitet për Parlament të hapur dhe Gjyqësi të hapur do të kryhet nga ana e Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përkatësisht nga ana e Gjyqit suprem të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të cilën do ta informojnë Ministrinë e shoqërisë informatike dhe administratës dhe do të sigurojnë informacione për portalin për PQH (www.ovp.gov.mk).

PARLAMENT I HAPUR

ZHVILLIM I PLANIT KOMBËTAR PËR VEPRIM PËR PARTNERITETIN PËR QEVERISJE TË HAPUR PËR PERIUdhËN 2021-2023 (PKV 5) - PARLAMENT I HAPUR

Në vitin 2018, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke ndjekur qëllimet e saj strategjike për Demokraci funksionale parlamentare, Parlament të hapur, Diplomaci parlamentare, Parlament të siguritë dhe Shërbime moderne dhe efikase dhe shërbim parlamentar dhe rekomandimet e mekanizmit të njoftimit të pavarur të PHQ, iu bashkangjiti iniciativës për Partneritet të Qeverisjes së Hapur. Duke pasur parasysh pavarësinë e punës së Parlamentit si pushtet i veçant në Republikën e Maqedonisë së Veriut, puna e identifikimit të zotimeve për Parlament të hapur u zbatua paralelisht me aktivitetet për përcaktim të zotimeve të reja për Qeveri të hapur në Planin e pestë kombëtar për veprim për Partneritet për qeverisje të hapur për periudhën 2021-2023.

Plani për veprim për Parlament të hapur u zhvillua në proces të gjërë përfshirës me zbatimin e ngjarjeve hibride, punëtorive, e-konferencave për PQH (si pjesë e javës globale për hapje të pushtetit ligjvënës #GLOW2020 bashkëorganizuar nga ana e Rrjetit për parlament të hapur (OPeN)), webinarëve dhe online konsultave të propozim teksteve të planit¹⁰.

Në bazë të konsultave të realizuara, grupi i punës për hapje të ligjvënës të Parlamentit në datë 07.06.2021 miratoi Planin e veprimit të Parlamentit 2021-2023 kundrejt Partneritetit për qeverisje të hapur.

¹⁰ 7 organizata kthyen komente edhe atë IDSCS, NDI, FSHHM, Shoqata e nëpunësve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, EKOZVON, koalicioni rural, dhe drejtori rajonal për PQH për Evropën

RISHIKIM PËRMBLEDHËS I ZOTIMEVE PËR PARLAMENT TË HAPUR

1. PARLAMENTI PËR QYTETARËT ME PËRGJIGJE TË HAPUR DHE RIKUPERIM TË HAPUR NGA PANDEMIJA KOVID-19

- Përpilim i portalit online për të dhëna të hapura për qasje më të lehtë në informacione nga qytetarët
- Platformë për rekomandime dhe iniciativa nga qytetarët deri te pushteti ligjvënës dhe regjistër i organizatave të shoqërisë civile
- Siguri digjitale përmes nënshkrimeve digjitale për deputetët dhe shërbimin parlamentar

2. INFRASTRUKTURË E PËRMIRËSUAR TIK

- Përpilim i faqes së re të internetit të parlamentit për informim më të mirë të qytetarëve
- TV kanal parlamentar plotësisht funksional
- Përpilim i zgjidhjes softuerike për ndjekje të procesit ligjvënës deri te publiku
- Hapje e softuerit e-arhivë për kërkime nga publiku
- Furnizim me kamera me mjete për transmetim të seancave në internet

3. PJESËMARRJE E QYTETARËVE/ PARLAMENT I HAPUR

- Përpilim i reportazheve dhe njoftim i publikut për promovim dhe punën e zyrave për kontakt me qytetarët
- Zbatim i aktiviteteve për promovim të partneritetit për qeverisje të hapur
- Furnizim me zgjidhje softuerike për mundësim të përkthimit nga të folurit në tekst

* * *

Koordinimi, zbatimi dhe ndjekja e Planit për veprim do të bëhet nga ana e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut për çka do të informojë Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe do të mundësojë informacione në portalin për PQH (www.ovp.gov.mk).



1. PARLAMENTI PËR QYTETARËT ME PËRGGJIGJE TË HAPUR DHE RIKUPERIM TË HAPUR NGA PANDEMIA KOVID-19

1.1. Përpilimi i portalit online për të dhëna të hapura për qasje më të lehtë në informacione për qytetarët

korrik 2021 – korrik 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Parlamenti thekson se të dhënat e hapura mund të kontribuojnë për transparencën, hapjen dhe pjesëmarrjen e publikut në punën e pushtetit ligjvënës.

Për këtë qëllim Parlamenti do të krijojë mjet softuerik për sete të dhënash.

Qëllimi kryesor i zotimit

Qasje sistematike online në setet e të dhënave nga pushteti ligjvënës, për qasje më të mirë dhe kërkim nga publiku.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Mjeti softuerik do të mundësojë:

- hapje të seteve të të dhënave në formate të lexueshme kompjuterike;
- prodhim i seteve të të dhënave në punën e përditshme dhe informacione kronologjike
- publikim i meta të të dhënave për setet e të dhënave;
- rritje e përfshirjes së shfrytëzuesve përmes përdorim të përsëritur të të dhënave (re-usage)

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shtesë

/

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.1.1	Procedura e paraparë në planin për prokurime publike për vitin 2021 dhe mjetet e siguruar nga donacioni	1. Përgatitje e specifikacioneve teknike dhe dokumenteve tenderuese Procedurë e prokurimit publik e publikuar	Parlamenti dhe PMP	maj 2021	qershor2021
1.1.2	Implementim i zgjidhjes softuerike	1. Operator ekonomik i zgjedhur, kontratë e lidhur dhe e zbatuar	Parlamenti dhe operatori ekonomik	qershor2021	nëntor 2021
1.1.3	Plotësim i sistemit me sete të dhënash	1. Numri i seteve të të dhënave të krijuara 2. Sasia e informacioneve të përpunuara në format të përshtatshëm dhe vendosja në sistem	Parlamenti	dhjetor 2021	qershor2022

Zotimi për herë të parë parashihet në planin PHQ (Partneritet i hapur qeveritar) 2021-2023

Institucion udhëheqës
për zbatim

PARLAMENTI me mbështetje të Programit
për mbështetje parlamentare PMP

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i
Parlamentit
Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe
koordinator për PQH për Parlamentin

Funksioni,
Departamenti

Sektore në shërbimin e Parlamentit

Email

parl.inst@sobranie.mk

Telefon

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri,
departamente/
agjencione

/

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Partnerë të
përfshirë në MMP
janë NDI, QMN dhe
IDSCS





1. PARLAMENTI PËR QYTETARËT ME PËRGGJIGJE TË HAPUR DHE RIKUPERIM TË HAPUR NGA PANDEMIA KOVID-19

1.2. Platformë Për Propozime Dhe Iniciativa Nga Qytetarët Deri Tek Pushteti Ligjvënës Dhe Regjistër I Organizatave Të Shoqërisë Civile

korrik 2021 – 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Parlamenti ka web faqen e saj për informim të publikut. Për përfshirje direkte të qytetarëve në linkun në vijim ekziston mundësi të kontaktohet me kryetarin e parlamentit <https://www.sobranie.mk/kontaktiraj-so-pretседателот.nspk>

Si shtesë, për komunikim me deputetët qytetarët mund të shfrytëzojnë linkun e mëposhtëm nga web faqja e Parlamentit <https://www.sobranie.mk/prashaj-go-pratenikot.nspk>

Parashikimi i këtij zotimi është që sistematikisht të përmirësohet qasja me pranim dhe dorëzim të ideve të qytetarëve dhe OJQ. Në pjesën e dytë të regjistrit të organizatave të shoqërisë civile do të adresohet problemi i thirrjes së OJQ në eventet e procesit ligjvënës, pa ndikime politike në zgjedhjen e OJQ-ve, si dhe me informim të barabartë të të gjitha OJQ-ve që janë në sistemin për eventin, ligjin dhe të ngjashme në të cilin mund të marrin pjesë.

Qëllimi kryesor i zotimit

Të gjenerohet qasje sistematike online që qytetarët të dorëzojnë ideja tek përfaqësuesit e tyre.

Qaje sistematike e OJQ në procesin ligjvënës.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Aktiviteti për përpilim të platformës për propozime dhe iniciativa përfshinë përmirësim të mundësive ekzistuese (të përshkruara paraprakisht) për kontakt dhe komunikim me deputetët, promovim të mundësive për publikun, zgjidhje administrative për mbledhje të propozimeve, dorëzim dhe mbajtje e evidencës për proceset e zotimit propozohet për përpilim të mjetit për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin ligjvënës.

Për regjistrin e organizatave të shoqërisë civile, ideja është të definohet proces i rishikimit dhe zgjidhje e OJQ për pjesëmarrje në trupa pune, debate publike dhe mbikëqyrëse.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJEËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shitesë

Mjete të programuara në buxhetin e Parlamentit prej 2.000.000 denarësh për përmirësim softuerik
 Vlera e projektuar prej 840.000 denarëve për regjistër të qytetarëve e mundësuar me doncion nga PMP



Nr	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.2.1	Zbatim financiar i zotimit	1. Parashikim i mjeteve në buxhetin cirkular. 2. Buxhet i miratuar për vitin 2022 3. Plan i miratuar për prokurime publike për vitin 2022 me procedurën e paraparë	Parlamenti	qershor 2021	dhjetor 2022
1.2.2	Zbatim administrativ i zotimit	1. Procedura të publikuara për prokurime publike. Kontratë e realizuar me operator ekonomik	Parlamenti dhe operatori ekonomik	maj 2022	shtator 2022
1.2.3	Pjesëmarrje e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin ligjvënës	1. Numri i iniciativave të dorëzuara përmes sistemeve 2. Numri i iniciativave të rishikuara nga deputetët 3. Numri dhe lloji i organizatave të shoqërisë civile të cilat kanë marrë pjesë në trupat e punës, debatet mbikëqyrëse dhe publike.	Parlamenti dhe OJQ	dhjetor 2022	dhjetor 2022

Zotimi për herë të parë parashihet në planin PHQ 2021-2023

Institucion udhëheqës
për zbatim

PARLAMENTI me mbështetje të Programit
për mbështetje parlamentare PMP

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i
Parlamentit
Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe
koordinator për PQH për Parlamentin

Funksioni,
Departamenti

Sektore në shërbimin e Parlamentit

Email

parl.inst@sobranie.mk

Telefon

/

Ministri,
departamente/
agjencione

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Partnerë të
përfshirë në MMP
janë NDI, QMN dhe
IDSCS

Lista e organizatave
me të cilat është
konsultuar i gjithë
plani për veprim





1. PARLAMENTI PËR QYTETARËT ME PËRGJIGJE TË HAPUR DHE RIKUPERIM TË HAPUR NGA PANDEMIA KOVID-19

1.3. Siguri digjitale përmes nënshkrimeve digjitale për deputetët dhe shërbimin parlamentar

korrik 2021 – dhjetor 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Pyetja për punën në largësi u imponua nga pandemia e koronës. Për këtë lloj pune përveç pajisjeve të nevojshme të TIK, për veprimtaritë procedurale në pajtim me Rregulloren u paraqit nevoja e autorizimit digjital. Kjo është e rregulluar me Ligjin për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale dhe përveç prokurimit të certifikatave digjitale përfshin edhe përshtatje softuerike dhe kërkesa tjera që dalin nga ligji bashkë me trajnimin për grupet qëllimore.

Qëllimi kryesor i zotimit

Aktiviteti propozohet me qëllim që të kontribuohet drejt digjitalizimit në disa aspekte të punës së Parlamentit të cilat kërkojnë pjesëmarrje fizike dhe autorizim/nënshkrim të dokumenteve. Në vend të kësaj, me aktivitetin e propozuar vendoset mundësi për shfrytëzim të nënshkrimit digjital.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi propozohet për mundësim dhe shfrytëzim të tokenëve digjitalë për nënshkrime elektronike për deputetët dhe shërbimin parlamentar. Nëse nuk mund të marr pjesë fizikisht në seancë plenare ose në seancë të trupit punues, veprimin procesual deputeti të mundet ta ndërmarrë nga largësia.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shtesë

Aktiviteti do të zbatohet duke patur parasysh, dhe kushtëzuar me ndryshimet dhe plotësimet përkatës të Rregullores së Parlamentit në lidhje me mundësinë deputetët ti shfrytëzojnë tokenët digjitalë për nënshkrime elektronike.

Vlera e projektuar prej 1.800.000 denarë me mjete nga donacioni

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
1.3.1	Miratim i ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores së Parlamentit në lidhje me mundësinë që deputetët ti shfrytëzojnë tokenët digjitale për nënshkrime elektronike	1. Pyetje e marrëveshjes politike dhe konsenzusit mes partive	Parlamenti	Korrik 2021	Dhjetor 2023
1.3.2	Zbatim financiar dhe administrativ i zotimit	1. Procedurë e publikuar për prokurime publike	Parlamenti	Korrik 2021	Dhjetor 2023
1.3.3	Lehtësim i shfrytëzimit dhe mundësim i vazhdimësisë së përdorimit	1. Instalim dhe trajnime	Parlamenti	Korrik 2021	Dhjetor 2023

Zotimi për herë të parë parashihet në planin PHQ 2021-2023

Institucion udhëheqës
për zbatim

PARLAMENTI me mbështetje të Programit
për mbështetje parlamentare

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i
Parlamentit
Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe
koordinator për PQH për Parlamentin

Funksioni,
Departamenti

Sektore në shërbimin e Parlamentit

Email

parl.inst@sobranie.mk

Telefon

/

Ministri,
departamente/
agjencione

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Partnerë të
përfshirë në MMP
janë NDI, QMN dhe
IDSCS

Lista e organizatave
me të cilat është
konsultuar i gjithë
plani për veprim





2. INFRASTRUKTURË E PËRMIRËSUAR E TIK

2.1. Përpilim i web faqes së re të parlamentit për informim më të mirë të qytetarëve

korrik 2021 - dhjetor 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Parlamenti ka web faqen e saj, e cila ka të dhëna për informim proaktiv të publikut. Nga analizat e bëra dhe me zhvillimin teknologjik, Parlamenti llogarit që web faqja duhet të përmirësohet që të mund të jetë më lehtë e kërkueshme, më e organizuar dhe të ofrojë më shumë informacione për qytetarët.

Në programin për mbështetje parlamentare është planifikuar dhe buxhetuar përpilimi i web faqes së re.

Qëllimi kryesor i zotimit

Aktiviteti propozohet me qëllim që të kontribohet drejt riorganizimit të të dhënave, mënyrës së plotësimit dhe evidentimit në kohë të duhur, sistemi i kërkimit nëpër dokumente.

Si do të kontriboj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi propozohet për përpilim të faqes së re të internetit të Parlamentit.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shitesë

Vlera e projektuar prej 5.082.219 denarësh me mjete të siguruar nga konfederata Zvicerane

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.1.1	Zbatim financiar dhe administrativ i zotimit	1. Mjete të siguruara nga PMP dhe prokurime publike të publikuara	Parlamenti	prill 2021	dhjetor 2021
2.1.2	Zbatim operativ i zotimit	1. Zbatim i kontratës për përmirësim të web faqes	Parlamenti	korrik 2021	mars 2022
2.1.3	Web faqe funksionale	1. Numri i hapjeve të web faqes 2. Numri i shkarkimeve të informacioneve dhe dokumenteve	Parlamenti	mars 2022	dhjetor 2023

Zotim në vijim i bartur nga plani PHQ 2019-2021

Institucion udhëheqës
për zbatim

PARLAMENTI me mbështetje të Programit
për mbështetje parlamentare

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i
Parlamentit
Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe
koordinator për PQH për Parlamentin

Funksioni,
Departamenti

Sektore në shërbimin e Parlamentit

Email

parl.inst@sobranie.mk

Telefon

/


Subjekte të tjera të
përfshira

Ministri,
departamente/
agjencione

/

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Partnerë të
përfshirë në MMP
janë NDI, QMN dhe
IDSCS





2. INFRASTRUKTURË E PËRMIRËSUAR E TIK

2.2. Kanal televiziv plotësisht funksional i parlamentit

janar 2021 - dhjetor 2023

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Parlamenti ka kanal të veçantë televiziv në të cilin mund të informoj publikun në mënyrë proaktive për proceset rrjedhëse direkt ose me inçizime. Puna e kanalit parlamentar ka organizim institucional përmes funksionimit të Këshillit të kanalit parlamentar. Parlamenti llogarit se kanali është resurs përmes të cilit mund më mirë të njoftojë publikun për punën e saj dhe të rris shikueshmërinë.

Qëllimi kryesor i zotimit

Aktiviteti propozohet me qëllim rritjen e shikueshmërisë së kanalit televiziv të parlamentit përmes reformës së kanalit, përmes përmbajtjeve që ofron nga puna e Parlamentit dhe përmes skemës programuese të definuar me pajisje moderne dhe persona të trajnuar.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Zotimi propozohet për reformim të kanalit televiziv të parlamentit.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shtesë

Vlera e projektuar prej 15.529.000 denarë me mjete të siguruar nga Konfederata Zvicerane.

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.2.1	Zbatim financiar dhe administrativ i zotimit	1. Mjete të siguruara procedurë e realizuar për prokurime publike 2. Kontratë e lidhur me operatorin ekonomik	Parlamenti MRT	qershor 2021	dhjetor 2022
2.2.2	Mundësim i kapaciteteve administrative	1. Publikim i njoftimit për angazhim të 7 nëpunësve parlamentar	Parlamenti	Shtator 2021	dhjetor 2022

Zotim në vijim i transferuar nga plani PHQ 2019-2021



Institucion udhëheqës për zbatim	PARLAMENTI me mbështetje të Programit për mbështetje parlamentare	
Emri i personit përgjegjës për zbatim	Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i Parlamentit Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe koordinator për PQH për Parlamentin	
Funksioni, Departamenti	Sektore në shërbimin e Parlamentit	
Email	parl.inst@sobranie.mk	
Telefon	/	
Subjekte të tjera të përfshira	Ministri, departamente/ agjencione	/
	Organizata të shoqërisë civile, sektori privat, grupe pune dhe multilaterale	Partnerë të përfshirë në MMP janë NDI, QMN dhe IDSCS





2. INFRASTRUKTURË E PËRMIRËSUAR E TIK

2.3. Përpilim i zgjidhjes softuerike për ndjekje të procesit ligjvënës nga publiku

korrik 2021 - dhjetor 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Vijimi i procedurës ligjvënëse mund të ndiqet përmes faqes së internetit të Parlamentit. Kërkimi nuk shkon përmes dokumentit (propozim ligj), por sipas trupit punues dhe nevojiten disa hapa dhe përvojë në kërkim që të gjinden informacione.

Qëllimi kryesor i zotimit

Aktiviteti propozohet me qëllim që publiku të mundet në kohë reale të ndjek në çdo fazë propozim ligjet dhe si janë afatet në procedurë nga dita e pranimi deri në miratimin dhe nënshkrimin e dekretit.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Me këtë zgjidhje, saktë do të shihen fazat e procedurës ligjvënëse, pranimi i propozimeve, leximi i parë dhe i dytë, seancat plenare, koha e dorëzimit të amandamenteve dhe debatit, deri në miratimin e propozim ligjit. Më shumë informacione proaktive për publikun dhe rishikim të saktë kur mund të dorëzohen amandamentet.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR LLOGARIDHËNIE PUBLIKE PO/JO

Informacione shtesë

/

Nr.	Arritje	Tregues	Bartës i aktivitetit	Data e fillimit	Data e mbarimit
2.3.1	Zbatim financiar dhe administrativ i zotimit	1. Buxhet i siguruar në vitin 2022 dhe procedurë e paraparë në planin për prokurime publike ose përfshirë në mënyrë alternative si modul për rregullim të prokurimeve ekzistuese publike për përmirësim të parlamentit.	Parlamenti dhe operatori ekonomik	korrik 2021	dhjetor 2022
2.3.2	Mundësim në vazhdimësi i përdorimit dhe shfrytëzimit	1. Numri i propozimeve që janë të dukshme në mënyrë të tillë Numri nuk hap web fagen për kontroll të ligjeve	Parlamenti	nëntor 2022	dhjetor 2023

Zotimi është aktivitet i ri nga plani PHQ 2021-2023



Institucion udhëheqës
për zbatim

PARLAMENTI

Emri i personit
përgjegjës për zbatim

Cvetanka Ivanova, sekretar gjeneral i
Parlamentit
Zlatko Atanasov, këshilltar shtetëror dhe
koordinator për PQH për Parlamentin

Funksioni,
Departamenti

Sektore në shërbimin e Parlamentit

Email

parl.inst@sobranie.mk

Telefon

/

Ministri,
departamente/
agjencione

/

Subjekte të tjera të
përfshira

Organizata të
shoqërisë civile,
sektori privat,
grupe pune dhe
multilaterale

Partnerë të
përfshirë në MMP
janë NDI, QMN dhe
IDSCS





2. INFRASTRUKTURË E PËRMIRËSUAR E TIK

2.4. Hapje e softuerit të e-arkivës për kërkime nga publiku

korrik 2021 - dhjetor 2022

Cili problem publik adresohet me zotimin?

Instituti parlamentar në Parlament krijoi zgjidhje softuerike për E-arkivë në vitin 2016. Kjo zgjidhje mundëson qasje elektrike në të dhënat nga arkiva ligjvënëse (gjithçka që hyn dhe del nga seanca plenare. Baza i përfshin të gjithë dokumentet e krijuara sipas një pike.

Të dhënat janë kodifikuar duke filluar nga viti 1986 me mbi 1.2 milion faqe dokumentesh.

Deri më tani kjo bazë shfrytëzoheshte me intranet me kërkesë të shërbimeve dhe deputetëve.

Qëllimi kryesor i zotimit

Aktiviteti propozohet me qëllim që baza të bëhet e disponueshme edhe për publikun dhe qytetarët të munden ti shfrytëzojnë dokumentet që janë pjesë e bazës së E-arkivës.

Si do të kontribuoj zotimi për zgjidhje të problemit publik?

Kjo zgjidhje mundëson qasje elektronike në të dhëna nga arkiva ligjvënëse (gjithçka që hyn në procedurë përkatëse ka dalur nga seanca plenare). Baza i përfshinë të gjithë dokumentet e krijuara sipas një pike.

Pse ky zotim është relevant për vlerat e PHQ?

- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR TRANSPARENCËN PO/JO
- ZOTIMI ËSHTË I RËNDËSISHËM PËR PJESËMARRJE TË SHOQËRISË CIVILE PO/JO
